

1 E premte, 13 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
7 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Dhe mirë se keni ardhur të gjithë në sallën e gjyqit. Për
14 procesverbal, të akuzuarit janë të katërt në sallën e gjyqit.

15 Sot do të vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse të kësaj
16 çështjeje gjyqësore të Mbrojtjes së Rexhep Selimit. Më vonë do
17 të vazhdojmë me Mbrojtjen e Jakup Krasniqit. Dhe sot do të
18 punojmë sipas rendit të ditës Të paraqitur në urdhrin e Trupit
19 Gjykses për sa i takon deklaratave përmbyllëse, që është në
20 parashtrimin F03639.

21 Ju kujtoj se seanca e ditës së sotme planifikohet që të
22 përfundojë në orën 4.45, do bëjmë disa pushime, pushimi i parë
23 është një orën 10.30 dhe do fillojmë në orën 11.00, pastaj
24 kemi pushimin e drekës në orën 12.00 dhe më pas kemi edhe një
25 pushim tjetër për 15 minuta në orën 3.00.

1 Dëshiroj që t'ju kujtoj palëve që të flasin ngadalë dhe
2 qartë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

3 Këto janë komentet e Trupit Gjykues.

4 Tani dua t'i jap fjalën Mbrojtjes së z. Selimi. Gjithsej
5 ju kemi dhënë katër orë, ndërkohë që keni dhe dy orë e gjysmë,
6 çfarë do të thotë që planifikohet që ju të keni përfunduar
7 deri në orën 12.00 sot.

8 Atëherë besoj që bëra një gabim sepse ne do bëjmë
9 pushimin e drekës në orën 12.00, nuk do bëjmë pushim të
10 shkurtër në 12.00, po do bëjmë pushimin e drekës.

11 Në rregull. Z. Tully fjala është për ju.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

13 Unë do trajtoj tri tema në emër të z. Selimi sot. Së
14 pari, do të trajtoj pretendimet e ZPS-së në lidhje me z.
15 Selimi si ministër i rendit publik, së dyti, do të trajtoj
16 aspekte të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me shkrime dore dhe
17 me shënimet që pretendohen që të jenë bërë prej z. Selimi dhe,
18 së treti, do flas për përjashtimet për rregullin 140 që ZPS-ja
19 mbulon në disa pjesë të dosjes së saj.

20 Tani le t'i marrim njëra pas tjetrës këto tri tema.

21 Tema e parë, Ministria e Rendit Publik.

22 Çështjet trajtohen plotësisht në dosjen tonë
23 përfundimtare në paragrafët përkatës së saj. Çështja kryesore
24 në parashtrimet e ZPS-së ka të bëjë me faktin e kontrollit në
25 qoftë se z. Selimi ka pasur ndonjë kontroll mbi policinë si

1 ministër i rendit publik. Sikurse do t'jua shpjegoj për një
2 çast, ZPS-ja nuk ka arritur që të vërtetojë argumentet e veta.

3 Përpara se të vijojmë me aspektin e kontrollit
4 plotësisht, megjithatë dua të trajtoj një çështje paraprake.
5 Për të qenë të qartë, termi "policia e UÇK-së ose PU-së" është
6 një tezë e ZPS-së e hartuar si një kosh ku ZPS-ja mund të
7 hidhte sa më shumë dëshmi përmes provave jogojore për të dhënë
8 përshtypjen e gabuar që ekzistonte një forcë policie dhe që
9 drejtohej nga z. Selimi si ministër i rendit publik. Pra,
10 është një përpjekje e ZPS-së për të dhënë një përshtypje të
11 gabuar ndërkohë që ky argument nuk qëndron.

12 Sikurse e kemi thënë në dosjen tonë përfundimtare, pas
13 qershorit, UÇK-ja dhe policia ushtarake e UÇK-së ka qenë nën
14 komandë dhe nën strukturat dhe ka qenë nën përgjegjësinë e
15 komandantëve të zonave, nuk ka qenë nën përgjegjësinë e z.
16 Selimi.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë sepse nuk kemi
18 transkript. Atëherë thjesht transkripti nuk ka lëvizur fare,
19 ndërkohë që filluam që në fillim, domethënë, kemi problem,
20 besoj që dhe ju keni të njëjtin problem. Është i ngrirë
21 transkripti. Nuk shohim dot asgjë në transkript në ekran.

22 Po, tani është më qartë. Faleminderit.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

24 Sikurse e kemi thënë në dosjen tonë përfundimtare në
25 paragrafin 452:

1 "Pas qershorit të 1999-s, policia ushtarake e UÇK-së
2 mbeti nën komandën dhe brenda strukturave të komandantëve
3 respektivë të zonave dhe jo nën Selimin. Nuk ka ekzistuar një
4 polici e tillë e UÇK-së ose e Ministrisë së Rendit Publik që
5 është organizuar ose është mbikëqyrur nga z. Selimi sikurse
6 pretendon ZPS-ja."

7 Unë do shtoja që mungesa e dokumenteve operative që
8 mbështesin pretendimet e ZPS-së sa i takon kontrollit të
9 Ministrisë së Rendit Publik mbi policinë ushtarake është
10 domethënës lidhur me këtë. Sikurse do ju them dhe më poshtë,
11 disa dokumente të cilat janë mbledhur prej Prokurorisë nuk
12 tregojnë që z. Selimi ka pas ndonjë autoritet funksional ose
13 ka ushtruar ndonjë kontroll mbi ndonjë forcë policie.

14 Të martën, këtë javë, në transkript në faqen 28521,
15 Prokuroria iu referua argumenteve në paragrafët 470, 473 të
16 dosjes tonë lidhur me kundërshtimin e mbështetshmërisë së
17 provës 02525, që janë procesverbale të një takimi të datës 2
18 gusht 1999 ku z. Selimi ka qenë i pranishëm. Prokurori i
19 quajti ato të rreme, ndërkohë që pavarësisht kësaj
20 shtrembërojnë tërësisht argumentet e këtyre dokumenteve.

21 ZPS-ja në paragrafin 151 të dosjes së vet, pretendonte që
22 paralelisht me emërimin e z. Selimi në prill të 1999-s ishte
23 krijuar dhe një polici e Ministrisë së Rendit Publik. Kjo nuk
24 është e vërtetë.

25 Në mbështetje të këtij pretendimi, në dosjen e vet

1 përfundimtare ZPS-ja i referohet vetëm paragrafëve 21 të
2 këtyre procesverbaleve të kontestuar të takimit ku z. Selimi
3 keqcitohet që i "ka kujtuar takimin që policia ushtarake
4 ekzistonte që prej prillit të atij viti dhe duhej që të
5 tejkaloheshin disa vështirësi". Ne e kemi theksuar në
6 paragrafin 472 të dosjes tonë se ky citim nuk mund të jetë i
7 saktë, sepse nuk kishte asnjë forcë policie të krijuar në
8 prill të 1999-s duke marrë parasysh rrethanat në atë kohë dhe
9 nuk ka asnjë provë konfirmuese të paraqitur nga dëshmitarë apo
10 nga ZPS-ja që mbështesin një pretendim të tillë. Në fakt, ky
11 pretendim rrëzohet nga vetë përmbajtja e dëshmive.

12 Në dosjen tonë përfundimtare në paragrafët përkatës, ne
13 kemi parashtruar që z. Selimi në këtë takim të gushtit të
14 1999-s, siç përmbledhet në provën 02525 është keqcituar. Ai e
15 ka pasur fjalën për krijimin e Ministrisë së Rendit Publik dhe
16 jo për krijimin e policisë ushtarake.

17 Nëse do shikojmë paragrafët 298 të dosjes së ZPS-së që
18 trajton kohën përkatëse prill-qershor 1999 edhe në qoftë se e
19 do i referohemi parashtrimeve përmyllëse të Prokurorisë të
20 hënën, ZPS-ja në mënyrë të përsëritur rrëzon pretendimet në
21 dosjen paraprake. Dhe duket sikur në dosjen e saj
22 përfundimtare i ka braktisur fare këto pretendime.

23 Në paragrafin 298 kemi një tjetër legjendë, ku thuhet
24 sipas ZPS-së që z. Selimi ka pasur në dispozicion të vet
25 policinë ushtarake. Kjo gjë bëhet duke keqinterpretuar

1 dëshminë e Bislam Zyrapi lidhur me teorinë e një inspektori
2 të përgjithshëm hipotetikusht dhe shumë të kualifikuar, dhe
3 marrëdhënien që ai kishte me policinë ushtarake. Ndërkohë
4 policia vazhdon që të heqë faqen tjetër të transkriptit kur
5 Zyrapi e bën të qartë që nuk kishte marrëdhënie të
6 drejtpërdrejtë ndërmjet inspektorit të përgjithshëm dhe
7 policisë ushtarake. Dhe pavarësisht se çfarë thotë Prokuroria,
8 në këtë dëshmi nuk ka asnjë informacion të rëndësishëm që
9 mbështesin pretendimin e Prokurorisë lidhur me z. Selimi si
10 ministër i rendit publik.

11 Dhe pjesa tjetër e provave të pakta të ZPS-së për lidhjen
12 e z. Selimi me policinë janë disa fotografi që Prokuroria ka
13 gjetur ku z. Selimi është veshur me uniformë të zezë.

14 Do i kërkoja Sekretarit që të na paraqesë një video.

15 Prokuroria të hënën na tha, që të paktën në qershor 1999,
16 z. Selimi e kishte ndryshuar uniformën e vet lara-lara me
17 uniformë të zezë duke spekuluar se kishte një lloj ndryshimi
18 në detyrat dhe përgjegjësitë e z. Selimi. Kjo u tha nga
19 Prokuroria në transkript në faqen 28478. Dhe Prokuroria iu
20 tregoi këtë imazh për të mbështetur qëndrimin e vet.

21 Megjithatë, në asnjë pikë në gjykimin e vet nuk e ka
22 vërtetuar Prokuroria që një person që vesh ndonjë uniformë të
23 zezë apo ndonjë uniformë tjetër, kjo, në vetvete, është
24 tregues se ky person i përket policisë ushtarake, e aq më pak
25 mund të jetë e vërtetë kjo për një polici ose për një ushtri

1 si ushtria e UÇK-së që nuk kishte rregulla strikte sa i takon
2 veshjes së uniformave.

3 Do i kërkoja Sekretarit që tani të paraqesë provën
4 3D00004. Faleminderit.

5 Për të ilustruar dobësinë e këtij argumenti - do i
6 kërkoja Sekretarit të kalojë pak më poshtë në fotografi -
7 është një fotografi e cila është shënuar nga Dëshmitari W04763
8 që tregon z. Selimi në qendër që ka numrin 1 sipër dhe është
9 një fotografi e shokëve të UÇK-së në vitin 1999.

10 Besoj që e shikoni mungesën e uniformitetit për sa i
11 takon veshjes së personave që keni këtu në ekran, megjithatë,
12 në veçanti dua t'ju tërheq vëmendjen që të shikoni personin që
13 ka numrin 4 që është Ekrem Rexha ose "Drini", një person i
14 cili nuk pretendohet as nga ZPS-ja, as nga ne, që ka pasur
15 ndonjë rol në policinë ushtarake, pavarësisht kësaj ky person
16 siç mund ta shikoni është veshur me të zeza. Dhe sipas ZPS-së
17 kishte një domethënie shumë më të thellë të përzgjedhjes së
18 veshjes së uniformës nga Drini në atë ditë.

19 Edhe në provën 00515, në faqen 008179, që ZPS-ja e citon
20 në poshtëshënimin 1232 të paragrafit 298 të dosjes
21 përfundimtare dhe kjo në vetvete tregon pavërtetësinë e
22 argumentit të ZPS-së. Po anëtarët e policisë ushtarake në këtë
23 fotografi me z. Selimi po veshin tre uniforma të ndryshme,
24 pra, kanë tre ngjyra të ndryshme uniformash të veshura. Dhe
25 ata nuk janë veshur në asnjë pikë, siç mund ta shikoni, në

1 mënyrë konsistente për të treguar që ata i përkasin policisë
2 ushtarake.

3 Pasi kemi dëgjuar provat e ZPS-së në këtë aspekt konkret,
4 ne theksojmë parashtrimet tona që pretendimi i ZPS-së lidhur
5 me themelimin e policisë së Ministrisë së Rendit Publik nga z.
6 Selimi në prill të 1999-s është i pambështetur dhe i rremë.
7 Gjithashtu do t'i rekomandonim Trupit Gjykues që të shikonte
8 paragrafët 470 dhe 473 dhe provën 02525 kur t'i vendosë ose
9 t'i japë peshë këtij aspekti të caktuar.

10 Tani do të kaloj tek tema e dytë që ka të bëjë me mënyrën
11 e kontrollit mbi policinë e z. Selimi, pavarësisht formës së
12 përgjegjësisë penale në të cilën janë ngritur akuzat ndaj z.
13 Selimi, sa i takon rolit të tij si ministër i rendit publik,
14 pyetja që ngrihet përpara Gjykatës ka të bëjë me kontrollin.
15 Mënyra se si ZPS-ja e ka çelur gjykimin dhe po ashtu edhe në
16 komentet përbyllëse të këtij gjykimi, çështja e kontrollit
17 qëndron në thelb të pretendimeve kundër z. Selimi në rolin e
18 vet si ministër i rendit publik. Pavarësisht dokumenteve të
19 shumta të pranuar nga Trupi Gjykues, ZPS-ja nuk ka arritur që
20 të provojë argumentin e vet përtej dyshimit të arsyeshëm. Jo
21 vetëm kaq, por ekziston një mungesë e tërë e dokumenteve
22 operative të dërguara nga Ministria e Rendit Publik në drejtim
23 të policisë ose e kundërta, gjë e cila nuk vërteton
24 përfshirjen e z. Selimi dhe faktin që ai ka pasur kontroll mbi
25 policinë.

1 ZPS-ja nuk ka dhënë prova për të vërtetuar që veprimet
2 ose mosveprimet e z. Selimi si ministër i rendit publik kanë
3 luajtur ndonjë rol në kryerjen e krimeve në aktakuzë, apo që
4 ai është përgjegjës për veprimet e personave të tjetër lidhur
5 me kryerjen e krimeve të ngritura në aktakuzë.

6 Në dosjen e vet përfundimtare ZPS-ja duket sikur nuk
7 është e vendosur sa i takon përshkrimit të autoritetit të z.
8 Selimi. Në paragrafin 503 thuhet që z. Selimi kishte "kontroll
9 operacional" ose operativ mbi policinë. Ndërkohë që 30
10 paragrafë më poshtë, në 532, duket sikur e ka ndryshuar disi
11 pak mendjen ZPS-ja duke pretenduar që ai kishte "autoritet
12 operacional" mbi policinë dhe që ai ishte "i pozicionuar" për
13 të udhëzuar veprimet e tyre.

14 Pra, pavarësisht termave që përdor UÇK-ja, ajo nuk ka
15 dhënë asnjë provë për mbështetjen e asnjë prej qëndrimeve të
16 saj.

17 Sa i takon kontrollit operativ të pretenduar të z.
18 Selimi, siç deklarohe në paragrafin 503, ZPS-ja citon një
19 provë materiale në poshtëshënimin 2057, që është prova 189.
20 Dhe është një faqe e librit të Jakup Krasniqit që i referohet
21 ngjarjeve të pretenduara në Llap në gusht të 1998, tetë muaj
22 pasi ishte krijuar Qeveria e Përkohshme.

23 Në paragrafin 532, që i referohet autoritetit operativ të
24 z. Selimi, prapë dëshmitë që jep Prokuroria, provat që jep
25 Prokuroria janë po ashtu të dobëta. Pra, një prej tyre është

1 prova 515, që është një komunikatë që është lëshuar në emër të
2 z. Selimi që unë do ta trajtoj më pas po që e kemi trajtuar
3 plotësisht dhe në hollësi në paragrafin 459 dhe 460 të dosjes
4 tonë dhe po ashtu në provën 3926 që është një shënim i
5 pambështetshëm, i vagullt, i cili është trajtuar në paragrafin
6 459 të dosjes sonë dhe prova 2525, që po ashtu janë
7 procesverbale të një takimi të pabazuar të datës 2 gusht 1999.

8 Pjesa tjetër e citimeve në këtë poshtëshënim ose nuk janë
9 me rendësi për akuzën në fjalë ose janë tërësisht të
10 shtrembëruara. Për shembull, dëshmia e Remit në faqen 5905,
11 5907 trajtojnë çështje përpara krijimit të Qeverisë së
12 Përkohshme dhe trajtojnë çështje të cilat nuk kanë pikë lidhje
13 me autoritetin e pretenduar të z. Selimi si ministër i rendit
14 publik. Ose kemi po ashtu provën 01605, që është një deklaratë
15 e Dëshmitarit W04737 që spekulon lidhur me kompetencat e
16 ministrit të brendshëm dhe personi në fjalë thotë që ai nuk
17 kishte asnjë lloj informacioni lidhur me aspekte të tilla. Për
18 më shumë detaje, ju lutem, referojuni transkriptit në faqen
19 19826, 19827.

20 Pavarësisht që çfarë spekulimi mundohet ZPS-ja që të
21 paraqesë përmes këtyre citimeve, është fakt që në asnjë prej
22 këtyre dokumenteve nuk mund të gjendet një dokument operativ
23 që mbështet pretendimin e ZPS-së. ZPS-ja nuk e ka provuar
24 argumentin e vet.

25 Tani më lejoni të them diçka me mangësitë shkresore, pa

1 diskutim që dua të cek dhe të trajtoj mungesën e qartësisë së
2 argumenteve të ZPS-së sa i takon strukturës së Ministrisë së
3 Rendit Publik.

4 Në dallim të tërë me kohën që i është kushtuar ZPS-së në
5 përpjekje për të krijuar strukturën e pretenduar prej saj ose
6 funksionimin ose organizimin e UÇK-së, përfshirë këtu edhe
7 linjat e raportimit, mënyrat e komunikimit, detajet e takimeve
8 të pretenduara e të tjerë, ZPS-ja ka qenë tërësisht e heshtur
9 sa i takon Ministrisë së Rendit Publik. Kjo është një heshtje
10 që përfaqëson ose reflekton gjendjen e provave të tyre.

11 Sikurse e kemi thënë shumë herë, mungesa e dëshmitarëve
12 për të folur për çështje të rëndësishme është domethënëse,
13 është paragjyquese për shkak të kontekstit dhe për shkak të
14 dokumenteve të shumta shkresore që janë paraqitur
15 drejtpërdrejtë për pranim Trupit Gjyqësor pa u vërtetuar përmes
16 dëshmitarëve. Sikurse e kemi thënë në dosjen përfundimtare në
17 paragrafët 456, 469, 478, 482 dhe 511, nuk është thjesht rasti
18 që dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me Ministrinë e Rendit
19 Publik nuk ishin të disponueshme. ZPS-ja thërriti dëshmitarin
20 Nuredin Ibishi, që kishte informacion lidhur me ministrinë,
21 një dëshmitar që e përshkroi Ministrinë e Rendit Publik si një
22 subjekt pa funksione operationale dhe që ka theksuar herë pas
23 here që ministria nuk kishte asnjë lloj kontrollim mbi
24 policinë. Dhe kjo dëshmi u pranua pa asnjë kundërshtim nga
25 ZPS-ja dhe nuk u shtjellua më tej nga ajo. E kam konkretisht

1 fjalën për provën P1755.9 në faqet 33, 39 dhe më pas provën
2 P1755 dhe faqja 1 deri në 8.

3 Të hënën e kësaj jave në transkript në faqen 28460,
4 Prokurori i tha Gjykatës që do përshkruante strukturën e
5 Qeverisë së Përkohshme përfshirë dhe Ministrinë e Rendit
6 Publik. Po ndryshe nga sa premtoi, ai mori vetëm një paragraf
7 të transkriptit, pra, faqen 28479 të transkriptit dhe thjesht
8 i referoi Trupit Gjykses te paragrafët 301, 302 të dosjes së
9 vet dhe shpresoi se mund t'ia dilte kështu.

10 Në qoftë se do shohim faqet e dosjes së ZPS-së, besoj se
11 do ju vrasë sytë fakti që ka më shumë poshtëshënime sesa ka
12 parashtrime.

13 Dokumentet jokonsistente, kontradiktore shpeshherë, të
14 palidhura, të hedhura në poshtëshënimin në këto faqe tregojnë
15 dëshpërimin e ZPS-së dhe për këtë arsye ZPS-ja, dokumente të
16 cilat, materiale ose prova shkresore janë dhënë nga ZPS-ja për
17 të ilustruar praninë dhe funksionet e Ministrisë së Rendit
18 Publik.

19 Në vend që të japë argumente ose shpjegime sa i takon
20 funksionimit të ministrisë dhe se si këto prova materiale
21 mbështesin argumentin e vet, Prokurori thjesht kujton
22 dokumente, sipas tij, që këto dokumente kanë ekzistuar dhe
23 janë sekuestruar nga z. Selimi dhe hiqet sikur vetëm ky fakt
24 që i ka gjetur këto dokumente mjafton për të vërtetuar
25 argumentin e vet.

1 Thuajse të gjitha provat materiale të cituara nga ZPS-ja
2 në paragrafin 300 në dosjen e vet, në paragrafin 474, 482 të
3 dosjes sonë trajtohen plotësisht, kështu që këto dokumente nuk
4 do i shtjellojë në hollësi.

5 Megjithatë, sa i takon strukturës organizative - që do ta
6 gjeni në provën 3932, 3787.1 dhe P04083 - që citohen si në
7 paragrafin 300 dhe 301 të dosjes përfundimtare të ZPS-së, ne
8 ndjehemi të detyruar të theksojmë se ZPS-ja nuk ka bërë as
9 minimumin e mundshëm për të vërtetuar organizimet komplekse që
10 i ka përshkruar në ato tabela ato nuk kanë ekzistuar fare.

11 Në asnjë pikë të caktuar ZPS-ja nuk është përpjekur që
12 organigramat t'i lidhte me emrat, as nuk ka prodhuar prova për
13 të vërtetuar që këto organigrama ishin në realitet, pra, ishin
14 të vërteta dhe as nuk ka bërë asnjë përpjekje të mundshme për
15 të vërtetuar që z. Selimi ishte në krye të saj.

16 Pra, në paragrafët 301 dhe 300 jo vetëm që nuk jepet
17 informacion i saktë, por, sigurisht, që nuk mund të mbështetet
18 struktura e Ministrisë së Rendit Publik. Në veçanti listat e
19 punonjësve të pakontekstualizuara dhe pa datë në provën 03932
20 duket sikur janë në kontradiktë me saktësinë e përshkruar prej
21 tyre, ku pjesa më e madhe e punonjësve thjesht kanë qenë me
22 role gjenerike të përgjithshme si, për shembull,
23 "administrator". Dhe, në thelb, ata nuk kishin pikë lidhje me
24 komandantët e policisë.

25 Dhe mbështetshmëria e punonjësit të Ministrisë së Rendit

1 Publik të renditur në provën 03932 në vetvete është e
2 dyshimtë. ZPS-ja nuk vërtetoi se kishte departamente ose role
3 të renditura apo që kishte persona që kishin përshkrime pune.

4 Dhe, sigurisht, kjo është një çështje e cila të paktën
5 duhet t'i ishte ngritur Dëshmitarit W04758 dhe duhet t'i ishin
6 bërë pyetje lidhur me të.

7 Në mbështetje të pretendimit në paragrafin 300 që ishte
8 ngritur një komision strehimi që ishte në varësinë e z.
9 Selimi, ZPS-ja citon një letër që është P02372.

10 Ju kërkoj ndjesë përkthyesve jam shumë shpejt.

11 Atëherë, ZPS-ja asnjëherë nuk e ka çuar asnjëherë përtej
12 këtë pretendim përveçse e ka ngritur në fjalë, por nuk e ka
13 mbështetur në asgjë. Nuk ka asnjë referencë për një komision
14 të tillë në organigramat që sipas ZPS-së janë të mbështetshme
15 dhe të bazuara. ZPS-ja nuk është përpjekur fare që të provonte
16 që Ministria e Rendit Publik e drejtuar nga z. Selimi ishte
17 një strukturë që kishte mundësi të ushtronte kontroll operativ
18 mbi një forcë policie në mbarë vendin. Për rrjedhim, ky
19 argument i Mbrojtjes nuk qëndron dhe është tërësisht i
20 pambështetshëm.

21 Atëherë sa i takon autoritetit të pretenduar të z. Selimi
22 që ai ka pasur mundësi që të ushtrojë kontroll operativ ose që
23 të drejtojë, të udhëzojë veprimet e të tjerëve.

24 Të hënën e kësaj jave në transkript në faqen 28419 dhe
25 28485, Prokurori diskutoi dekrete të ndryshme të Qeverisë së

1 Përkohshme. Përsëri, përmes provave jogojore ka parashtruar
2 shembuj të kufizuar të dekretëve qeverisëse të Qeverisë së
3 Përkohshme, disa prej të cilave janë edhe pa datë dhe të
4 panënshkruar sikurse e kemi referuar disa herë në dosjen tonë.
5 Mungesa e këtyre dokumenteve është një lloj dëshmie që nuk
6 ekzistonte një strukturë e mirëorganizuar e Ministrisë së
7 Rendit Publik.

8 Në gjykime të tjera, që janë gjykuar të akuzuar të tjerë,
9 është theksuar se ligjet për sa i takon strukturave që kanë
10 funksionuar janë shumë të rëndësishme për të përcaktuar se
11 çfarë lloj autoriteti ka pasur i akuzuari. Dua që ta referoj
12 Panelin tek çështja e TPNJ-së Boskoski, dhe më konkretisht dua
13 që t'i tërheq vëmendjen të lexojë paragrafët 498 dhe 517 të
14 aktgjykimit të ICTY-së. Këta paragrafë në rastin e fundit
15 theksojnë faktin që Trupi Gjykses duhet që të dëgjojë
16 dëshmitarë të shumtë në mënyrë të tillë që të sqarojë ose të
17 mbushë hendeqe të dukshme informacioni.

18 Në këtë rast në këtë çështje nuk u dhanë as shembuj të
19 ligjeve të ngjashme dhe nuk u pyetën as dëshmitarë të tjerë,
20 në mënyrë të tillë që të konfirmojnë ose të vërtetojnë se
21 çfarë rolesh kishte pasur aktualisht z. Selimi. Ndërkohë si në
22 çështjen Boskoski edhe një çështje tjetër të ICTY -së janë
23 shqyrtuar kompetencat formale të të akuzuarit.

24 Ndërkohë që dokumenti që ZPS-ja ju ka dhënë juve, të
25 nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, nuk portretizojnë asgjë që

1 kanë të bëjnë me qëndrimin e klientit tim.

2 Për më tepër, duke pasur parasysh kontekstin unik në të
3 cilin Qeveria e Përkohshme ka lindur dhe në të cilin ka
4 funksionuar ajo, nuk mund të deduktohet që Ministria e Rendit
5 Publik ka funksionuar si një ministri e strukturuar, e
6 disiplinuar dhe shumë e rregulluar dhe që ka pasur struktura
7 të plota ose mbështetëse të qeverisë. Nuk ka shembuj të asaj
8 kohe që mund të përdoren si analogji. Kështu që nuk mund të
9 prezumohet pa pasur prova të mbështetshme që ministri kishte
10 autoritet operativ mbi policinë dhe ishte në qëndrim të tillë
11 që të udhëzonte policinë që të bënte veprime të caktuara ose
12 që lejohej me ligj që të bënte diçka të tillë.

13 Tani do të kaloj tek pjesa e urdhrave, tek elementi i
14 urdhrave.

15 Ju lutem për një çast mendoni se sa e rëndësishëm është
16 roli i shefit operativ të policisë së një vendi. Edhe në një
17 situatë jashtë konfliktit në Kosovë në qershor të 1999-s, kjo
18 do të ishte një detyrë herkuliane. Minimalisht do të kishim
19 pritur të shihnim urdhra, udhëzime që të buronin prej këtij
20 komandanti operativ drejtuar vartësve, por s'kemi parë asnjë
21 të tillë. Asnjë shembull të ndonjë urdhri, ndonjë udhëzimi, në
22 asnjë moment, asnjë policie në asnjë zonë të Kosovës, as nuk
23 është lëshuar nga z. Selimi, as në emër të z. Selimi.

24 I vetmi dokument që ZPS-ja konsideron një urdhër është
25 një komunikatë e lëshuar në emër të z. Selimi më 14 qershor të

1 1999-s, konkretisht është prova 515.69. ZPS-ja nuk ka thirrur
2 një dëshmitar të vetëm që ta njohë këtë dokument. As nuk kemi
3 ndonjë precedent. Edhe formulimi është kaq i vagullt dhe asgjë
4 në përmbajtje nuk tregon që pushteti i shefit të policisë të
5 UÇK-së i ishte transferuar ministrit të rendit publik.
6 Dokumenti është trajtuar tërësisht në paragrafin 459 të dosjes
7 sonë, dhe ju lutem, nuk mund ta konsideroni këtë dokument si
8 një urdhër, as nuk i afrohet një urdhri sepse ku dokument nuk
9 tregon që z. Selimi të ketë pasur kontroll apo autoritet
10 operativ.

11 I vetmi dëshmitar që ka thirrur ZPS-ja që pretendoi se
12 kishte dijeni për urdhra specifike të lëshuar prej z. Selimi
13 në cilësinë e ministrit të rendit publik ka qenë Dëshmitari
14 W04748 që është përshkruar nga vetë anëtarët e familjes si
15 gënjeshtar, një person që nuk ka qenë as në UÇK në atë kohë, e
16 jo më tej të ketë qenë në ministrinë e brendshme. Ai kishte
17 një injorancë totale se si ka funksionuar UÇK-ja asokohe. Një
18 person që në mënyrë krejt të pabazë ka pretenduar se ka pasur
19 një njeri për marrëveshje të fshehta mes KFOR-it dhe policisë
20 dhe pavarësisht spekulimeve të tij lidhur me urdhrat e lëshuar
21 prej z. Selimi, ai e pranoi gjatë kundërpyetjeve se nuk kishte
22 pasur dijeni personale në lidhje me ndonjë urdhër të marrë
23 prej policisë në verën e 1999-s, e më konkretisht ai nuk
24 kishte asnjë njohuri që komandantët e zonave të kishin marrë
25 urdhër nga ministri i rendit publik. Ju lutem shikoni

1 paragrafët 520, 521 të dosjes sonë dhe 527, 536.

2 Tani të flasim për raportimin.

3 Ju lutem, edhe një herë, kini parasysh se sa i madh është
4 roli që pretendon ZPS-ja se e paska pasur z. Selimi, shefi
5 operativ i policisë së një shteti në Kosovën pas konfliktit,
6 në verën e 1999-s. Do pretendonim të shihnim të paktën raporte
7 nga kjo zyrë. Por, ne kemi parë tërësinë e provave të
8 supozuara të ZPS-së në një slide të vetëm të martën,
9 konkretisht në transkript 28522. Dokumenti në P01539, është
10 përshkruar nga Prokurori në vetvete si një ankesë. Ky nuk
11 është raport. Kaq është. Një letër e një komandanti rajonal që
12 i ankohet Shtabit të Përgjithshëm për rendin publik të
13 vendosur në dijeni dhe thjesht ka thënë "duam të kuptojmë më
14 mirë se si duhet trajtuar një ushtri". As nuk përmenden
15 ndalime, as keqtrajtime, as ndonjë nga akuzat të cilat janë në
16 aktakuzë. Nuk ka asnjë provë që z. Selimi të ketë pasur dijeni
17 për ngjarjet që po ndodhin asokohe në Karadak e jo më në vende
18 të tjera, e jo më të themi pastaj që i ka bërë apo i ka
19 udhëzuar ai. Dokumenti nuk ka referencë për ndonjë urdhër të
20 mëparshëm apo raport që të jetë shkëmbyer mes këtyre
21 personave. Pra, ky dokument, ta përdorim ne imagjinatën sa të
22 dëshirojmë, nuk mund të jetë një raport operativ. Asnjë fjalë
23 në këtë dokument nuk tregon që të ketë pasur marrëdhënie të
24 mëparshme raportimi dhe siç e kemi diskutuar dhe në paragrafët
25 486, 489 të dosjes sonë, ne nënvijëzojmë që ZPS-ja nuk e ka

1 vërtetuar se kjo letër të jetë dërguar apo të jetë marrë nga
2 z. Selimi në 1999, pavarësisht se ku është gjetur kjo letër 20
3 vite më pas.

4 Shohim paragrafin 301 të dosjes së Prokurorisë, aty do të
5 kuptoni se si ZPS-ja ka pranuar në heshtje dobësinë e provave
6 të veta sa i takon raportimit dhe në mënyrë të shtrembëruar
7 pretendon se ky raport i është dërguar Ministrisë së Brendshme
8 nga komanda e policisë së UÇK-së/Ministria e Punëve të
9 Brendshme në verën-vjeshtën e 1999-s, dhe përdorin provën
10 2384, 3956, 3960, 3959 dhe provën 3954.

11 Nga pikëpamja e periudhës kohore është e saktë, por
12 mënyra se si duhet t'i referohen provave nga tetori i 1999-s
13 në kontekstin e kësaj çështjeje, është të themi që është
14 "jashtë periudhës së aktakuzës". Tri provat materiale që kanë
15 datën e nëntorit 1999 duhet të përshkruhen nga Prokurori, siç
16 e bëri Prokurori të hënën, "goxha kohë pas periudhës së
17 aktakuzës". Shiko me transkriptin në faqen 28421 në lidhje me
18 këtë.

19 Një hollësi tjetër që është në paragrafin 301 të dosjes
20 së Prokurorisë është fakti që asnjë prej këtyre dokumenteve
21 nuk është dërguar nga UÇK-ja, sepse ishte shpërbërë në javët
22 apo muajt përpara, por ka ardhur TMK dhe TMK-ja nuk është fare
23 pjesë e argumenteve të ZPS-së. Fakti që aty është përmendur
24 "policia e UÇK-së/Ministrisë së Punëve të Brendshme" në këtë
25 paragraf, pikërisht ilustron se sa i mjegullt është ky term

1 dhe se si e përdor ZPS-ja këtë term. Këto dokumente tërësisht
2 irelevante pas periudhës së aktakuzës nuk mund të pretendohen
3 prej ZPS-së se janë prova.

4 Një pikë të fundit në lidhje me këtë pikë. Formularët,
5 kartat e identifikimit edhe mjetet e letërnjoftimit dhe
6 formularët që ka përdorur ZPS-ja. Prokurori në mënyrë të
7 vazhdueshme ka folur për formularë, letërnjoftime dhe
8 fotografi të përmendura në paragrafin 302 të dosjes së vet dhe
9 thonë që kjo është një provë e fortë për të vërtetuar
10 argumentet tona. Argumenti ynë për këto dokumente
11 administrative, është i shtjelluar në paragrafët 509, 521, të
12 dosjes sonë dhe unë nuk dua t'i përsërisë të gjitha.

13 Po që të jemi të qartë sa u takon kartave identifikuese
14 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa pasur provat e
15 nevojshme për të vërtetuar se z. Selimi ka udhëzuar apo ka
16 urdhëruar veprimet e personave që i mbanin këto karta apo që i
17 raportnin atij, atëherë Prokuroria nuk mund të vërtetojnë
18 ekzistencën e tyre dhe nuk mund të thotë se ai kishte kontroll
19 apo autoritet operativ ndaj personave që i kishin këto karta.
20 Edhe kjo nuk e plotëson boshllëkun provues.

21 ZPS-ja flet për disa autorizime të disa kartave që janë
22 pranuar si prova gjyqësore, po këto autorizime nuk janë as
23 udhëzime, as urdhra për të vepruar lidhur me diçka. Këto
24 autorizime në vetvete që janë shumë të kufizuara nuk
25 përcaktojnë marrëdhënien epror-vartës apo ndonjë marrëdhënie

1 tjetër kontrolli midis z. Selimi dhe personave që i zotëronin
2 këto dokumente.

3 Nëse vlerësojmë argumentet e ZPS-së në raport me
4 standardet relevante, sipas nesh, Trupi Gjykues duhet të marrë
5 parasysh që e kombinuar mes mosparaqitjen e provave operative,
6 Trupi Gjykues gjithashtu duhet të ketë parasysh që ZPS-ja nuk
7 ka thirrur një person të vetme që e ka pasur këtë kartë që të
8 shpjegonte funksionin dhe rëndësinë e tyre, e jo më t'u
9 përgjigjet pyetjeve të thjeshta: A keni marrë ndonjë urdhër ju
10 prej z. Selimi, e a i keni raportuar atij? Nuk e bënë këtë
11 gjë.

12 Gjithashtu, është po ashtu e rëndësishme që Trupi Gjykues
13 të mbajë parasysh se nuk është vërtetuar lidhja nga ZPS-ja mes
14 lidhjes së këtyre kartave edhe krimet për të cilat ngrihen
15 akuzat.

16 Po ashtu dokumente të ndryshme të regjistrimit dhe disa
17 fotografi pasaportash, sikurse prova P04011, nuk e mbrojnë apo
18 nuk vërtetojnë argumentet e ZPS-së. Emrat dhe fotografitë në
19 këto dokumente nuk tregojnë se z. Selimi ka qenë personi që
20 drejtonte këta persona.

21 Po ashtu, të hënën Prokurori ju tha në faqen 28479, se
22 paragrafi 302 i dosjes së vet dhe dokumentet që citon në të
23 tregojnë se dokumentet administrative të Ministrisë së Punëve
24 të Brendshme përmbajnë shumë persona që kanë qenë të përfshirë
25 në krimet për të cilat ngrihen akuzat. ZPS-ja harron faktin se

1 shumica e këtyre krimeve pretendohet se kanë ndodhur përpara
2 se të formohet Qeveria e Përkohshme. Për ato që kanë ndodhur
3 përpara se të formohet Qeveria e Përkohshme nuk ka prova që z.
4 Selimi të ketë pasur dijeni për përfshirjen e pretenduar në
5 kryerjen e krimeve nga personat që renditen në paragrafin 302
6 në asnjë moment të periudhës së aktakuzës.

7 Ato pak emra që renditen për vendngjarjet ku kanë ndodhur
8 krimet, lidhja që bën ZPS-ja mes tyre dhe Ministrisë së Punëve
9 të Brendshme janë disa prova shumë të dobëta, për shembull,
10 citon disa fotografi pasaportash pa data në rastin e personave
11 që renditen në paragrafin 302(b) dhe (f) për të cilët nuk ka
12 asnjë lloj prove se si lidheshin këta persona me Ministrinë e
13 Punëve të Brendshme, nëse kishin ndonjë lidhje, dhe nëse ka
14 pasur ndonjë lidhje, deri në çfarë shkalle ka qenë kjo lidhje.

15 Apo marrim pikën (g), del emri i një personi në një listë
16 të padatë, pa kontekst të punonjësve të Ministrisë së Punëve
17 të Brendshme, është prova 3932 dhe në këtë rast nuk ka asnjë
18 provë kur dhe nëse ky person ka pasur lidhje me Ministrinë e
19 Punëve të Brendshme, dhe nëse ka pasur lidhje deri në çfarë
20 shkalle ka qenë kjo lidhje.

21 Tani duke marrë parasysh shembullin, shembulli i një
22 personi në këtë listë që ka kartë, një kartë identifikimi të
23 Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me nënparagrafin
24 (d) Selim Krasniqi, data e lëshimit të kartës është gati një
25 vit pas kryerjes së pretenduar të krimeve.

1 ZPS-ja nuk ka gjetur asnjë lidhje mes z. Selimi dhe
2 krimeve të kryera duke përdorur këtë dokument administrativ,
3 pavarësisht se ku i ka gjetur ZPS-ja këto dokumente. Po ashtu
4 nuk ka vërtetuar se z. Selimi ka pasur në dijeni se këta
5 persona pretendohet se kishin kryer krime, pavarësisht se
6 çfarë lidhje kishin këta me Ministrinë e Punëve të Brendshme.
7 Pra, Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë se z. Selimi ka
8 pasur kontroll operativ apo çdolloj kontrolli mbi policinë në
9 cilësinë e tij si ministër i rendit publik.

10 Do flas tani për temën e dytë, shënimet me shkrim dore.

11 Këtu duhet të kemi parasysh paragrafin 1485 të dosjes së
12 Prokurorisë dhe ne i kemi trajtuar po ashtu në dosjen tonë,
13 edhe është po ashtu shtjelluar nga Prokuroria në transkript në
14 faqen 28378, 28403. Ne, në paragrafët 434, 431, 440, 441 deri
15 në 445 të dosjes sonë, i kemi trajtuar disa prej këtyre
16 dokumenteve. Ato që nuk janë trajtuar në dosjen tonë sipas
17 nesh nuk janë fare, nuk duhet të lidhen fare me z. Selimi. Dhe
18 i kujtojmë Trupit Gjykses qëndrimin tonë që e kemi bërë të
19 qartë në paragrafin 77 të dosjes tonë lidhur me relevancën
20 shumë të kufizuar, thjesht për faktin një dokument është
21 gjetur në banesën e të akuzuarit.

22 Përpara se të trajtoj argumentin e ZPS-së, i lutem Trupit
23 Gjykses të shikojë një vendim që ka dalë në çështjen Haradinaj
24 i datës 27 shkurt 2012, ku Trupi Gjykses vlerësoi se
25 përpjekjet e Prokurorisë për të pranuar një ditar ku

1 pretendonte se përmbajtja ishte e z. Balaj. Dhe, sipas Trupit
2 Gjykues, ato nuk kishin bazë, ata thanë pavarësisht nëse Balaj
3 mund të jetë zotëruesi i këtij blloku shënimesh, në fakt, ky
4 dokument nuk mund të merret parasysh thjesht për përmbajtjen e
5 tij.

6 Në paragrafin 4, Trupi Gjykues tha:

7 "... ky bllok shënimesh është gjetur në dhomën e gjumit
8 të z. Balaj, në të njëjtën tryezë ku kishte dhe kartën e
9 identifikimit të UÇK-së ... ka emrin e tij, vendin,
10 datëlindjen dhe përmbajtja e bllokut ishte thjesht perspektiva
11 e z. Balaj ... dhe autori i referohej vetes si komandant i
12 njësisë speciale që në fakt përputhej me rolin që pretendohet
13 se kishte Balaj."

14 Këto argumente të Trupi Gjykues nuk ishin të mjaftueshme
15 për të vërtetuar standardin e besueshmërisë *prima facie* që
16 është më i ulëti dhe Trupi Gjykues doli në përfundimin në
17 paragrafin 17 dhe citoj:

18 "... Prokuroria nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar
19 autorin e ditarit edhe burimin e informacionit që gjendet në
20 të. Prokuroria parashtron se çështjet që trajtohen në këtë
21 bllok shënimesh përputhen me provat që janë pranuar nga Dhoma.
22 Sidoqoftë Dhoma e Apelit", flasim tani në rastin Limaj, citoj,
23 "konfirmimi nuk është as kusht as një garanci lidhur me
24 mbështetshmërinë e një prove të vetme."

25 Ndonëse ky vendim lidhet me pranimin e provave, ne

1 mendojmë se parimi që ka përdorur ky trup gjykues, edhe
2 vendimi i apelit që sapo përmenda, vlejnë edhe më shumë në
3 rastin tonë sa i takon peshës që duhet t'i jepni provës
4 përkatëse.

5 Tema tjetër është fakti që ZPS-ja nuk ka paraqitur prova
6 të mjaftueshme lidhur me këto blloqe shënimesh.

7 Praktika e ZPS-së qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe
8 të tërthortë gjatë gjithë gjykimit ka qenë që gjithmonë të
9 pretendonte se secili prej këtyre materialeve ishte i z.
10 Selimi, pra, ai ishte autor. ZPS-ja kishte shumë mundësi që ta
11 bënte të qartë dhe të diskutonte se cilin nga materialet që
12 citohet në dokumentin 1485 përpara se të kërkonte pranimin e
13 tyre. U kërkua të pranoheshin blloqe shënimesh përmes
14 mocioneve të provave jogojore pa asnjë provë shoqëruese.
15 Dëshmitarëve iu tregua faqja individuale në një mënyrë të
16 dyshimtë gjatë gjykimit, por pa u gjetur se kush ishte autori
17 i këtyre materialeve.

18 Praktika strategjike e Prokurorit, në fakt, është e
19 qëllimshme në mënyrë që ta linte Mbrojtjen pezull deri në
20 momentet e fundit të gjykimit, që Mbrojtja të gjendej në një
21 moment të vështirë që të mos dinte ç'të bënte me dokumentet në
22 fjalë dhe e vetmja gjë që përsërisnin, refreni i tyre ishte që
23 këto janë "sekuestruar prej z. Selimi".

24 Gjatë gjykimit, Prokurori ka bërë deklaratatë të qarta sa u
25 takon autorësisë së këtyre dokumenteve, por kjo ka ndodhur

1 sepse ka ndërhyrë Mbrojtja dhe jo se Prokuroria ka qenë
2 proaktive vetë për t'i vërtetuar argumentet e veta. Për
3 shembull, më 12 shtator 2023, në faqen e transkriptit 7760,
4 7764, një prokuror i tregoi një faqe të një blloku shënimesh
5 të sekuestruar prej z. Selimi Dëshmitarit W04255. Dhe kur
6 Mbrojtja u ngrit dhe nuk e pranoi autorësinë, ai tha
7 fillimisht:

8 "Nuk mund ta thërrasim ne autorin e dokumentit sepse në
9 këtë rast do kërkonim që të jepte dëshmi z. Selimi."

10 Në fakt, i njëjti Prokuror u tërhoq më pas dhe tha:

11 "Më falni, se mbase nuk fola siç duhet. Unë nuk thashë që
12 i ka shkruar Rexhep Selimi. Unë thashë u sekuestrua prej tij.
13 Është sekuestruar nga ZPS-ja sikurse është njoftuar në
14 metadatat për Mbrojtjen."

15 Ndonëse ky dokument përfundimisht nuk u pranua, por kjo
16 tregon qasjen e paqartë të Prokurorisë sa i takon autorësisë
17 së dokumenteve, pra, ne si Mbrojtje nuk mund të themi, nuk
18 mund të pranojmë që dokumentet që kanë shënimin "të
19 sekuestruar prej z. Selimi", janë domosdoshmërisht prodhim apo
20 produkt i z. Selimi. ZPS-ja në asnjë moment s'i ka bërë të
21 qartë argumentet e veta për autorësinë e materialeve që iu
22 atribuuan z. Selimi, pavarësisht se kur është marrë ky vendim
23 nga Trupi Gjykses dhe duhet të keni parasysh kjo mund të ketë
24 pasoja konkrete për personin.

25 Strategjia e kundërpyetjeve të dëshmitarëve, në fakt, për

1 shembull, ishte një nga refuzimet e ZPS-së për ta trajtuar më
2 tej autorësinë e materialeve pavarësisht se pati shumë mundësi
3 që të pyeste në lidhje me këtë. Qasja e paqartë e ZPS-së në
4 lidhje me këto shënime, në momentet e fundit të këtij gjykimi
5 u bë edhe më qartë në pretendimet e tyre të forta se fjalët
6 këtu janë të z. Selimi.

7 Po t'i kishim ditur këto akuza specifike gjatë gjykimit,
8 ne si Mbrojtje do të kishim pasur strategji tjetër gjatë
9 kundërpyetjeve tona dhe do të kishim bërë hetime të ndryshme
10 sa i takon argumenteve të ZPS-së, sepse në mënyrë materiale do
11 të kishte ndikuar në diskutimin që do të kishim bërë ne edhe
12 për mënyrën si do të kishim paraqitur provat. Këtu ne jemi
13 cenuar. Prokuroria gjatë gjykimit nuk ka bërë të qarta akuzat
14 e veta dhe kjo na ka penguar ne të bënim hetimet përkatëse.

15 Tani, përpara se të flas për paragrafë të tjerë në dosjen
16 e ZPS-së, dua të theksoj se si e ka përdorur ZPS-ja një
17 dokument konkret, bëhet fjalë për provën P01265.

18 Ne duam të vendosim në vëmendjen tuaj se sa shqetësuese
19 është kjo në lidhje me këtë dokument. Më 4 qershor 2024, në
20 fakt, në faqen e transkriptit 16625, 16626, një faqe, që
21 kishte ERN 00226545, një faqe, pra, nga një bllok shënimesh me
22 80 faqe iu tregua Dëshmitarit W04410.

23 Kur kundërshtoi Mbrojtja autorësinë dhe tha që nuk mund
24 ta vërtetoni autorësinë, Prokuroria tha dhe citoj:

25 "... nuk kemi thënë asnjëherë që e ka shkruar Rexhep

1 Selimi këtë bllok. Ne kemi thënë që është sekuestruar prej
2 shtëpisë së tij.”

3 E gjeni në transkript në faqen 16627.

4 Dhe kur kundërshtoi sërish Mbrojtja ata thanë, citoj:

5 “prova nuk e qartë në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër
6 se kush e ka shkruar, kjo është e vërtetë.”

7 Këtë mund ta gjeni në transkript në faqen 16628.

8 Të hënën Prokurori përsëriti fjalë të ngjashme apo
9 formulime të ngjashëm në transkript në faqet 28379, 28378.

10 Sidoqoftë, të shohim se si e kanë përdorur këtë dokument
11 në dosjen e tyre përfundimtare, pra, çfarë thotë dhe çfarë bën
12 ZPS-ja duket sikur janë dy gjëra të ndryshme, tjetër thotë e
13 tjetër bën. Në paragrafin 530 të dosjes, ZPS-ja pretendon se
14 z. Selimi ka mbikëqyrur policinë dhe shërbimet e zbulimit
15 sepse dinte rolet e tyre kryesore apo dinte rolet që kishin
16 oponentët e supozuar. Këtu kanë cituar, e kemi citimin në
17 poshtëshënimin 2185.

18 Dhe ky shënim është shkruar në vetën e parë dhe nuk i
19 referohet z. Selimi në vetën e tretë. Përndryshe nga çfarë i
20 thanë Trupit Gjykses dhe Mbrojtjes, mesa duket ZPS-ja në fakt
21 po përpiqet, që në një formë apo në një tjetër, të thotë që
22 autori i këtij shënimi është pikërisht z. Selimi.

23 Sërish në paragrafin 533, në poshtëshënimin 2196,
24 përsërisin të njëjtën praktikë, pretendojnë që z. Selimi është
25 takuar me komandantë të zonave për të diskutuar të

1 ashtuquajturën luftë speciale. Duhet të keni parasysh se këto
2 janë terma që janë kryesore në çështjet tona. Dhe kanë cituar
3 provën 01265. Dhe një herë po ju themi, shënimi përkatës është
4 në vetën e parë dhe nuk i referohet z. Selimi në vetën e
5 tretë, kështu që nuk mund të pretendohet se autori i këtij
6 dokument ka qenë z. Selimi.

7 Edhe më shqetësues është fakti se ky dokument është
8 përdorur në poshtëshënime dhe u janë referuar shënimeve nga
9 blloqe shënimesh ku ZPS-ja pretendon se janë shkruar prej z.
10 Selimi. Ju lutem shikojini me vëmendje paragrafët dhe
11 poshtëshënimet që sapo citova, dhe të keni parasysh se si ka
12 vepruar ZPS-ja dhe për faktin që e ka cenuar Mbrojtjen në
13 mënyrën se si i ka parashtruar argumentet e veta.

14 Dhe tani do flas për argumentet që gjenden në paragrafin
15 1485 të Prokurorisë.

16 Së pari, sa i takon pretendimit të ZPS-së në paragrafin
17 1485(i) se prova 1D00033 përmban nënshkrimin e z. Selimi, si
18 në lidhje me pikën (iv) ku thuhet "përputhshmëri të
19 përgjithshme në mënyrën se si është përdorur shkrimi në të
20 gjitha blloqet e shënimeve", ne mendojmë se këto janë çështje
21 që duhet t'i analizojë kriminalistika dhe ZPS-ja nuk ka
22 thirrur asnjë dëshmitar që të ketë mundësi ta bëjë një analizë
23 të tillë.

24 ZPS-ja nuk ka thirrur një dëshmitar fakti më së paku, që
25 të identifikojë shkrimin e dorës apo nënshkrimet në këto

1 blloqe shënimesh, i cili është në gjendje të thotë që këto
2 janë të shkruara prej z. Selimi, dhe kjo është barrë e provës
3 në fakt. Barra e provës mbetet me ZPS-në. Mbrojtja e ka bërë
4 disa herë të qartë përveç kundërshtimeve të vazhdueshme që të
5 mos pranoheshin këto blloqe shënimesh, qoftë e kemi bërë me
6 gojë, qoftë përmes mocioneve tona sepse e kemi kontestuar
7 autorësinë e këtyre dokumenteve.

8 Ju lutem kini parasysh konstatimin e Trupit Gjykses të
9 aktgjykimit Oric, paragrafi 64, lidhur me konstatimet që janë
10 bërë -- kontestimet lidhur me autenticitetin e shkrimit me
11 dorë:

12 "Prokuroria duhet të vërtetojë autenticitetin e të gjitha
13 dokumenteve që pretendohet se janë nënshkruar qoftë nga
14 Hamdija Fejzic apo nga Hamed Salihovic që i kundërshton
15 Mbrojtja. Për këtë qëllim, sidomos për faktin që janë njoftuar
16 edhe paragjykimit se do të kishte kundërshtime në lidhje me
17 autenticitetin, Prokuroria duhet të kishte paraqitur të gjitha
18 provat e nevojshme për të vërtetuar autenticitetin e këtyre
19 dokumenteve."

20 Siç e kemi thënë në dosjen tonë përfundimtare në
21 paragrafin 441, ZPS-ja kishte mundësi të thërriste ekspertë
22 lidhur me shkrimin e dorës sepse kjo është një praktikë që
23 është kryer rëndomtë në shumë gjykime të tjera ndërkombëtare.
24 Rasti Popovic, Milutinovic, Oric. E shumë e shumë të tjera.
25 Duhet të kishte thirrur, pra, një dëshmitar ekspert, duhet ta

1 kishin thirrur, pra, duke ditur se nuk kishin një dëshmitar
2 fakti më së paku që të bënte këtë vërtetim.

3 Dhe e çuditshëm është se të hënën Prokurori u kthye vetë
4 në ekspert edhe deklaroi në lidhje me P01265 se vetë ZPS-ja
5 kishte vendosur jashtë mureve të sallës së gjyqit që shkrimi
6 në fakt nuk dukej si konsistent, nuk përputhej sipas tyre edhe
7 ata kishin vendosur që për këtë dokument nuk do t'ia
8 atribuonin autorësinë z. Selimi.

9 Më pas, Prokurori ju nxiti të reflektoni bazuar në të
10 njëjta parashtrime të pacituara në dosjen e tyre, në
11 paragrafët 1485(iv) që të shqyrtonin blloqet e tjera dhe të
12 dilnin në përfundimin se "mënyra si është shkruar" e disa
13 shënimeve në fakt përputhet me disa prova të tjera materiale
14 dhe ju të dilni në përfundimin se autori i tyre ishte z.
15 Selimi. Lexoni transkriptin 28403.

16 ZPS-ja s'mund t'i bëjë këto argumente as gjatë gjykimit,
17 e jo më tej në dosjen e tyre përfundimtare dhe në argumentet
18 përfundimtare. Për këtë duhet të vinte një ekspert i
19 kriminalistikës. Ideja që vetë ZPS-ja vepron vetë si dëshmitar
20 dhe i kërkon Trupit Gjykues ta bëjë vlerësimin po ashtu si
21 ekspert pa ndihmën e një eksperti është absurde. Kjo nuk ka
22 themelësi dhe duhet rrëzuar në tërësinë e vet.

23 Qoftë edhe për hir të argumentit, pavarësisht se i bëmë
24 të gjitha parashtrimet tani, nëse Trupi Gjykues do të pranonte
25 se nënshkrimi i materialit 00333 i përket z. Selimi, një

1 nënshkrim i vetëm në një faqe në një material prej 38 faqesh
2 nuk tregon autorësinë e tërë bllokut të shënimeve, dhe madje
3 duhet të ketë pikëpyetje pse një person ka nënshkruar një
4 shënim të vetëm në bllokun e tyre personal, siç pretendon se
5 ka ndodhur ZPS-ja në dosjen 1D00033.

6 Mbrojtja nuk e pranon që ZPS-ja ka vërtetuar se blloku i
7 shënimeve që pamë në videon P01221 është i ngjashëm me atë që
8 keni parë në provën P00182. Por qoftë edhe për hir të
9 argumentit, nëse Trupi Gjykses del në përfundimin se janë të
10 njëjtë, ZPS-ja nuk e ka vërtetuar se cilëve prej shënimeve në
11 këtë bllok shënimesh prej 65 faqesh është shkruar prej z.
12 Selimi. Dhe ju lutem Trupit Gjykses të analizojnë provat dhe
13 të dalin në përfundimin se autorësia e tërë dokumentit nuk
14 mund t'i atribuohet një personi të vetëm.

15 Në dosjen tonë përfundimtare dhe siç u tha nga Prokuroria
16 të martën, ne evidentuam një gabim që në fakt kërkon që të
17 hiqet një referencë në paragrafin 445 në lidhje me provën
18 P00182, ku kishim thënë që nuk i është treguar asnjë
19 dëshmitari. Ky paragraf supozohej t'i referohej një faqeje
20 konkrete nga materiali P00182 që citohet në dosjen paraprake
21 të ZPS-së, poshtëshënimi 401 ku pretendoj se z. Selimi ishte
22 konsultuar me komandantët e zonave për ndalimet.

23 Faqja në fjalë me ERN 226414, në fakt, nuk iu tregua
24 asnjë dëshmitari gjatë gjykimit dhe si e tillë nuk e vërteton
25 argumentin që është parashtruar në dosjen paraprake të ZPS-së

1 dhe as nuk vërtetohet pretendimet përkatëse që janë parashtruar
2 në dosjen përfundimtare. Po në lidhje me tërësinë e provës 182
3 qëndron pika e përgjithshme, ZPS-ja nuk ka arritur të
4 vërtetojë se z. Selimi është autori i dokumentit.

5 Në lidhje me pikën (iii) të paragrafit 1485, argumenti i
6 ZPS-së në lidhje me emrin e z. Selimi në disa faqe të
7 materialit 182 dhe 3781.2, apo të një personi me të njëjtat
8 iniciale në dokumentin 1D000033, nuk mund të përdoret si provë
9 për autenticitetin apo autorësinë e tij. Thjesht fakti që një
10 person ka marrë pjesë në takime nuk do të thotë që është
11 autori i blloqeve të shënimeve apo pjesëve të caktuara në
12 blloqe shënimesh.

13 Gjithashtu, theksojmë se referencat që ka cituar ZPS-ja
14 në këto shënime janë shkruar në vetën e tretë, i njëjti kriter
15 që është përdorur mesa duhet nga ZPS-ja për të vendosur në
16 mënyrë arbitrare se prova P01265 në fakt nuk i atribuohet z.
17 Selimi.

18 Lidhur me referencat që ngelin në pikën (iii) të
19 paragrafit të 1485, poshtëshënimi 6269, ZPS-ja nuk ka
20 vërtetuar përmes krahasimit të referencave me provat materiale
21 të tjera se z. Selimi është autori i secilës prej këtyre
22 shënimeve në bllok shënimesh të cilin ata e përdorën, dhe
23 referencat e përdorura përmes dokumentit të tjera mbi të cilat
24 ata mbështeten nuk vërtetojnë autorësinë e tërësisë të bllok
25 shënimeve të cilat janë marrë.

1 Përpara se të kalojmë tek pika tjetër lidhur me këtë
2 temë, vë në dukje poshtëshënimin 6269 prova 181, P01264, libër
3 ky i shkruar nga Dëshmitari 4410.

4 Siç e thamë në paragrafin 442 dhe 444 të dosjes sonë
5 përfundimtare, ne kundërshtojmë se z. Selimi ka marrë pjesë në
6 takimin i cili të ketë ndodhur, dhe përmendet në P00181, si
7 dhe pretendimin se këto shënime janë -- ai është autori i
8 tyre. ZPS-ja nuk ka vërtetuar përmes dëshmisë së 4764,
9 dëshmitarit, pra, se z. Selimi ishte i pranishëm edhe pse kjo
10 përmendet disa herë në këto shënime. Dëshmitari 4758
11 gjithashtu kundërshton këtë pretendim në mënyrë të
12 drejtpërdrejtë. Prova është P00187 dhe ky libër i cili përmend
13 këtë takim nuk e rendit z. Selimi në mesin e pjesëmarrësve.
14 ZPS-ja nuk e ka trajtuar pse dëshmia e 4410 duhet të pranohej
15 duke patur parasysh burimet e shumta që në mënyrë të
16 drejtpërdrejtë e kundërshtojnë atë.

17 Në fund, nuk do të harxhoj, shpenzoj shumë kohë duke
18 trajtuar paragrafin 1485. Në fjalinë hyrëse e cila përmban
19 rreshtin edhe "faqet të cilat nuk përmbajnë provë të
20 drejtpërdrejtë të autorësisë së z. Selimi", kjo fjali pranon
21 dobësinë thelbësore, themelore të provave dhe të argumentit që
22 në fillim.

23 Në këtë paragraf ZPS-ja ju fton që të vendosni që z.
24 Selimi kishte njohuri për përmbajtjen e bllokshënimeve nga
25 faqet e shumta të ndryshme të këtyre bllokshënimeve që nuk

1 janë paraqitur në asnjë moment në këtë sallë gjyqi, duke
2 argumentuar se ato përmbajnë "tregues se autori ka vepruar në
3 emër të Shtabit të Përgjithshëm", dhe se "temat janë të
4 nivelit të Shtabit të Përgjithshëm", dhe se "personi që është
5 regjistruar duke folur i drejton komentet e tij për Shtabin e
6 Përgjithshëm dhe përmbajtja është komunikuar nga/ose Shtabit
7 të Përgjithshëm".

8 Duke bërë një gjë të tillë, ZPS-ja ju ofron juve asgjë më
9 shumë sesa spekulimet e tyre dhe konjunkturën lidhur me këto
10 prova materiale dhe përsëri e paraqet dëshmitarin e fakteve
11 apo mendimit në çështjen e tyre. Këto janë argumente që
12 shërbejnë interesat e Prokurorisë dhe duhet të hidhen poshtë
13 në tërësi.

14 Tema përfundimtare, dhe është e shkurtër. Do të trajtoj
15 një përjashtim që tani Prokuroria dëshiron të heqë nga
16 rregulla 140.

17 Të hënë e kësaj jave, në transkript faqja 28453, 28454,
18 Prokurori i kërkoi Gjykatës që të mbanin parasysh
19 moskundërshtimet nga Mbrojtja lidhur me pranimin e deklaratave
20 të dëshmitarit sipas rregullës 153, 155 që sipas tyre përbejnë
21 mungesën e kundërshtimit të këtyre provave, pra, që vlejné të
22 tilla. Duke bërë një gjë të tillë Prokuroria pasqyroi
23 argumentet e gjetura në paragrafin 1408, 1409 të dosjes së
24 tyre, dhe argumentoi në favor të heqjes së përjashtimit të
25 parimit të gjykimit të drejtë të mirëpranuar, i cili gjendet

1 në rregullin 140(4)(a). Rregulla lexon që verdikti i fajësisë
2 nuk do të bazohet në vetëm apo në shkallë të gjerë në
3 deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka patur
4 mundësi ta marrë në pyetje.

5 Prokuroria parashtron në paragrafin 1409, se formulimi i
6 drejtpërdrejtë i kësaj rregulle mbështet argumentin e tyre dhe
7 se nuk mund të bëhet konstatim për dëm të shkaktuar, për dëm
8 në rastet kur Mbrojtja nuk ka kundërshtuar pranimin e
9 deklaratave, por pastaj menjëherë kundërshtojnë, janë në
10 kundërthënie me vetveten duke dhënë një shpjegim të ndërlikuar
11 të pakuptueshëm që keqinterpretojnë ligjin lidhur me mënyrën
12 se si formulimi i kësaj rregulle duhet të interpretohet. Dhe
13 kjo është e papranueshme.

14 Një çështje paraprake, në kontekstin e rrethanave
15 specifike sepse prova është pranuar lidhur me rrugën sipas
16 rregullës 155, sugjerimi i Prokurorisë se Mbrojtja hoqi dorë
17 nga mundësia për t'ju bërë kundërpyetje dëshmitarëve duke
18 moskundërshtuar pranimin e tyre, e sipas kësaj rregulle është
19 absurde. Në mënyrë konkrete rregulla e një dëshmitari kur
20 bëhet fjalë për dëshmitarët sipas rregullës 155 të cilët kanë
21 vdekur dhe për rrjedhojë nuk mund të japin dëshmi, argumentet
22 e ZPS-së janë të natyrës metafizike dhe përtej mundësive që ka
23 kjo Gjykatë. Asgjë më shumë nuk është e nevojshme të thuhet
24 lidhur me këtë argument të ZPS-së.

25 Dhe sa i takon argumentit në lidhje me rregullën 153,

1 Prokurori, citoj, se nuk ka asnjë jurisprudencë që mbështet
2 interpretimin e rregullës 140 sepse një jurisprudencë e tillë
3 apo autoritet nuk ekziston. Kjo është sepse argumenti është
4 ligjërisht apo juridikisht i gabuar dhe nuk ka mbështetje.

5 Në paragrafin 1409, poshtëshënimi 5194, ZPS-ja
6 keqinterpreteton paragrafin 20 të vendimit F03327, vendim i
7 këtij Trupi Gjykses që trajton heqjen dorë të tërthortë nga
8 rregulla 153 dhe 155 dhe perifrazon në mënyrë të pasaktë
9 konstatimin e Trupit Gjykses, citoj:

10 "Trupi Gjykses vlerësoi rëndësinë e marrjes parasysh nëse
11 pranimi i asaj që përbën një deklaratë sipas rregullës 153,
12 155, nuk u kundërshtua dhe në këtë rast nëse kjo përbën një
13 heqje dorë nga garancitë që parashihen nga rregulla 153, 155."

14 Në fakt, konstatimi i vërtetë dhe real dhe shumë më i
15 kufizuar ishte se Trupi Gjykses jo vetëm që mori parasysh
16 garancitë konkrete që parasheh rregulla 153 dhe rregulla 155
17 për heqjen dorë në rrethana të jashtëzakonshme në rastet kur
18 nuk ka kundërshtime për zbatimin e ligjit të përgjithshëm të
19 rregullës 138 në vend të ligjit special të veçantë pra lex
20 specialis të rregullës 153, 155.

21 Ngjashëm, ZPS-ja citoi në mënyrë të pavend dhe të padukur
22 vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
23 Ndryshe prej kodit penal të cilin ata përmendin, pranimi i
24 deklaratave të dëshmitarëve sipas rregullës 153, 155 në DHSK
25 nuk bazohet, nuk mbështetet në pëlqimin e dhënë vetëm nga

1 palët. Ky vendim i përket përfundimisht Trupit Gjykses, që
2 është gardiani kryesor i gjykimit të drejtë dhe që merr
3 parasysh kundërshtimet, në qoftë se ka, të palës që duhet të
4 përgjigjet.

5 Në kundërshtim me atë, me keqinterpretimin që bën ZPS-ja
6 të rolit që kundërshtimet e Mbrojtjes luajnë, kanë në procesin
7 e pranimi sipas rregullës 153, 155, kundërshtimet e Mbrojtjes
8 apo moskundërshtimet nuk janë vendimtare në vendimin për të
9 pranuar provat dhe ato nuk mund në mënyrë të arsyeshme të
10 konsiderohen si mundësi e qartë për marrjen për kundërpyetjet
11 që Mbrojtja mund t'i bëj dëshmitarit dhe nuk mund të
12 interpretohet që Mbrojtja ka hequr dorë nga kjo e drejtë.

13 Kundërshtimet e Mbrojtjes janë vetëm disa prej faktorë
14 relevantë për vendimin e Trupit Gjykses. Vendimi për pranimin
15 sipas rregullës 153 i provave në këtë gjykim, në paragrafët
16 39, 47, apo dhe shembuj të tjerë ku Mbrojtja nuk e kundërshtoi
17 pranimin e provave që përmbushin kriteret e rregullës 153,
18 Trupi Gjykses megjithatë konstatoi në këto raste se ishte në
19 interes të drejtësisë që Dëshmitari W02586 të thirrej, sepse,
20 pa dëshminë e tij nuk mund të verifikoheshin provat apo të
21 konfirmoheshin ato të një viktime të vrasjes së paligjshme që
22 pretendohet që është në dosjen e lëndës.

23 Paragrafi 1409 i dosjes së Prokurorisë i referohet
24 moskundërshtimit nga Mbrojtja të deklaratave sipas rregullës
25 153, 155 dhe pretendon se këto përbëjnë që Mbrojtja hoqi dorë,

1 pra, nga mundësia për të marrë pyetje dëshmitarët. ZPS-ja
2 përpiqet që të fshijë veprimet e veta duke bërë dëshmitarët
3 sipas rregullës 153 të padisponueshëm për të dhënë dëshmi. Siç
4 është konstatuar në paragrafët 593, 598 nga aktgjykimi i
5 apelit të Shalës të cilin ZPS-ja nuk e citon, shqetësimi
6 kryesor për Trupin Gjykues se arsyet për mospraninë e
7 dëshmitarit vendimtar në këtë çështje ishte për faj të ZPS-së
8 dhe Trupit Gjykues.

9 Këto shqetësime mbeten edhe të njëjta për këtë Trup
10 Gjykues, pavarësisht faktit nëse Mbrojtja kundërshtoi apo jo
11 pranimin e deklaratave që mendohet apo pretendohet të jenë
12 sipas rregullës 153, 155. Është ZPS-ja, pala thirrëse, e cila
13 mori vendimin apo i bëri kërkesën e Trupit Gjykues për
14 mospraninë e dëshmitarëve dhe ky vendim përfundimisht është
15 vendim i Trupit Gjykues. Kundërshtimet e Mbrojtjes --
16 moskundërshtimet e saj për pranimin kanë patur një rol që nuk
17 është vendimtar në këtë proces. ZPS-ja është në dijeni të
18 marrëveshjes midis palëve, është në dijeni, një marrëveshje
19 midis palëve apo moskundërshtimi i dëshmisë së dëshmitarëve --
20 i pranimit të dëshmisë së dëshmitarëve sipas njërës apo
21 tjetrës rregull është thjesht pranim i provës dhe përmbush
22 standardin e ulët që zbatohet në rastin e pranimit të provave.
23 Nuk është pranim i heshtur apo pranim i krahasueshëm me
24 mosmarrjen në pyetje nga pala e kundërt.

25 Ne themi, qëndrimi jonë është formulimi i thjeshtë i

1 drejtpërdrejtë i rregullës 140(4) (a), i cili pasqyron nenin 21
2 të ligjit, në fakt, ka -- do të thotë se një verdikt fajësie
3 nuk mund të bazohet vetëm apo në shkallë të gjerë në
4 deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka patur
5 mundësinë atëherë ta marrë në pyetje. Kjo kërkon një
6 interpretim subjektiv më të gjerë siç e sugjeron -- nuk kërkon
7 interpretim më të gjerë siç përpiqet të thojë ZPS-ja.

8 Përfundimisht, për të përfunduar, gjatë gjithë këtij
9 gjykimi dhe në veçanti në dosjen përfundimtare, ZPS-ja ka
10 përdorur prova dytësore që kanë që burojnë nga disa dokumente
11 të sekuestruara nga z. Veseli, pasi të dyja fjala si mburojë
12 dhe si armë. Përdoret si armë për të mbuluar boshllëqet dhe
13 mangësitë në provat e tyre dhe si mburojë për t'u mbrojtur nga
14 përgjegjësitë që kanë për të përmbushur standardet që kërkohen
15 në paraqitjen e provave të Prokurorisë në këtë rast.

16 Kjo është thjesht retorikë? Kjo nuk është thjesht
17 retorikë nga ana jonë. Ajo që del nga dosja e Prokurorisë,
18 deklarata hyrëse, dokumentacioni i çështjes, paraqitja e
19 provave jогоjore, dosja përfundimtare është thjesht që ZPS-ja
20 përpiqet që të bëjë gjithçka - dhe kjo gjendet në transkriptin
21 28522 - dhe fjalët e tyre përfundimtare, Prokurori tha:

22 "Rexhep Selimi nuk mund t'i ikë materialeve që janë në
23 posedim të tij ..."

24 Rexhep Selimi nuk është në gjykim sepse ka patur
25 materiale në posedim dhe asgjë nga këto lidhur me këtë fakt

1 nuk e çliron ZPS-në nga paraqitja e provave të tyre përtej dhe
2 vërtetimi i tyre përtej dyshimit të arsyeshëm për të gjitha
3 aspektet materiale, diçka që Prokuroria nuk ka arritur të bëj.

4 Ju falënderoj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 [Përkthim] Mund të filloni.

7 Z. MAIR:[Përkthim] Faleminderit.

8 Unë kisha në mend që t'ju drejtohesha juve, të nderuar
9 Gjykatës, lidhur me dështimin e Prokurorisë për të vërtetuar
10 akuzat e tyre për krime kundër njerëzimit, por duke patur
11 parasysh parashtrimet e Mbrojtësit të z. Thaçi të mërkurën, me
12 të cilat ne pajtohemi dhe që ju garantoj ishin shumë elokumente
13 dhe bindëse si gjithçka tjetër, nuk do të përdor kohën e
14 Gjykatës për të ripërsëritur ato.

15 Do t'iu referoja juve, Gjykatës, në dosjen tonë
16 përfundimtare paragrafët 1202, 1213 dhe parashtrimet tona me
17 shkrim, të cilat ne i mbështesim dhe qëndrojmë pas tyre.

18 Pika që doja të ngrija është të përsëris parashtrimet dhe
19 të përforcoj parashtrimet e ekipeve të tjera të Mbrojtjes
20 përpara meje duke ju kërkuar juve me shumë respekt që të bëni
21 një shqyrtim të hollësishëm të poshtëshënimeve të dosjes së
22 ZPS-së dhe konkretisht pjesën e krimeve kundër njerëzimit,
23 sepse kjo pjesë është e mbushur me referenca të shumta të
24 ngatërruara, ku ka referenca në disa raste duke përsëritur
25 qindra faqe, duke përmendur qindra faqe pa ndonjë referencë

1 konkrete për fakte, argumente, prova apo poshtëshënime që
2 citojnë në prova që mbështesin pretendimin mbi të cilin ata
3 mbështeten.

4 Parashtrimet e mia sot në vend që të përqendrohen -- në
5 fakt, do të përqendrohen në çështjen e çështjes ligjore apo
6 juridike të fillimit të konfliktit të armatosur sipas nenit 14
7 të Ligjit. Unë do të trajtoj në -- nuk do të trajtoj fundin e
8 konfliktit të armatosur. Ne qëndrojmë pranë parashtrimeve tona
9 në paragrafët 1173, 1193 të dosjes sonë.

10 Sa i takon fillimit të konfliktit të armatosur, siç është
11 për të thënë në dosjen tonë në paragrafët 1159, 1172, qëndrimi
12 jonë është se Prokuroria nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të
13 arsyeshëm ekzistencën e një konflikti të armatosur
14 jondërkombëtar përpara nëntorit 1998.

15 Si çështje paraprake, Prokuroria, në dosjen e tyre
16 përfundimtare, poshtëshënimi 56005, sugjeron se Mbrojtja ka
17 pranuar se konflikti i armatosur ka arritur pragun që kërkohet
18 të kritereve të intensitetit në fund të majit 1998, duke
19 cituar paragrafët 56110 të mocionit të përbashkët të Mbrojtjes
20 sipas rregullës 130. Ky është parashtrimi F3256.

21 Mbrojtja pranoi -- nuk e ka pranuar një gjë të tillë dhe
22 sugjeron ndryshe dhe që të mendohet një gjë e tillë i
23 shpërfill tërësisht standardet e ndryshme dhe themelore midis
24 mocionit që nuk ka prova në të kundër Mbrojtjes dhe asaj apo
25 që ka prova për të mbështetur një verdikt fajësie dhe

1 standardi që është shumë më i lartë i dyshimit të arsyeshëm që
2 Prokuroria duhet të arrijë.

3 Qëndrimi i Mbrojtjes në mocionin sipas rregullës 130
4 ishte i qartë. Nuk ka patur prova kundër Mbrojtjes të cilave
5 Mbrojtja duhej t'ju përgjigjej lidhur me konfliktin e
6 armatosur midis marsit dhe fundit të majit 1998 bazuar në këtë
7 standard të ulët. Një pohim i tillë është tërësisht i pavarur
8 nga standardi që duhet të zbatohet lidhur me ekzistencën e
9 konfliktit të armatosur tani në fund të kësaj çështjeje, dhe
10 këtë standard Prokuroria duhet ta përmbushë. Mbrojtja nuk ka
11 pranuar asgjë lidhur me këtë, dhe kjo nuk e heq barrën nga
12 Prokuroria që të vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të
13 armatosur, jashtë përtej faktit të pranuar lidhur me nëntorin
14 dhe deri më qershor, 9 qershor 1999.

15 Kthyer tek pika e parë, pra, standardi i konfliktit të
16 armatosur dhe organizata.

17 Ekzistenca e një konflikti të armatosur jondërkombëtar
18 kërkon që grupi i armatosur të jetë i përfshirë, "të ketë një
19 strukturë, një zinxhir komandues, rregullore të përcaktuara,
20 si dhe simbole të qarta të autoritetit". Anëtarët e saj nuk
21 duhet të veprojnë vetëm, por në përputhje me "standardet që
22 janë dominuese në grup" dhe të cilat i "nënshtrohen një
23 autoriteti të kreut të grupit". Këto kritere janë paraqitur
24 dhe konfirmuar në aktgjykimin e apelit të Tadic. UÇK-ja nuk
25 përmbush asnjë prej këtyre kritereve përpara nëntorit 1998.

1 Prokuroria përdor një paragraf të tërë në dosjen e tyre,
2 1308, që i kushtohet organizimit të UÇK-së, kryesisht duke u
3 mbështetur në fakte të shqyrtuara më parë dhe iu ka referuar
4 pjesëve të dosjes së Prokurorisë pa vërtetuar organizimin.

5 Shumë prej këtyre fakteve të shqyrtuara përpara nuk i
6 referohen organizimit të vetë UÇK-së, por përplasjeve apo
7 luftimeve, në një tentativë të dukshme për të treguar se UÇK-
8 ja ishte mjaftueshëm e organizuar për t'u përballur me forcat
9 serbe. Këto fakte, megjithatë, nuk përmbajnë asnjë fakt të
10 veçantë mbi mënyrën se si luftimet janë zhvilluar dhe shkalla
11 apo madhësia e tyre.

12 Gjithashtu, provat i referohen kryesisht veprimeve
13 mbrojtëse kundër sulmeve serbe apo përplasje të armatosura të
14 shkurtra. Sugjeron se individët që mbronin veten duke hapur
15 zjarr në një farë mënyre kjo mbështet ekzistencën e një
16 organizate.

17 Referencat e përdorura të brendshme nga Prokuroria janë
18 trajtuar nga Mbrojtja në pjesët III.A dhe III.B të dosjes sonë
19 dhe tregojnë se UÇK-ja ishte një grup në formim dhe ishte punë
20 e vazhdueshme. Provat dëshmojnë se gjatë pjesës më të madhe të
21 1998-s ka patur pak lidhje midis këtyre njësiteve dhe kishte
22 një lidhje shumë të dobët me Shtabin e Përgjithshëm. Dhe ju
23 referoj juve në paragrafin 96, 111, 114, 144 të dosjes tonë.

24 "Lidhje shumë e dobët", pra, kur themi këtë, shumë
25 ushtarë të UÇK-së, përfshirë komandantët nuk dinin as për

1 ekzistencën e Shtabit të Përgjithshëm apo anëtarëve të tyre.
2 Dhe konkretisht ju referoj te paragrafët 104 të dosjes tonë.
3 Vetë zonat ishin duke -- në zhvillim e sipër dhe për pjesën më
4 të madhe të paformuara, dhe të paktën kjo vlen për pjesën e
5 parë të vitit 1998. Dhe këtu ju referoj tek paragrafët 114,
6 117 të dosjes sonë. Kjo nuk është strukturë me zinxhirë
7 komandues. Kjo është një grumbullim njësitësh lokale,
8 njësitësh guerile në të vërtetë që veprojnë në mënyrë të
9 pavarur dhe horizontale pa ndonjë kohezion apo uniformitet.

10 Edhe brenda Shtabit të Përgjithshëm në këtë pikë kohore,
11 në këtë moment kohor, nuk kishte strukturë komanduese të
12 vërtetë dhe nuk kishte përcaktim të qartë të përgjegjësive. Ne
13 e kemi thënë këtë në paragrafin 129 të dosjes tonë. Shumë prej
14 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm ishin jashtë vendit dhe
15 lëviznin dhe nuk ishin së bashku në një vend.

16 Ajo që është më e rëndësishme është mungesa e provave se
17 Shtabi i Përgjithshëm në fakt kishte autoritet për të caktuar
18 detyra apo për të zbatuar urdhra. Lidhur me këtë nuk mund të
19 thuhet se kishte një kre të qartë të një grupi apo të cilit i
20 nënshtroheshin autoritetit, të cilit i nënshtroheshin
21 ushtarët.

22 Një tregues i organizimit, logjistika e mjaftueshme, të
23 cilën UÇK-ja nuk kishte gjatë pjesës më të madhe të 1998-s.
24 Dhe ne e kemi thënë këtë në paragrafët 185, 192 të dosjes tonë
25 duke treguar mangësitë në nivelin e armëve, logjistikës, dhe

1 nuk dua këtu t'i përsërisë këto parashtrime. Pra, kishte
2 mungesë të vazhdueshme të armëve dhe kryesisht ishin armë të
3 lehta.

4 Kishte gjithashtu mungesë të vazhdueshme dhe të qartë të
5 mundësive dhe mjeteve të komunikimit të cilat ishin të
6 kufizuara dhe kufizonin aftësinë për të koordinuar
7 operacionet, sulmet dhe kjo është në paragrafët 193, 198 të
8 dosjes tonë. Edhe njësitë individuale arritën të gjenin --
9 edhe në qoftë se njësitë individuale të caktuara kanë gjetur
10 mjete komunikimi, funksionimi i tyre ishte i kufizuar për
11 ndërprerjen e vazhdueshme, për shkak të ndërprerjes së
12 vazhdueshme të energjisë elektrike apo përgjimeve të mundshme.

13 Faktor tjetër, faktori tjetër është ai i të folurit të
14 faktit që kanë folur me një zë. Të nderuar, ju keni dëgjuar
15 parashtrime bindëse dhe thelbësore lidhur me mungesën e
16 provave lidhur me autorësinë e komunikatave dhe deklaratave.
17 Nuk dua t'i përsërisë ato. Po ju referoj te paragrafët 605,
18 619 të dosjes sonë. Duke patur parasysh provat që ka ky Trup
19 Gjykues, mungesa e provave përpara Trupit Gjykues lidhur me
20 kontekstin e këtyre shpalljeve publike.

21 Gjithashtu, nuk ka paqartësi në prova lidhur me
22 mekanizmin disiplinor brenda në gjykatën ushtarake e cila u
23 krijua vetëm në nëntor të vitit 1998. Dëshmitari W04264
24 shpjegoi se kishte komisione disiplinore në disa zona përpara
25 vendosjes apo krijimit të gjykatës kushtetuese. Ai nuk tha --

1 ai tha që jo të gjitha zonat kishin këto komisione të
2 krijuara. Dhe provat që keni ju nuk vërtetojnë një regjim të
3 sofistikuar, qoftë dhe fillestar, disiplinor që ishte krijuar.

4 Vetë provat e Prokurorisë bazuar në të, rregulloret e
5 Shtabit të Përgjithshëm nuk ekzistonin deri të paktën në
6 qershor të 1998 - kjo është në paragrafët 118, 119 të dosjes
7 sonë - ndërsa rregulloret disiplinore janë vetëm të vitit
8 1998. Dhe do ju referoja juve te prova P715.

9 Provat e kufizuara të pakta nuk vërtetojnë se rregulloret
10 ishin në fuqi përpara nëntorit 1998. Dhe shumica e
11 dëshmitarëve të cilët u pyetën lidhur me rregulloret ose
12 kishin dëgjuar për ekzistencën e tyre ose nuk kishin dëgjuar
13 fare. Dhe kjo mund të gjendet në paragrafët 162, 167 të dosjes
14 sonë.

15 Në tërësi, tentativa e brishtë e Prokurorisë për të
16 vërtetuar organizimin nuk përmbush standardin që kërkohet për
17 të vërtetuar një grup të organizuar të armatosur. Kjo nuk ka
18 vërtetuar strukturë, zinxhir komandues apo tërësi
19 rregullohesh. Nuk ka demonstruar, nuk ka vërtetuar se anëtarët
20 e UÇK-së respektonin "standardet që ishin në standardet e
21 grupit".

22 Nuk ka vërtetuar se anëtarët e UÇK-së i "nënshtroheshin
23 autoritetit të kreut të grupit".

24 Provat thjesht nuk vërtetojnë një organizatë të unifikuar
25 dhe që ishte në gjendje të organizonte sulme përtej atyre që

1 bënin për t'ju përgjigjur agresionit serb në momente të
2 caktuara të izoluara dhe akte dhune sporadike që neni 14(2) i
3 përjashton në mënyrë të qartë.

4 Në asnjë moment përpara nëntorit 1998 Prokuroria nuk ka
5 vërtetuar se organizimi i UÇK-së ishte mjaftueshëm i përparuar
6 dhe i organizuar. Për këtë arsye dhe vetëm për këtë arsye, ne
7 parashtrojmë se Trupi Gjykses mund të konstatojë se nuk kishte
8 konflikt të armatosur përpara nëntorit 1998.

9 Megjithatë, do të trajtoj shkurtimisht intensitetin e
10 konfliktit të armatosur. Prokuroria deklaron në dosjen e tyre
11 se nga marsi 1998 luftimet midis forcave serbe dhe UÇK-së
12 kishin qenë "të vazhdueshme" dhe përfshinin, dhe ka përdorur
13 disa fjali të tilla si "veprime armiqësore të shkallës së
14 lartë", "bëtaja të hapura", për ta përshkruar atë që ata
15 pretendojnë ishte konflikt i armatosur. Kjo duket intensive
16 por deri në momentin kur shihen provat që përdorën për të
17 mbështetur këtë.

18 Nuk do t'i trajtoj të gjitha në hollësi, por është e
19 nevojshme që ato të shqyrtohen me kujdes. Do t'i shihni që
20 provat nuk e mbështesin idenë e një konflikti të gjerë, por
21 kryesisht i referohen veprimeve serbe, sulme të njëanshme, siç
22 janë ato në Qirez, Likoshan dhe Prekaz. Për shembull, fjalia
23 "veprime armiqësore të shkallës së gjerë" i referohet provave
24 të Christopher Hill i cili flet për sulmin e serbëve ndaj
25 kompleksit të Jasharit që përshkruhet si "një shpërthim i

1 përplasjeve të mëdha" dhe kjo është në transkript 27661, por
2 nuk i referohet luftimeve të tjera.

3 Për sa i takon fjalisë "betejë e hapur", Prokuroria citon
4 P1747, një dorëshkrim i paautor në një ditar, e cila është
5 paraqitur si provë jогоjore dhe i referohet thjesht sulmeve në
6 Qirez apo Likoshan si "luftë e hapur" dhe nuk përmend ndonjë
7 konflikt të gjerë.

8 Masakra e Prekazit ka qenë e një shkalle të ndryshme nga
9 sulmet e mëparshme, në një zonë gjeografike të kufizuar, një
10 sulm asimetrik dhe nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar se
11 përplasjet në Kosovë kishin arritur këtë intensitet për të
12 përmbushur standardet në fjalë. Edhe sikur të shtojmë Qirezin
13 dhe Likoshanin në këto pjesë, analiza ngelet e njëjtë.

14 Përplasjet që kanë ndodhur pas Prekazit në muajt në vijim
15 janë luftime të vogla, incidente, në fakt, ku shpesh
16 përfshiheshin viktima të pakta si rezultat. Ju referoj tek
17 paragrafi 1166 për informacion të mëtejshëm.

18 Por nuk është vërtetuar në dokumentacionin e lëndës, ajo
19 që nuk është vërtetuar është frekuenca, shpeshtësia dhe
20 fushëveprimi apo shkalla e konfliktit në mars deri në maj, në
21 periudhën nga marsi deri në maj. Prokuroria i referohet
22 luftimeve të vazhdueshme në paragrafin 1310, por provat e tyre
23 nuk kanë ndonjë detaj, hollësi lidhur me sesi luftimet janë
24 bërë në mënyrë të përditshme.

25 Kjo është thjesht duke iu referuar hollësive të tilla si

1 vendndodhja, shpërndarja e luftimeve, numri i personave të
2 përfshirë, armët e përdorura. Dhe Trupit Gjykues nuk i është
3 dhënë asnjë mundësi apo bazë për të përjashtuar se luftimet e
4 përdorura në këtë kontekst kanë qenë thjesht shkëmbim zjarri,
5 që kanë zgjatur ndoshta disa minuta dhe kjo nuk e përmbush
6 standardin në fjalë, janë akte sporadike dhe intensiteti,
7 kriteri i intensitetit është përjashtuar.

8 I nderuar Gjykatës, po shoh më ka ngelur pesë minuta për
9 të vazhduar.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni dhe të mbaroni.

12 Z. MAIR: [Përkthim] Tentativa e shkurtër, përpjekja e
13 shkurtër e Prokurorisë për të përshkruar dhe dy ngjarje të
14 tjera në këtë periudhë kohore vetëm e provon të kundërtën e
15 asaj që ata pretendojnë. Paragrafi 1314, për shembull, i
16 referohet një beteje në prill, të ashpër, ku i referohet
17 kryesisht forcave serbe që ndërmarrin aksione apo bombardime.
18 Dhe ndonëse ka disa referenca për sulmet e UÇK-së apo
19 batalionet e policisë apo përplasje, ka fakte të pakta lidhur
20 me atë që në fakt ka ndodhur dhe sigurisht që kjo nuk e
21 vërteton se bëhej fjalë për një betejë të vazhdueshme dhe të
22 rëndë.

23 Ngjashëm, me paragrafin 1315, Prokuroria sugjeron se një
24 eskalim në maj, pra, "luftimet e vazhdueshme në gjithë
25 Kosovën" po citojmë. Por edhe këtu bëhet fjalë për një raport

1 serb për të shtëna zjarri në postblloqe apo kolona dhe ndoshta
2 një shkëmbim zjarri i shkurtër me viktima të pakta dhe kjo nuk
3 e mbështet pretendimin e Prokurorisë për luftime të gjëra në
4 gjithë Kosovën.

5 Do të ndalem këtu për të trajtuar, për të përmendur se
6 Prokuroria nuk i trajton konstatimet e mëparshme të Gjykatës,
7 e cila konstatoi se konflikti i armatosur duhet të arrijë
8 shkallën e intensitetit që kërkohet përpara majit 1998, ne e
9 bëjmë këtë përmbledhje në 2865, në paragrafin 2865 të dosjes
10 sonë. Provat mbi të cilat mbështetet këtu ZPS-ja për periudhën
11 mars-maj, në shkallë të madhe janë vlerësuar dhe janë hedhur
12 poshtë nga Dhomat e Gjyqit si përpjekje për të lëvizur, për të
13 ndryshuar periudhën kohore.

14 Për pjesën tjetër të periudhës kohore deri në nëntor të
15 1998-s, Prokuroria jep vetëm deklarata sipërfaqësore të
16 përgjithshme pa dhënë ndonjë hollësi me pretendimin se
17 Prokuroria ka keqinterpretuar, pra, nocionin se Mbrojtja
18 kishte pranuar këtë pikë. Kjo shpërfill se barra është e atyre
19 dhe ne themi se tërësia e provave që ka ky Trupi Gjykues nuk e
20 vërteton atë.

21 Tani dua të kaloj thjesht tek disa, në mënyrë të shpejtë,
22 tek disa faktorë të tjerë që tregojnë dhe vërtetojnë këtë
23 pikë. E kam trajtuar çështjen e personelit dhe të armëve,
24 pajisjes me armë në fillim të parashtrimeve të mia. Nuk do t'i
25 përsërisë ato për të thënë se UÇK-ja ishte një strukturë që

1 ishte në zhvillim e sipër duke u ndërtuar, duke u organizuar,
2 në përpjekje për të mbledhur dhe për të grumbulluar armë, por
3 kryesisht ishte me numër personeli shumë të kufizuar.

4 Ndërsa Prokuroria parashton në paragrafin 1322 të dosjes
5 së tyre, se UÇK-ja u bë e dukshme dhe në paragrafët 1323, se
6 kishte një ngritje apo shtim të numrit të rekrutëve në UÇK në
7 prill të 1998-s, kjo nuk tregon se sa individë në fakt ishin
8 në gjendje për të luftuar të cilët u përfshinë në përplasje të
9 vogla gjatë vitit 1998.

10 Dosja e Prokurorisë, paragrafi 1326, 1330, kur thotë
11 gjithnjë e në ngritje është qëndrim që nuk mbështetet nga
12 provat. Pjesa dërrmuese e provave të cilave ato i referohen
13 vijnë nga libra të paautentifikuar, nga ditarë, gazeta, pra,
14 janë të pakonfirmuara. Disa citime që ata përdorin nuk
15 mbështesin pretendimet e tyre fare. Për shembull,
16 poshtëshënimi 5670 i referohet faktit se UÇK-ja kishte në
17 posedim dhe përdorte armë të rënda duke iu referuar P2816, që
18 vetëm i referohet mitralozave të lehtë dhe murtajahedhësve.

19 Sa i takon aspektit njerëzor, nuk dua të minimizoj
20 humbjen e luftës, humbjet që kanë ndodhur për shkak të luftës,
21 humbjet njerëzore që kanë ndodhur në 1998, dhe të shpërfill
22 faktin se njerëzit janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre, dëbuar
23 nga ato, dhe kjo përmendet në paragrafin e dosjes së
24 Prokurorisë 1331, 1340 që është për pjesë më të madhe si
25 pasojë e veprimeve të njëanshme të serbëve që bombardonin dhe

1 shkatërronin shtëpitë, por kjo nuk tregon se një konflikt i
2 armatosur i shtrirë në kohë mes palëve ka ekzistuar në atë
3 kohë. Ndërsa Prokuroria hap paragrafin 1331 duke iu referuar
4 viktimave gjithnjë në rritje në të dyja anët, paragrafët në
5 vijim rendisin viktimat që janë kryesisht viktima të sulmeve
6 të serbëve.

7 Në paragrafin 1334, në fakt, i referohet UÇK-së, citon
8 dëmet e rënda të ndërtesave në mars dhe vetëm mars, duke
9 cituar tre prova: P4254, 1747, 4023. Megjithatë, kur i shikon
10 këto prova materiale këto tregojnë se dëmet janë shkaktuar,
11 dëmet që pretendohet të jenë shkaktuar nga UÇK-ja janë shumë
12 të vogla dhe bëhet fjalë vetëm për pak shtëpi.

13 Dhe tani, po kthehem në fund, tek faktori i fundit që
14 është vëmendja që i kushtoi Këshilli i Sigurimit. Prokuroria
15 në dosjen e tyre në paragrafin 1342, i referohet Këshillit të
16 Sigurimit dhe miratimit nga ai i Rezolutës 1160 në mars, në të
17 cilën ata nuk e kategorizuan situatën në Kosovë si konflikt i
18 armatosur. Prokuroria deklaroi se kjo gjë nuk është e
19 pazakontë dhe nuk tregon se si Këshilli i Sigurimit e ka parë
20 këtë çështje, duke cituar pastaj Rezolutën 1203, 1209, 1244,
21 të cilat po ashtu nuk e kanë përdorur fjalën "konflikt i
22 armatosur".

23 Përqendrimi i Prokurorisë megjithatë minohet menjëherë
24 dhe hidhet poshtë nga pranimi nga ana e tyre i drejtpërdrejtë
25 i rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1199, nga shtatori 1998,

1 i cili i referohet konfliktit të armatosur në Kosovë. E
2 përmend në mënyrë shumë të çuditshme Prokuroria, e citon këtë
3 rezolutë vetëm në pesë paragrafë më vonë në paragrafin 1347.

4 Megjithatë, në të njëjtën kohë duhet të shënohet se
5 përdorimi i gjuhës në paragrafin 1199, se Këshilli i Sigurimit
6 nuk e përsëriti formulimin në rezolutat e mëtejshme.

7 Pjesa tjetër e citimeve të Prokurorisë në paragrafët
8 1341, 1348 tregoi shqetësimin e vazhdueshëm të bashkësisë
9 ndërkombëtare për dhunën që po ndodhte në Kosovë, qëndrimi i
10 kuptueshëm që lidhur me sulmet, ashpërsinë e sulmeve të
11 forcave serbe në Kosovë, por përfundimisht kanë autoritet të
12 kufizuar lidhur me përcaktimin ligjor apo përkufizimin ligjor
13 të konfliktit të armatosur.

14 Të marra së bashku, provat e paraqitura nga Prokuroria
15 nuk vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se një konflikt i
16 armatosur ka ekzistuar përpara nëntorit 1998. Është e dobishme
17 që të shqyrtohet në hollësi kjo pikë sepse thekson dy aspekte
18 të rëndësishme. Së pari edhe këtu jemi përballë Prokurorisë, e
19 cila ka barrën e vërtetimit të pretendimeve të tyre pasi
20 provat tregojnë edhe një herë që ata nuk kanë arritur të bëjnë
21 një gjë të tillë. Së dyti, dosja përfundimtare e Prokurorisë
22 lidhur me konfliktin e armatosur është emblematike e gjithë
23 çështjes dhe provave të tyre. Ata nuk paraqesin, nuk marrin
24 parasysh asnjë provë kundërthënëse për teorinë e tyre dhe
25 bëjnë deklaratatë përgjithësuese të cilat shpesh mbështeten në

1 deklarata të gabueshme, të pasakta apo prova të cilat vetëm në
2 mënyrë të tërthortë mbështesin pretendimet e tyre në rastet
3 kur i mbështesin ato. Duke bërë ekstrapolime përtej fakteve që
4 në fakt ata tregojnë. ZPS-ja, megjithatë, këto boshllëqe nuk
5 janë plotësuar nga ZPS-ja dhe arsyetimet logjike të mangëta
6 paraqiten tanimë të qarta.

7 Me këtë përfundojmë parashtrimet tona, i nderuar
8 Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Mair.

11 Bëjmë gjysëm ore pushim.

12 --- Pauza fillon në orën 10.36

13 --- Seanca rifillon në orën 11.07

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
15 Sheremeti.

16 ZNJ. SHEREMETI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës,
17 kolegë të nderuar, qytetarë të nderuar që ndodhen këtu në
18 sallë dhe që na ndjekin nga shtëpia.

19 Duke u bazuar mbi parashtrimet e kolegëve, unë do të flas
20 sot lidhur me dëmin, viktimat dhe me masën e dënimit. Dhe
21 prandaj dua të filloj duke bërë një gjë shumë të qartë. Ne nuk
22 i qasemi kësaj çështjeje me shpërfillje ndaj rrëfimeve që ka
23 paraqitur Mbrojtësi i Viktimave, historitë e atyre të cilët
24 kanë ardhur para këtij Trupi Gjykues apo vuajtjet e grave,
25 nënave të cilat kanë humbur fëmijët e tyre. Nuk jemi ne të

1 tillë dhe nuk është ky qëndrimi ynë.

2 Pavarësisht që jemi në anën e kundërt të kësaj procedure
3 penale, ne jemi që të gjithë njerëz. Dhe ne e kuptojmë dëmin
4 dhe vuajtjet e atyre që kanë duruar. Megjithatë, pranimi i
5 këtij dëmi nuk do të ndryshojë detyrën themeltare të këtij
6 Trupi Gjykues që është për të përcaktuar, bazuar vetëm mbi
7 provat, nëse Prokuroria i ka provuar përtej dyshimit të
8 arsyeshëm që të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale për këtë
9 dëm.

10 Këto dy realitete nuk përjashtojnë njëri-tjetrin. Ne mund
11 të pranojmë vuajtjen ndërkohë që i qëndrojmë pozitës që këtë
12 nuk e ka shkaktuar z. Selimi.

13 Duhet të mos harrojmë që kjo ka ndodhur, këto ngjarje
14 kanë ndodhur në Kosovë pas viteve të represionit të popullatës
15 shqiptare nga autoritetet shtetërore serbe. Shqiptarët e
16 Kosovës janë privuar nga të drejtat themelore civile dhe
17 politike, janë përjashtuar nga jeta publike, i janë nënshtruar
18 arrestimit arbitrar dhe dhunës policore dhe janë shënjestruar
19 në mënyrë të përhershme përmes diskriminimit. Nga fundi i
20 viteve 1990 kjo përfundoi në luftë të hapur që shkaktoi
21 shpërngulje masive, shkatërrimin e shtëpive dhe dhunën ndaj të
22 gjithëve, kryesisht civilëve. Ky nuk ishte një konflikt
23 neutral. Shqiptarët e Kosovës vetë ishin viktimat e dhunës
24 drejtuar nga shteti që kanë jetuar në kanosje të përhershme
25 frike dhe mungesë të stabilitetit duke u përpjekur thjesht që

1 të shpëtojnë.

2 Megjithëkëtë, qëndrimi ynë është krejt shumë i qartë.
3 Vuajtja në luftë dhe opresioni sistematik nuk përjashton apo
4 zëvendëson provën ligjore. Nuk është e mjaftueshme që të
5 thuhet që ka pasur dhunë gjatë një periudhe të caktuar. Nuk
6 mjafton të thuhet që ka patur paraburgosje. Nuk mjafton të
7 thuhet që në shoqëritë pas një konflikti trauma është e
8 gjerësishme. Asnjë prej këtyre nuk tregon përtej dyshimit të
9 arsyeshëm që z. Selimi ka kryer krime apo që i ka urdhëruar
10 ato, ka kontribuar në mënyrë esenciale apo ka patur njohurinë
11 dhe kontrollin efektiv që të përbëjë edhe përgjegjësi të
12 komandantit.

13 Paraqitja nga ana e Prokurorisë e këtij dëmi është i
14 natyrës së përgjithshme dhe kumulative. I përshkruar në
15 efektet mbi të tërë shoqërinë, por nuk tregon një dëm i cili
16 të shkojë dhe të jetë si rezultat i sjelljeve, vendimeve apo
17 të autoritetit të z. Selimi. Megjithatë, ai tregon të gjitha
18 autoritete në shumë vende dhe një periudhë të caktuar dhe i
19 kërkon Trupit Gjykses që këtë ta shohë si një "model" dhe këtë
20 model të pretenduar ta tregojë si një pjesë të një plani
21 qendror për kontrollin e përqendruar.

22 Provat tregojnë, provat në fakt përbëhen nga episode të
23 qarta dhe dëmi jo të natyrës së përgjithshme dhe me kryes të
24 paidentifikuar. Kjo nuk është provë. Edhe po të ekzistojë një
25 provë, ajo duhet të ketë lidhje me një individ të caktuar dhe

1 jo me kategori të përgjithësuara si "anëtarët e UÇK-së".

2 Po të ketë patur një mënyrë veprimi koherente apo një
3 autoritet, një rrjet komandimi i cili të çonte në drejtim të
4 z. Selimi, atë do të kishte dalë nga provat. Dhe nuk ka
5 ndodhur një gjë e tillë.

6 Dosja përfundimtare e ZPS-së ka 24 impakte të viktimave.
7 Dhe dëmi i përshkruar tregon një dëm të cilin nuk duhet ta
8 kishte pësuar asnjë person. Megjithëkëtë asnjë prej këtij dëmi
9 nuk të çon tek z. Selimi. I vetmi rast kur përmendet z. Selimi
10 është në dëshminë e Dëshmitarit W04644. Dhe kjo përmendje e
11 shkurtër nuk ka të bëjë me dhunë, keqtrajtim apo ndonjë formë
12 të dëmit. Përkundrazi, dëshmitari përshkruan se si e ka parë
13 z. Selimi të ketë ardhur me një xhip dhe ta ketë shoqëruar
14 vjehrrin e dëshmitarit nga kjo skenë pa patur asnjë pretendim
15 të një abuzimi apo të ndonjë veprimi tjetër të gabuar. Edhe
16 kjo përmendje është thjesht si pjesë e shumë dokumenteve që
17 ndodhen në poshtëshënimin 2727, në faqen 386 të dosjes
18 përfundimtare të ZPS-së. Dhe kjo përmendje anësore nuk ka
19 lidhje me lëndimet psikologjike dhe fizike që përshkruhen
20 gjerësisht dhe që dëshmitari i atribuon individëve të tjerë të
21 paidentifikuar.

22 Mbrojtësi i Viktimave po kështu ka rrëfime shumë
23 emocionuese të cilat janë serioze dhe duhet të pranohen, por
24 megjithëkëtë nuk përmbajnë bazën ligjore apo lidhjen
25 individuale me krimet e aktakuzës.

1 Kur përmendi në mënyrë të drejtpërdrejtë Selimin,

2 Mbrojtja thotë që kjo është keqkarakterizim.

3 Në poshtëshënimin 306 nga Mbrojtësi i Viktimave dhe
4 pyetjet që i janë bërë W04444, ato, në fakt, e minojnë këtë
5 dhe në fakt e keqinterpretton të tërë çështjen.

6 Siç e kemi thënë në dosjen tonë përfundimtare,
7 paraburgosja e W04444 është e pranuar dhe ka lidhje me një
8 hakmarrje personale pa lidhje me UÇK-në apo krimin e
9 armatosur. Pyetjet që kemi bërë nuk kishin të bënin me hedhjen
10 poshtë të vuajtjes, por për të provuar atributin, kontekstin
11 dhe konsistencën, pikërisht kur nuk është identifikuar një
12 kryes specifik.

13 Duhet të mbajmë parasysh po kështu që viktima vetë e ka
14 pranuar se dëmi që ka pësuar ishte i ekzagjeruar.

15 Të nderuar Gjykatës, kundërshtimi i atribuimit nuk është
16 mohim i dëmit, por është një proces i drejtë. Në të njëjtën
17 kohë, Mbrojtësi i Viktimave tregon në mënyrë të papërputhshme
18 frikën ndaj UÇK-së dhe ndërkohë është e vërtetë që civilë t'i
19 jenë afruar anëtarëve të UÇK-së për t'i ofruar informacion pa
20 patur asnjë pasojë, siç e ka treguar edhe dëshmia e
21 Dëshmitarit W04594 në paragrafin 263. Ndërkohë që parashtrimi
22 i Mbrojtësit të Viktimave ilustron në mënyrë të fuqishme
23 vuajtjet e luftës, në fakt, gjatë gjithë kohës e
24 keqinterpretton atë si tragjedinë kolektive dhe e ngatërron atë
25 me përgjegjësinë kriminale personale.

1 Dhe Trupit Gjykues nuk i duhet të trajtojë çështjen nëse
2 ka patur vuajtje, por nëse ka prova për t'i lidhur këto krime
3 me z. Selimi në veçanti. Dhe prandaj Mbrojtësi i Viktimave
4 shfrytëzon ekspertët për të mbushur këto hendeqet e dëshmimeve.

5 Dhe dëshmitë e ekspertëve që ka paraqitur Mbrojtësi i
6 Viktimave nuk kanë arritur që të tregojnë lidhjen midis
7 krimeve dhe dëmit. Jo për shkak se ekspertët nuk ishin të
8 ndershëm. Jo për shkak se Mbrojtja deshi të mohonte traumën,
9 po për shkak se vetë ekspertët kanë shprehur mundësi, e kanë
10 në mënyrë të veçantë kanë folur lidhur me atribuimin,
11 diagnozën dhe me lidhjen në një farë mënyre dhe dëmin e kanë
12 paraqitur në kuadrin e tërësishëm të luftës në Kosovë dhe të
13 pasojës dhe jo duke paraqitur pretendime specifike para këtij
14 Trupi Gjykues.

15 Tani do të flas për tre limite apo kufizime strukturore
16 të cilat janë konfirmuar nga ekspertët.

17 E para, as nuk janë bërë ekzaminime mjeko-ligjore për
18 synimet ndaj ndonjë raporti. Ekspertët e kanë paralajmëruar
19 Mbrojtësin e Viktimave paraprakisht se pa vlerësimin
20 individual ata nuk mund të tregonin dhe lidhjen rrjedhimore.
21 Megjithëkëtë, Mbrojtësi i Viktimave vazhdoi edhe me këto
22 paralajmërime.

23 E dyta, pa patur intervista, ekzaminime, diagnoza,
24 ekspertët vetë e thanë se ishte e pamundur që të përcaktohej
25 nëse simptomat arrinin pragun diagnostifikues, nëse ato ishin

1 kushte ligjore të justifikueshme apo kishin lidhje me ngjarje
2 specifike. Raportet e diskutuara nuk kanë paraqitur
3 konkluzione mjeko-ligjore që të çonin në lidhjen midis dëmit
4 dhe aktorëve apo pjesëmarrësve të caktuar.

5 E treta, literatura ishte ndërlidhëse dhe jo shkakore.
6 Një nga librat mbi të cilin janë bazuar është një të cilin e
7 kam interpretuar unë, e kam shkruar vetë. Dhe këto studime për
8 traumën në Kosovë nuk mund të tregojnë lidhjen shkakore
9 individuale. Ato mund të tregojnë dëmin e shkaktuar, dëmin e
10 përgjithshëm, mund të tregojnë dhe viktimat e një personi por
11 nuk të çojnë në një person të caktuar.

12 Ekspertët kanë konfirmuar se nuk kanë qenë në gjendje që
13 të përcaktojnë nëse dëmi psikologjik i ndonjë viktime të jetë
14 shkaktuar nga krimet e kësaj çështjeje gjyqësore. Ata kanë
15 pranuar që simptomat mund të jenë të përputhshme me luftën në
16 përgjithësi, por jo me ndonjë sjellje specifike e cila t'i
17 atribuohet UÇK-së, e më pak z. Selimi.

18 Dhe në qoftë se një ekspert e pranon se ato nuk mund të
19 përcaktojnë se këto simptoma krijuar nga krimet, simptomat të
20 jenë nga krimet apo nga paraburgimi apo t'i atribuohen ndonjë
21 të akuzuari, atëherë këto prova nuk mund të tregojnë shkakun
22 përtej dyshimit të arsyeshëm. Dhe ky është një element kryesor
23 dhe në qoftë se nuk arrihet që të përcaktohet përgjegjësia
24 penale, atëherë kjo ka rëndësi.

25 Atë ditë Mbrojtësi i Viktimave tha, dhe citoj:

1 "Këto çështje dhe kjo çështje nuk janë thjesht studime.
2 Kjo aktakuzë nuk është një përshkrim ligjor i akteve penale.
3 Bëhet fjalë për vende dhe kohëra kur njerëzit janë dëmtuar në
4 mënyrë serioze, dëm i cili i ka ndryshuar ata dhe familjet e
5 tyre përgjithmonë. Pranimi -- duke pranuar këtë dëm, Trupi
6 Gjykues do të thotë që i ka dëgjuar vuajtjen e tyre, që ata
7 nuk kanë shkuar kot dhe në të gjithë botën në një çast kaq të
8 madh".

9 Dhe kjo ndodhet në faqet 28535, 28536 të transkriptit të
10 10 shkurtit.

11 Pala Mbrojtëse e pranon këtë që duhet të pranohet dëmi.
12 Megjithëkëtë, vështirësia është se ky është një gjykim penal.
13 Një gjyq penal pa viktime është i pamundur, por synimi është
14 jo thjesht për të pranuar që ka patur vuajtje, por për të
15 përcaktuar që është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i
16 akuzuari e ka shkaktuar këtë dëm.

17 Nga ana tjetër e rrëfimit të viktimave janë edhe jetët e
18 të akuzuarve, individë të cilët kanë luftuar për vendin e
19 tyre, për lirinë dhe përgjegjësia e të cilëve duhet të
20 përcaktohet dhe jo të hamendësohet. Mos ta harrojmë një gjë të
21 tillë.

22 Do kaloj tani tek çështja e masës së dënimit. Siç e kanë
23 thënë kolegët e mi, nuk ka prova që të mbështesin fajësinë në
24 asnjërën prej pikave të akuzës kundër z. Selimi. Duhet të
25 shpallet pafajësia dhe prandaj nuk mund të flitet për masë

1 dënimi.

2 Megjithëkëtë, nëse Trupi Gjykses arrin në fazën e masës
3 së dënimit, pala do të flasë lidhur me kërkesën e pazakontë,
4 të jashtëzakonshme të Prokurorisë. Prokuroria kërkon 45 vite
5 për secilin prej të akuzuarve, duke u bazuar në rregullën
6 163(4) dhe me një masë dënimi të përbashkët duke trajtuar
7 totalitetin e pretenduar të sjelljes si justifikim.

8 Edhe në alternativë, kërkesa e Prokurorisë është mbi
9 shproporcional dhe e paprecedentë në rrethanat e kësaj
10 çështjeje që nuk është provuar. Një dënim 45-vjeçar
11 praktikisht është dënim me jetë, ky nuk është proporcional.
12 Është një dënim simbolik që shfaqet si një masë dënimi.

13 Parashtrimet e ZPS-së i ngrenë vështirësinë,
14 parandalimin, përgjegjësinë kolektive si faktor përcaktues. Në
15 fakt, masa e dënimit ka të bëjë me kontributin personal të të
16 akuzuarit, autoritetin e tij, synimin, sjelljen e cila të jetë
17 provuar dhe të vlerësohet në praktikë me praktikat të cilat
18 Trupi Gjykses do t'i marrë parasysh. Kur të zbatohen të gjitha
19 këto parime, atëherë masa e dënimit që kërkon ZPS-ja është
20 qartësisht shproporcionale, sidomos duke patur parasysh
21 udhëzimin e Panelit të Apelit në rastet Shala dhe Mustafa, siç
22 do ta bëj të qartë.

23 Parashtrimet e Prokurorisë në mënyrë të përsëritshme i
24 trajtojnë të akuzuarit si pjesëmarrës që kanë zënë vendin e
25 njëri-tjetrit në një organizatë të përbashkët kriminale duke

1 argumentuar se ndaj tyre do të jetë masa identike apo
2 kryesisht për shkak të synimit të përbashkët dhe pozitës së
3 lartë që kanë patur.

4 Kjo qasje nuk përputhet me Ligjin e Dhomave të
5 Specializuara dhe praktikën e këtij Trupi Gjykses. Trupit
6 Gjykses i kërkohet që të përcaktojë masën e dënimit për
7 secilin prej të akuzuarve individualisht, duke patur parasysh
8 sa të rënda kanë qenë krimet që ka bërë ai person, duke matur
9 parasysh kontributin e tyre dhe rrethanat individuale. Dhe ky
10 është paragrafi 740 i aktgjykimit të apelit të Shalës.

11 Sa përket z. Selimi, Prokuroria mbështetet fuqimisht në
12 titullin e tij zyrtar dhe jo sjelljen e tij. Z. Selimi ka
13 patur rolin e inspektorit të përgjithshëm, por provat nuk kanë
14 treguar që ky rol në fakt është një rol i kontrollit efektiv
15 mbi qendrat e paraburgimit, kryesit e drejtpërdrejtë apo mbi
16 kryerjen e krimeve, siç kanë thënë kolegët e mi. Prokuroria e
17 trajton këtë pozitë të lartë si një provë të autoritetit dhe
18 të fajësisë.

19 ZPS-ja përmend rastet e Mustafës dhe Shalës si një bazë
20 për të justifikuar dhe masën e rëndë të dënimit në këtë rast.
21 Dhe kjo e kthen prapa logjikën e Panelit të Apelit. Në Shala,
22 Paneli i Apelit tha se masa 15 vjeçare me 15 burg kundër
23 Mustafës, mbi një të akuzuar me autoritet komandues dhe që
24 kishte dhënë kontribut personal, kishte treguar se sa
25 shproporcionale ishin masat e dënimit mbi personat që kanë

1 pasur fajësinë më të vogël.

2 Dhe është ky arsyetim që ka vlerë këtu. Krahasimi i
3 masave të dënimit synon që të parandalojë pikërisht arritjen
4 dhe jo normalizimin e saj. Në qoftë se komandanti me rol të
5 drejtpërdrejtë dhe kontroll të efektshëm ka marrë një masë
6 dënimi prej 15 vitesh burg, atëherë masa e dënimit me burgim
7 të përjetshëm për një të akuzuar kontributi i të cilit është
8 shumë më i ulët ngre çështjen e proporcionalitetit.

9 Ndërkohë që parandalimi dhe dënimi janë pikërisht në
10 themel të synimit që dhënies së masës së dënimit, nuk mund të
11 justifikohen masat e dënimit të cilat nuk kanë të bëjnë me
12 përgjegjësinë individuale. Paneli i Apelit në Shala ka
13 nënvijëzuar se masa e dënimit duhet të ketë të bëjnë me rolin
14 e të akuzuarit.

15 Masat e dënimit kryesisht kanë -- dërgojnë një mesazh dhe
16 nuk duhet të instrumentalizohen kundër të akuzuarit. Masa e
17 paraburgimit nuk mund të zëvendësojë proporcionalitetin dhe
18 dënimi nuk mund të shkojë tej përgjegjësisë personale të të
19 akuzuarit.

20 Dënimi krahasimor, praktika e dënimit krahasimor në
21 jurisprudencën e TPNJ-së nënvizon pikërisht këtë pranim që
22 masat e dënimit imponohen vetëm kur përcaktohet përgjegjësia
23 personale përmes konstatimit konkret dhe individual të
24 primares së drejtpërdrejtë me identifikim atribuon dhe me
25 provë.

1 Mbrojtësi i z. Thaçi dje e bëri të qartë se në rastin
2 Stakic, Mitic dhe Taylor, dhe nuk do të përsërisë të njëjtat
3 argumente. Por do të flas thjesht për praktikën e kësaj
4 Gjykate që ndjek të njëjtën qasje disiplinore.

5 Duke u bazuar mbi jurisprudencën e TPNJ-së, Paneli i
6 Apelit të Shalës e ka informuar se në rastet kur Trupi Gjykses
7 nuk e ndjek praktikën e masës së dënimit, atëherë duhet të
8 akuzuarit të shpjegojë arsyet dhe jo të tregojë thjesht
9 dispozitat statutore. Dhe paragrafi 6038 i aktgjykimit të
10 Karazdic. Sa i përket rasteve të ngjashme, atëherë do të ketë
11 udhëzues të përbashkët ku bëhet fjalë për të njëjtat vepra
12 penale që të cilat të jenë bërë në rrethana krejt të ngjashme.

13 Sa i përket *lex mitior*, Paneli i Apelit të Mustafës ka
14 përcaktuar dhe parime që kërkohen për rastet e një mase dënimi
15 më të ulët në rastet kur është amenduar dhe kuadri ligjor.
16 Aktgjykimi i Mustafës paragrafi 465, e ka hedhur poshtë
17 aplikimin e rreptë *lex mitior* mbi bazën se dënimet mbi bazën e
18 legjislacionit vendor nuk janë të detyrueshme për Dhomat e
19 Specializuara.

20 Megjithëkëtë, ata kanë arritur, ata thanë që neni 44(2) i
21 ligjit i imponon një detyrim për të mbajtur parasysh
22 legjislacionin vendor kur jepet pikërisht dënimi. Trupi
23 Gjykses ka përcaktuar -- Paneli ka përcaktuar se Trupi Gjykses
24 nuk kishte marrë parasysh këtë detyrim. Thjesht recitimi i
25 udhëzuesit të brendshëm nuk i kishte mjaftuar. Paragrafi 477.

1 Ajo që kërkohet ishte pikërisht që të shihej se cilat ishin
2 masat e dënimit vendore ku mund të zbatohen dhe për të
3 përcaktuar dhe me këtë edhe pikërisht dënimin, që ndodhet në
4 paragrafin 477. Dhe ky është gabim ligjor nga Trupi Gjykses.

5 E njëjta qasje është e dukshme edhe në dosjen e
6 Prokurorisë, e cila nuk ka referencën ndaj praktikës së
7 dhënies së masës së dënimit nga pjesa nga legjislacioni
8 vendor.

9 ZPS-ja, në paragrafin 1527, ka thënë që "në përcaktimin e
10 masës së dënimit Trupi Gjykses do të mbajë parasysh praktikën
11 e gjykatave kombëtare, ndërkombëtare në rastet e ngjashme" dhe
12 -- mirëpo poshtëshërimi nuk përmend asnjë çështje të brendshme
13 të cituar. Për këtë arsye do të flas për praktikën e
14 brendshme.

15 Krimet e luftës së kohëve të fundit që kanë shkuar për
16 Departamentin e Posaçëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë
17 kanë të bëjnë me dënimin për krimet e luftës kundër popullatës
18 civile, përfshirë rrahje, torturë, paraburgim të paligjshëm,
19 mbajtjen peng, vrasjen e civilëve disa herë kundër shumë
20 viktimave. Megjithatë masat e dënimit kanë qenë të kufizuara.

21 Në rastet që kanë të bëjnë me Prokurori kundër Jolic,
22 Vukotic, Bajrovic, Bacevic, masa e dënimit ishte 5 deri në 15
23 vite, pavarësisht se kishte të bënte me shumë viktime dhe me
24 raste të dhunës së rëndë. Këto çështje të krimeve të luftës
25 kundër popullatës civile nuk janë identike me rastet e

1 tanishme të kësaj çështjeje gjyqësore këtu, në shumë raste
2 megjithatë sjellja e përcaktuar ishte më e rëndë përfshirë
3 vrasje, torturën, rrëmbimin dhe keqtrajtimin. Edhe në këto
4 rrethana, masat e dënimit të imponuara ishin shumë më të ulëta
5 sesa ajo që kërkohet këtu. Dhe duke patur parasysh këtë
6 praktikë të masës së dënimit të brendshme, kërkesa e
7 Prokurorisë për 45 vite burg për të akuzuarit është e
8 pashpjeguar dhe nuk është në përputhje me standardet kombëtare
9 për dënimin e krimeve të luftës.

10 Prezumimi i pafajësisë do të mbetet parimi kryesor dhe
11 asgjë nuk mund ta zëvendësojë.

12 Megjithëkëtë, në qoftë se arrijmë në masën e dënimit,
13 duhet të kemi parasysh faktorët lehtësues. Z. Selimi ka kaluar
14 një kohë të gjatë në paraburgim. Paraburgimi i tij është
15 gjatë, i kufizuar dhe ka shkatërruar jetën e tij familjare.
16 Filloi me pandeminë e COVID-19, kur kushtet e paraburgimit
17 ishin shumë të rrepta dhe kontakti me familjen ishte shumë i
18 kufizuar, sidomos gjatë vitit të parë. Gjatë gjithë
19 procedurave, ai ka bashkëpunuar në mënyrë të vullnetshme me
20 ZPS-në, pa pranuar fajësinë. Sjellja e tij ka qenë gjithmonë
21 me respekt dhe ka respektuar, ka shprehur simpati edhe empati
22 për viktimat, duke mos pranuar përgjegjësinë penale.

23 Në të njëjtën mënyrë duhet të trajtojmë edhe një çështje
24 tjetër. Prokuroria ka sugjeruar ekzistencën e frikësimit të
25 dëshmitarëve, paragrafi 1518, 1519 të dosjes së tyre duke

1 përfshirë dhe referencën e të hënës ndaj "klimës së
2 frikësimit" e cila menaxhohet në këtë Trupi Gjykues, që është
3 transkripti 28361. Ky pohim bazohet në pretendimin se disa
4 prej dëshmitarëve janë përpjekur që të tërheqin dëshmitë e
5 tyre apo t'u shmangen atyre, ndërkohë që Prokuroria e atribuon
6 këtë ndaj frikësimit të mundshëm, poshtëshënimi 6377,
7 megjithëkëtë nuk zhvillohet ky argument.

8 Mbrojtja e ka folur, e ka trajtuar çështjen e
9 dëshmitarëve relevantë në dosjen e saj. W03825, paragrafi 883,
10 3827, paragrafi 88485 dhe përveç këtij poshtëshënimi që të
11 akuzuarit janë ish-anëtarë të UÇK-së dhe ish-zyrtarë publikë,
12 Prokuroria nuk ka pretenduar dhe s'ka dhënë prova të ndonjë
13 përpjekjeje nga z. Selimi për të ndikuar, frikësuar apo për të
14 ndërhyrë me dëshmitarë. Këto janë pretendime të pambështetura
15 dhe nuk justifikojnë asnjë lloj ndërhyrje ndaj z. Selimi.

16 Duhet që të tregohemi të drejtë. Mbrojtja është e
17 detyruar që të flasë lidhur me masën e dënimit përpara se të
18 provoheshin faktet. Kjo nuk ishte zgjedhja jonë. Refuzimi për
19 të moszbatuar, refuzimi për t'u larguar nga këto parashtrime
20 të detyruar hipotetike është i pazakontë në çështje të kësaj.
21 Nuk duhet të jetë kjo kostoja që të ketë kjo procedurë penale.
22 Në qoftë se arrihet një fajësi edhe masa e dënimit do të jetë
23 e bazuar mbi konstatimet e arritura jo në hamendje, jo në
24 hamendësime.

25 Në këtë kontekst një masë dënimi prej 45 vite për secilin

1 prej të akuzuarve do të ishte krejt shproporcionale. Nuk mund,
2 nuk përputhet me jurisprudencën e kësaj Gjykate. I tejkalon të
3 gjitha masat e dënimit të TPNJ-së dhe të gjykatave vendore.
4 Është në kundërshtim me udhëzimin e Panelit të Apelit në Shala
5 dhe Mustafa. Kalon të gjitha masat e dënimit mbi të gjitha ato
6 që kanë patur dhe autoritet më të madh komandues dhe rol
7 personal në rastet e ngjashme.

8 Për sa i përket z. Selimi, është edhe më e ashpër. Kjo
9 masë dënimi do të dënonte pikërisht përkatësinë e tij dhe
10 sjelljen. Do të ishte një zëvendësim i përgjithësisë
11 individuale dhe prandaj ky Trup Gjykues nuk do ta lejojë këtë.

12 Për të përfunduar, siç e tha kolegu im, z. Roberts, në
13 parashtrimet e tij, gabimi në argumentet e ZPS-së është se ajo
14 shpreh një -- është i vazhdueshëm dhe i dukshëm në
15 mbipërsëritjen duke përsëritur dhe duke dhënë ekzagjerime por
16 duke mos provuar. ZPS-ja i ka treguar Trupit Gjykues se nuk do
17 të mund të paraqiste një çështje të mbështetur plotësisht dhe
18 nuk e ka bërë dot këtë mbështetje të fakteve.

19 E njëjta gjë ka të bëjë edhe me masën e dënimit. Në
20 rastet kur nuk ka prova, rriten edhe shifrat. Megjithëkëtë, sa
21 i rëndë është një krim që nuk është provë dhe dënimi do të
22 jetë, nuk mund të kompensojë për një çështje e cila nuk është
23 provuar asnjëherë.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Unë
25 do flas shkurt.

1 Do vazhdoj aty ku e la znj. Sheremiti, sa i takon
2 parashtrimeve me respekt dhe të gjera lidhur me dëmin e
3 viktimave në këtë çështje. Ne nuk duam të zbehim vuajtjen e
4 atyre të cilët kanë vuajtur në të gjithë Kosovën.

5 Kur fola sot dhe kur fola dje, në fakt, ju thashë, të
6 nderuar Gjykatës, që ne do të mundohemi që të jemi sa më
7 transparent që të jetë e mundur, dhe mendoj që po aq
8 transparent kemi qenë dhe në parashtrimet tona me shkrim. Këtë
9 gjë ne e bëjmë jo vetëm si detyrim ndaj jush ,anëtarë të
10 Trupit Gjykses, por edhe për faktin se ne mendojmë që kjo
11 është e vetmja mënyrë se si të vëmë drejtësi përmes kësaj
12 çështjeje. Dhe vetëm në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës, do i
13 vlerësoni pretendimet dhe akuzat e Prokurorisë dhe do t'i
14 krahasoni ato me vlerësimin gjyqësor të Mbrojtjeve të të
15 akuzuarve, vetëm në këtë mënyrë do të mundni që të vendosni
16 drejtësinë në vend.

17 Të nderuar Gjykatës, ne dje dëgjua lidhur me NKP-në në
18 përgjithësi, si dhe kontributin e synuar të z. Selimi në këtë
19 NKP. Dëgjua dedikime të detajuara si dje dhe sot prej meje
20 dhe kolegëve të mi, lidhur me rolin e pretenduar të z. Selimi
21 si inspektor i përgjithshëm dhe në pozicionin e tij si
22 ministër i rendit publik. Z. Selimi nuk ka qenë komandant. Z.
23 Selimi nuk ka ushtruar asnjë përgjegjësi eprore në asnjë
24 mënyrë dhe në asnjë formë. Këtu përfshinë dhe autoritetin e
25 pretenduar që z. Selimi ka qenë anëtar i këtyre strukturave,

1 pavarësisht faktit që ai ka qenë një anëtar i njohur dhe që në
2 fillim i UÇK-së.

3 Duke marrë parasysh faktin që z. Selimi nuk ka pasur
4 vartës duke marrë parasysh edhe faktin që nuk ka asnjë lidhje
5 midis z. Selimi sa i takon kontrollit efektiv, mendoj, që
6 përderisa Prokuroria nuk ka dhënë asnjë bazë për këto
7 pretendime ky është fundi i argumenteve të tyre.

8 Të nderuar Gjykatës, sigurisht që ju do e keni të
9 vështirë që të shikoni të gjitha provat që u ka hedhur me
10 tonelatë Prokuroria, duke e marrë parasysh madhësinë e
11 çështjes, duke e marrë parasysh numrin e përgjithshëm të
12 dëshmitarëve e të provave materiale, duke marrë parasysh faqet
13 e dosjes së Prokurorisë, nuk ka qenë e mundur dhe e
14 realizueshme prej Prokurorisë që të trajtonte me gojë të
15 gjitha aspektet e Prokurorisë, sepse po ta kishin bërë këtë
16 gjë do na duheshin tre muaj për të bërë parashtrimet
17 përbyllëse për këtë çështje. Ajo çfarë jemi përpjekur që të
18 bëjmë është që të vlerësojmë provat reale në këtë çështje,
19 gabimet, mungesën e konsistencës dhe problemet me logjikën. Ne
20 nuk jemi fshehur nga trajtimi i pretendimeve të ZPS-së dhe
21 provave mbi të cilat mbështetet ZPS-ja.

22 Kjo nuk do të thotë që duke iu referuar pretendimeve të
23 ngritura nga ZPS-ja ndaj z. Selimi këto pretendime dhe akuza
24 duhet të marrin ndonjë peshë. Sikurse e kemi shpjeguar në
25 hollësi në parashtrimet tona dhe në dosjen tonë, provat kundër

1 z. Selimi për të gjitha akuzat e ngritura nga ZPS-ja janë
2 kontradiktore, nuk kanë besueshmëri dhe janë të pabazuara. Në
3 veçanti, pretendimet që z. Selimi personalisht kanë marrë
4 pjesë në ndonjë krim të pretenduar rrëzohen tërësisht në qoftë
5 se do bëhet një analizë e kujdesshme e provave që ka
6 parashtruar Prokuroria.

7 Kur bënë parashtrimet me shkrim mund të kishim ndjekur
8 qasjen e Prokurorisë edhe të ishim përpjekur që të përsërisnim
9 atë çfarë kemi parashtruar në dosjen paraprake, dhe të
10 pretendonim që vitet e dëshmitarëve që kemi pyetur dhe që kemi
11 dëgjuar dëshmitarët këtu të mos kishin ekzistuar fare, por ne
12 kemi përqafuar një tjetër qasje. Po ashtu mund të kishim
13 shpresuar që ju, të nderuar Gjykatës, të mos e kishit vërejtur
14 ndikimin e dëshmitarëve që Prokuroria as nuk i thirri ose
15 qëllimisht vendosi në momentin e fundit të mos ishin
16 dëshmitarë. Dhe nga ana tjetër, ne mund të kishim zgjedhur të
17 bënim të njëjtën gjë si Prokuroria, por e vërteta është që ne
18 i kemi etiketuar të gjitha provat të cilat janë në kundërshtim
19 me qëndrimin tonë.

20 Unë e kuptoj që ky është një proces gjyqësor ku ka palë
21 kundërshtare dhe e kuptoj që ZPS-ja duhet që të parashtrojë
22 provat e veta në mënyrën më të mirë të mundshme dhe,
23 sigurisht, që qëllimi i tyre është që t'ju tërheqë vëmendjen
24 ju në ato prova të cilat janë të favorshme ose i shërbejnë
25 argumenteve të tyre. Megjithatë parashtroj se ka një dallim

1 shumë të madh midis ZPS-së që përqendrohet në pjesët më të
2 forta të provave të saj, siç beson Prokuroria dhe tërësisht
3 duke injoruar ose anashkaluar kontradiktat që rrjedhin prej
4 informacionit që paraqet ajo. Mendojmë që një gjë e tillë e
5 kalon cakun e palëve kundërshtare në një proces gjyqësor të
6 tillë.

7 Pra edhe një herë, një qasje e tillë e kalon pragun e
8 prezantimit të palëve kundërshtare dhe shkon në keqinterpretim
9 ose në mosveprim.

10 Të nderuar Gjykatës, juve në qoftë se do shikoni dhe do
11 të vlerësoni me imtësi provat do të mbërrini në këtë përfundim
12 që: Z. Selimi është tërësisht jo i fajshëm, pra, është i
13 pafajshëm për të gjitha akuzat që ka ngritur ZPS-ja ndaj tij.
14 Si rezultat, z. Selimi duhet të deklarohej jo fajtor dhe duhet
15 të lejojë që të vazhdojë të shkojë në vendin e vet pranë
16 familjes së vet në Kosovë. Nuk ka asnjë bazueshmëri të të
17 gjitha argumenteve dhe të akuzave që ZPS-ja ka ngritur për z.
18 Selimi.

19 Ju falënderoj për vëmendjen dhe këtu është fundi i
20 komenteve përmbyllëse të z. Selimi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Tani do bëjmë pushimin e drekës, do të fillojmë me
23 parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit në orën 1.30. Nga tani
24 deri në orën 1.30 do të kemi pushimin e drekës.

25 --- Pauza e drekës fillon në orën 11.41

1 --- Seanca rifillon në orën 13.31

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
3 Jemi gati të fillojmë me deklaratën përmbyllëse të Mbrojtjes
4 së Krasniqit. Nuk e di kush do fillojë i pari prej jush, por
5 fjala është për ekipin e Krasniqit.

6 Ti jo, ti nuk je planifikuar, Tully.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, jo, i nderuar Gjykatës. Unë kam
8 përfunduar për sot.

9 Por thjesht dua t'ju informoj që i kam dërguar një email
10 Sekretarit. Dhe dua që të korrigjohen katër referenca.

11 Më konkretisht korrigjimet lidhen me faqen 9, rreshti 14,
12 ku referenca thotë "4735" dhe në vend të kësaj duhet të thotë
13 "4737".

14 Në faqen 14, rreshti 4, thuhet "192", po në fakt "1922".

15 Në faqen 17, rreshti 10, ku thotë "ZPS", duhet të jetë
16 "Ministria e Rendit Publik", që është referenca e parë në atë
17 rresht.

18 Dhe në faqen 24, rreshti 16, ku thuhet "ditar", duhet të
19 jetë rresht.

20 Këto janë sqarimet që doja të bëja për procesverbal.
21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 juve.

24 Si kujtesë, dëshiroj që t'ju them që do bëjmë një seancë
25 për një orë e gjysmë së pari, do të bëjmë një pushim, pastaj

1 kemi seancën e dytë prej një orë e gjysmë dhe pastaj do keni
2 një orë e gjysmë të hënën. Dhe pastaj pasi të mbaroni ju, të
3 hënën ne Gjykatësit do të vazhdojmë me pyetjet dhe do t'ju
4 përditësojmë pastaj se çfarë rrjedhe do të ketë procesi.
5 Faleminderit për vëmendjen deri tani.

6 Znj. Alagendra, fjala është për ju në qoftë se jeni gati.

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
8 Gjykatës.

9 Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve në
10 sallën e gjyqit dhe ju që na ndiqni në distancë. Unë jam
11 Venkateswari Alagendra, jam mbrojtëse e z. Jakup Krasniqi. Unë
12 do bëj disa parashtrime në emër të z. Krasniqi sot.

13 Dëshiroj t'ju them që gjatë prezantimit do vëmë disa
14 diapozitiva, të cilat mund t'i transmetohen të gjitha publikut
15 me përjashtim të rasteve ku do themi konkretisht që nuk janë
16 për paraqitje për publikun.

17 Të nderuar Gjykatës, Jakup Krasniqit i është dashur të
18 presë shumë kohë për të mbërritur në përfundimin që çështja e
19 Prokuroria përshkruhet nga dobësi mospërputhje dhe kontradikta
20 të dukshme të shumta dhe të përhapura.

21 Të nderuar Gjykatës, në janar të 2011, Dick Marty lëshoi
22 një raport, dhe siç e dini ky raport shërbeu si katalist për
23 veprimet dhe për krijimin e DHSK-së më pas. Nuk do merrem
24 shumë me këtë raport, megjithatë historianët, analistët dhe
25 juristët mund të thonë në të ardhmen që shumë prej

1 pretendimeve hiperbolistike dhe të çuditshme të përfshira në
2 atë raport nuk kanë çuar në ngritjen e një akuze, pra,
3 sigurisht, siç e dini nuk kemi asnjë akuzë për trafikim
4 organesh këtu përpara kësaj Gjykate. Dhe ky raport nuk
5 përfshin asnjë pretendim për vepra penale të kryera nga Jakup
6 Krasniqi.

7 Një gjë është e qartë. Më shumë sesa pesë vite më përpara
8 Jakup Krasniqi është arrestuar dhe i është hequr liria, ka
9 qëndruar në objektin e paraburgimit për 1926 ditë, larg prej
10 bashkëshortes së tij, prej katër fëmijëve dhe tre nipërve e
11 mbesave. Arsyet jepen në hollësi në dosjen tonë përfundimtare
12 si dhe argumente shtesë të cilat ne do t'i paraqesim në
13 parashtrimin tonë, dhe ne me respekt parashtrajmë që ekziston
14 vetëm një opsion, që ju, të nderuar Gjykatës, të merrni vendim
15 pafajësie për të gjitha akuzat e ngritura ndaj Jakup
16 Krasniqit. Në fund të parashtrimit, do ju bëjmë thirrje, të
17 nderuar Gjykatës, që mbështetur në provat në dispozicion, të
18 shpallnit të pafajshëm z. Krasniqi dhe ta lejoni këtë zotëri
19 75 vjeçar që të kthehet në familjen e vet dhe të kalojë kohën
20 që i ka caktuar Zoti me familjen e vet.

21 Të nderuar Gjykatës, ky është një gjykim i gjatë. Janë
22 paraqitur shumë dokumente prej Prokurorisë në kuadër të tij
23 dhe shumë dëshmitarë janë thërritur për të dhënë dëshmi.
24 Ndonjëherë procesi gjyqësor ka qenë i ngarkuar me argumente të
25 shumta në Gjykatë. Ndonjëherë nxehtësia e argumenteve ka qenë

1 shumë më e pranishme sesa vetë drita. Megjithatë, të nderuar
2 Gjykatës, do ju kërkoja që kur të shqyrtoni provat e
3 paraqitura nga Prokuroria në këtë proces gjyqësor, të mos
4 harroni qoftë edhe për një çast këto fakte thelbësore. Në të
5 gjithë këta 34 muaj gjykimi, në të gjitha provat që janë pjesë
6 e dokumentacionit shkresor të kësaj çështjeje, nuk ka qoftë
7 edhe një dëshmitar të vetëm që pretendon që Jakup Krasniqi e
8 ka rrahur, e trajtuar apo e ka torturuar qoftë ky person civil
9 apo person tjetër.

10 Nuk ekziston qoftë edhe një viktimë e vetme, një person i
11 brendshëm i vetëm, nga qindra dëshmitarë të intervistuar nga
12 Prokuroria për shumë e shumë vite, që pretendojnë ose e
13 akuzojnë Jakup Krasniqin që i ka rrahur, i ka abuzuar ose që
14 ka qenë i pranishëm kur ata janë keqtrajtuar në asnjë trajtë
15 apo formë.

16 Në rastin kur Prokuroria është e mbështetur siç duhet në
17 dokumentet shkresore të besueshme dhe dëshmitarë të
18 dëshmitarëve, megjithatë, e vërteta është që kjo Prokurori,
19 fatkeqësisht, mbështetet kryesisht në spekulime dhe në
20 pretendime të pambështetura.

21 Të nderuar Gjykatës, në kohën që na keni dhënë në
22 dispozicion për katër orë e gjysmë, strukturimi i situatave
23 përmyllëse do të jetë si më poshtë. Pas prezantimit tim unë
24 do të flas për çështje shkresore që kanë të bëjnë me
25 dokumentet që pretendohen të jenë marrë nga shtëpia e Jakup

1 Krasniqit dhe dokumente që e kanë zanafillën nga shteti serb.
2 Më pas unë do të flas për shtrembërimin e rolit të Jakup
3 Krasniqit si zëvendëskomandant i mbështetjes nga Prokuroria.
4 Më pas z. Jacopo Ricci do të trajtojë dokumente dhe çështje të
5 caktuara, dokumentet të cilat sipas Prokurorisë janë
6 nënshkruar nga Jakup Krasniqi. Z. Ellis më pas do të trajtojë
7 disa incidente që pretendohet të përfshijnë z. Jakup Krasniqi,
8 si dhe do flasë për rolin e z. Krasniqi si zëdhënës i UÇK-së.
9 Z. Mentor Beqiri, që është anëtari kosovar i ekipit tonë, do
10 të japë një vështrim të përgjithshëm për formacionin e UÇK-së
11 si organizatë mbrojtëse; së dyti, do japë praktikat kulturore
12 dhe rëndësinë e kanunit për vlerësimin e përgjithshëm të
13 provave dhe akuzave të ngritura në këtë çështje; dhe, së
14 fundi, të nderuar Gjykatës, ai do prekë disa aspekte të cilat
15 janë trajtuar nga Mbrojtësi i Viktimave. Në fund do flas unë
16 me disa komente përmyllëse.

17 Të nderuar Gjykatës, së pari dua të përqendrohem tek
18 prirja e zakonshme e Prokurorisë për të përzgjedhur sipas
19 interesave të veta dokumente dhe dëshmitarë të caktuar. Herë
20 pas here, Prokuroria në mënyrë të vazhdueshme bën përzgjedhjen
21 e atyre pjesëve të dëshmimeve të dëshmitarëve që mbështesin
22 teorinë e çështjes ose argumenteve të tyre, ndërkohë që
23 injorojnë pjesë të caktuara të dëshmisë të të njëjtit
24 dëshmitar ose dëshmi kontradiktore të dëshmitarëve të tjerë.
25 Nuk kemi kohë të mjaftueshme për të identifikuar në mënyrë

1 shterimore të gjithë këto shembuj, por është e qartë që kjo
2 është një praktikë që e përshkruan dosjen përfundimtare të
3 Prokurorisë. Sikurse do të bëhet e qartë prej parashtimeve
4 tona, ka shembuj verbues të qasjes përzgjedhëse të Prokurorisë
5 lidhur me sjelljen e pretenduar të Jakup Krasniqit gjatë
6 gjithë kohës së aktakuzës.

7 Një prej shembujve të fundit është një video që ka
8 transmetuar Prokuroria të hënën, është prova materiale P1255.

9 Në përpjekje për të treguar lidhjen midis LPK-së dhe
10 strukturave të hershme të UÇK-së, Prokuroria iu tregoi ju, të
11 nderuar Gjykatës, një video nga sekonda 00:52 deri tek minuta
12 01:06 dhe e ndaloi aty videon. Por çfarë nuk iu tregoi
13 Prokuroria ju, të nderuar Gjykatës, është fjalia e mëposhtme e
14 thënë nga z. Krasniqi dhe neve themi qartazi që ZPS-ja nuk e
15 ka bërë punën e vet siç duhet.

16 Të nderuar Gjykatës, neve ju themi që Prokuroria është
17 mbështetur në deklarata të regjistruara më herët mbi dëshmitë
18 gojore dhe ka pasur parapëlqim të dëshmimeve të dhëna me shkrim
19 përpara sesa të fillonte procesi gjyqësor dhe jo të thërriste
20 persona të caktuar nën betim në gjykatë. Dhe një tjetër
21 element i cili po ashtu bëhet i qartë në dosjen e Prokurorisë
22 është që ajo nuk u jep peshën e duhur provave shfajësuese.

23 Unë do jap një shembull, megjithatë sigurisht që do ketë
24 më shumë shembuj të tjerë ilustrues.

25 Në paragrafin 130 dhe 192 të dosjes së vet, Prokuroria

1 parashtroi se z. Zyrapit përpara sesa të nxirrte urdhrin e 28
2 nëntorit 1998 i raportonte komandantit të përgjithshëm, dhe i
3 ka raportuar këtij komandanti dhe Jakup Krasniqit ankesat për
4 ndalimet dhe keqtrajtimet që kishte marrë kur kishte vizituar
5 zonat gjatë verës së 1998-s. Në mbështetje Prokuroria citon
6 një pjesë nga intervista e 2019-s e z. Zyrapit, ku ai kishte
7 deklaruar se përpara se të nxirrte urdhrin kishte diskutuar
8 këto ankesa me komandantin e përgjithshëm dhe zëdhënësin. Më
9 konkretisht kjo jepet në provën P1355.4 në faqen 19.

10 Por ajo çfarë nuk merr parasysh Prokuroria është dëshmia
11 e Zyrapit në të njëjtën faqe që ishte komandant i përgjithshëm
12 Azem Syla, jo Jakup Krasniqi, personi me të cilin ai ishte
13 konsultuar dhe me të cilin kishte diskutuar ankesat përpara
14 sesa të nxirrte urdhrin e 28 nëntorit të 1998-s. Sikurse mund
15 ta shikoni në ekran, kjo pjesë e dëshmisë së tij iu tregua
16 Zyrapit dhe iu bënë pyetje Zyrapit lidhur me të. Në përgjigje
17 z. Zyrapit konfirmoi me gjuhë të qartë dhe të kuptueshme se
18 përpara sesa të nxirrte urdhrin ishte konsultuar vetëm me Azem
19 Sylën dhe jo me Jakup Krasniqin. Kjo jepet në faqen 18022 të
20 transkriptit.

21 Prokuroria refuzon që të përfshihet me këto prova
22 shfajësuese edhe me dëshmitarin e saj më të mirë. Dhe ajo nuk
23 është marrë fare me këtë element, ndërkohë që për një prokuror
24 të përgjegjshëm nevojitet që Prokuroria të marrë parasysh si
25 provat shfajësuese dhe ato fajësuese. Kjo Prokurori i ka

1 anashkaluar tërësisht provat shfajësuese.

2 Kërkesa për rregullën 22 që Prokuroria duhet të përmbushë
3 për vërtetimin e të vërtetës duhet të lexohet së bashku me
4 rregullën 4(1) të Rregullores. Të marra së bashku, këto
5 rregulla përcaktojnë detyrimin e qartë të Prokurorisë për të
6 hetuar si prova fajësuese dhe shfajësuese njësoj. Kjo është
7 detyrë e domosdoshme nga Prokuroria e cila po ashtu
8 nënvijëzohet në nenin 47 dhe në nenin 101(1) të Kodit të
9 Procedurës Penale të Kosovës dhe neni 8(1.1) e Ligjit të
10 Kosovës për Prokurorinë e Shtetit. Është ligji numër 8L-167.
11 Këto kërkojnë përkatësisht që prokurorët të shqyrtojnë si
12 prova fajësuese dhe shfajësuese gjatë fazës hetimore dhe që
13 ata të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të
14 drejtë, objektive dhe të paanshme. Këto dispozita nuk janë
15 vetëm fjalë, por janë dispozita që i vendosin detyrime ligjore
16 konkrete Prokurorisë, të cilat duhet të përdoren prej saj për
17 të formësuar përzgjedhjet dhe përparësitë e saj të hetimit. Ne
18 parashtrojmë që Prokuroria nuk e ka ushtruar këtë përgjegjësi
19 themelore.

20 Në çështjen në fjalë, strategjia hetimore e Prokurorisë
21 ka qenë një narrative e paracaktuar ku ka futur fakte të marra
22 aty-këtu dhe nuk ka bërë përpjekje të vërteta për të testuar
23 alternativa ose shpjegime të cilat duhet të ishin shtjelluar
24 në tërësinë e tyre. Pista të tëra hetimi që mund të kishin
25 rënë në kontradiktë me teorinë e Prokurorisë nuk janë

1 shqyrtuar dhe eksploruar fare. Po ashtu Prokuroria nuk ka
2 thirrur një numër të rëndësishëm vendimtar të dëshmitarëve
3 dëshmia e të cilëve mund të kishte dhënë informacion të shumtë
4 kontekstual, operacional, si dhe informacion për hierarkinë e
5 UÇK-së në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë Trup Gjykses.

6 Sa për ilustrim, Prokuroria bën pretendime të gjera sa i
7 takon policisë ushtarake sikurse jepet në paragrafët 281 deri
8 në 291 të dosjes përfundimtare të saj, por pavarësisht kësaj,
9 Prokuroria nuk e thërret Fatmir Limajn, shefin e drejtorisë së
10 policisë ushtarake për të dhënë dëshmi.

11 Sikurse mund ta shikoni tani në ekran, Prokuroria
12 gjithashtu pretendon se Jakup Krasniqi ishte
13 zëvendëskomandanti i parë që kishte autoritetin dhe
14 kompetencën e plotë dhe funksionet e plota të komandantit të
15 përgjithshëm - këtë e jep në paragrafin 105 të dosjes
16 përfundimtare të Prokurorisë - dhe në faqen 28468 të
17 transkriptit të së hënës dhe që prej mesit të nëntorit të
18 1998, kur e ka marrë rolin zëvendëskomandanti Krasniqi ka
19 ushtruar kompetencat e plota të komandantit të përgjithshëm që
20 mungonte. Pavarësisht kundërshtimeve të Mbrojtjes për këtë
21 pohim, Prokuroria nuk e thërreti Azem Sylën që ka qenë
22 komandant i përgjithshëm i UÇK-së për pjesën dërrmuese të
23 aktakuzës për interpretimin e së vërtetës.

24 Prokuroria pretendon që të akuzuarit ishin përgjegjës për
25 krimet e kryera në Kosovë në periudhën qershor-shtator 1999,

1 por pavarësisht kësaj, dështon plotësisht që të thërrasë Agim
2 Çekun dhe të dëgjonin dëshminë e tij si shef i Shtabi i
3 Përgjithshëm në atë kohë.

4 Efekti kumulativ i këtyre mangësive e të përsëritura herë
5 pas hera nga kjo Prokurori e bën këtë Trup Gjykses të gjendet
6 para një dokumentacioni të çështjes që është i shtrembëruar
7 dhe i paplotë. Hetimet kur janë të njëanshme, të paplota ose
8 kur shtyten nga rezultati që dëshiron Prokuroria që të arrijë,
9 kjo është një situatë që është tërësisht e kompromentuar.
10 Trupi Gjykses nuk mund të mbështetet në një çështje të tillë
11 të Prokurorisë e cila mbështetet tek përjashtimi i shkresave
12 dhe i provave shkresore si dhe hetimeve selektive.

13 Procesverbali i kësaj çështjeje demonstroi që Prokuroria
14 ka dështuar për të vendosur ose për të vërtetuar lidhjen midis
15 Jakup Krasniqit dhe krimeve të pretenduara dhe, në veçanti, që
16 deklaratat publike, komunikatat dhe rregulloret e hartuara nga
17 Jakup Krasniqi kanë ndihmuar, inkurajuar, se kanë pasur ndonjë
18 lidhje me krimet e ngritura në aktakuzë.

19 Gjithsesi në veçanti, pas përfundimit të argumenteve të
20 veta, Prokurori e tërhoqi pretendimin e vet që Jakup Krasniqi
21 ka qenë i pranishëm dhe ka vizituar dhomën ku kanë qenë të
22 ndaluar persona të caktuar në Malishevë. Ky ishte i vetmi
23 pretendim i Prokurorisë që Jakup Krasniqi ka parë ndonjëherë
24 me sytë e veta një viktimë që ka qenë i mbajtur në ndalim.

25 Një prokuror i përgjegjshëm nuk do kishte ngritur kurrë

1 një akuzë të tillë. Dëshmitari W00067, që është dëshmitari
2 kryesor për këtë akuzë, ka vdekur goxha përpara sesa të
3 fillonte ky gjykim. Prokuroria i ka pasur të gjithë elementët
4 e nevojshme për të vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve përpara
5 se sa të ngrinte këtë akuzë. Dëshmitari W00067 dhe dëshmia e
6 tij ishte jokonsistente lidhur me identifikimin e pretenduar
7 të Jakup Krasniqit në Malishevë. Përshkrimet e z. Krasniqi nga
8 dëshmitari ose ishin të vagullta ose ishin të gabuara.
9 Identifikimi i pretenduar i dëshmitarit për z. Krasniqi
10 mbështetej tek fakti që kishte dëgjuar dikë tjetër që të
11 përmendte fjalën "Krasniqi" ndërkohë që ky personi tjetër
12 fliste shqipen, një fjalë që dëshmitari nuk e kuptonte fare,
13 ndërkohë që Prokuroria është në dijeni të faktit që ka pasur
14 dhe shumë Krasniqë të tjerë në pozita komanduese në Malishevë
15 në atë kohë, i referohem konkretisht këtu provës P01303.
16 Dëshmitari W00067 nuk e njohu Jakup Krasniqin në një linjë
17 fotografish që u treguan. Kjo është prova P01304.

18 Diapozitivi tjetër nuk duhet t'i paraqitet publikut, të
19 nderuar Gjykatës.

20 Sikurse mund ta shikon në ekranin tuaj edhe vetë UNMIK-u
21 në një dokument me Prokurorinë, pra, një dokument për të cilin
22 Prokuroria ishte e informuar dhe që ishte kërkuar të pranohet
23 në prova, arriti në përfundimin që personi nuk kishte të
24 ngjarë të ishte Jakup Krasniqi.

25 Çfarë tjetër i nevojitet një prokurori që të rrëzojë një

1 akuzë të tillë si të pavërtetë dhe të pambështetshme? Por
2 pavarësisht kësaj situate, Prokuroria vazhdoi me teorinë e
3 vet. Në korrik të 2023-s Prokuroria thërriti Ledwidge, i cili
4 tha, dhe këtu dua t'ju tregoj pjesën e cituar prej tij dhe
5 mund ta shikoni këtë në ekran, "Unë nuk e mendoj që Jakup
6 Krasniqi ka qenë i përfshirë në ndonjë prej këtyre gjërave".
7 Por, pavarësisht nga kjo, për këtë Prokuroria nuk u mjaftua me
8 këtë për ta tërhequr pretendimin e vet.

9 Megjithatë, shtatë muaj më vonë, pra, në shkurt të 2024-s
10 dhe z. Krasniqi kishte më shumë sesa tre vite e gjysëm që
11 ishte i ndaluar, Prokuroria thërriti një tjetër dëshmitar që
12 nuk ishte asnjë pikë njohurie dhe që nuk e dinte fare, tha që
13 nuk e dinte fare Jakup Krasniqi ishte atje dhe përfundoi duke
14 dhënë dëshmi të tjera jokonsistente përpara Trupit Gjykses.
15 Edhe kësaj here Prokuroria nuk e tërhoqi akuzën ndaj z.
16 Krasniqi. Por ajo vazhdoi që t'i qëndronte narratives
17 tërësisht false, sipas nesh, të saj.

18 Çështja vazhdoi më tej. Pas gjashtë muajsh, në gusht dhe
19 në shtator të 2024-s, Prokuroria thërriti një tjetër
20 dëshmitar, Dëshmitari W03780 dhe Ahmet Rahmanaj, të cilët
21 ishin në Malishevë dhe kishin njohuri të dorës së parë lidhur
22 me ndalimet edhe këta persona Prokuroria nuk i pyeti lidhur me
23 praninë e pretenduar të z. Krasniqi në rajonin e policisë në
24 Malishevë. Edhe pas dëshmisë së tyre Prokuroria nuk e tërhoqi
25 këtë akuzë ndaj z. Krasniqi. Edhe një herë e theksoj, edhe pas

1 kësaj here Prokuroria nuk e tërhoqi këtë akuzë ndaj z.
2 Krasniqi.

3 Të nderuar Gjykatës, këto shembuj demonstrojnë, sipas
4 nesh, se sa e papranueshme ka qenë qasja e Prokurorisë ndaj
5 dëshmimeve. Ky është një rast i cili ilustron që kjo është një
6 akuzë që nuk duhej që të ishte ngritur fare dhe kur u ngrit
7 Prokuroria humbi tre mundësi për ta analizuar më mirë
8 qëndrimin e saj. Pra, ne parashtrojmë që Prokuroria duhet ta
9 kishte tërhequr këtë akuzë në një fazë shumë më të hershme.
10 Por ajo nuk e bëri një gjë të tillë.

11 Në vend të vendimit për të tërhequr këtë akuzë pas
12 thujse dy vite gjykimi, pavarësisht kësaj Prokuroria vazhdoi
13 që t'i qëndronte qëndrimin të vet shprehimisht false dhe i
14 pambështetur që kjo ishte një pjesë e rëndësishme e akuzave të
15 ngritura ndaj z. Krasniqi. Asnjë prokuror i arsyeshëm,
16 profesionist dhe etik, parashtrojmë ne, nuk duhet të kishte
17 pritur kaq shumë kohë përpara sesa të tërhiqnin një akuzë të
18 tillë. Është e qartë që kjo akuzë nuk duhet të ishte ngritur
19 fare që prej fillimit.

20 Të nderuar Gjykatës, ju e dini që ky është një gjyq, nuk
21 është një forum që palët të flasin pa lidhje. Prokuroria nuk
22 duhet t'i bëjë akuzat në qoftë se nuk ka prova solide.
23 Prokuroria ka detyrimin pozitiv që të përheqin pretendimet ose
24 akuzat e tyre në momentin kur nuk kanë prova për t'i
25 mbështetur ato. Nuk është kjo puna e Prokurorisë që ata

1 thjesht t'i hedhin fjalët sikur akuzat të mos kishin asnjë
2 lloj vlere dhe të bëjnë sikur asgjë nuk ka ndodhur.

3 I njëjti model është i pranishëm edhe në dosjen
4 përfundimtare. Prokuroria nuk duhej që të ngrinte akuza për
5 çështje të cilat nuk janë mbështetur në gjykim. Ne jemi
6 besimplotë që ju, të nderuar Gjykatës, do të analizoni provat
7 aktuale dhe të gjithë dokumentacionin e çështjes gjyqësore dhe
8 do ta shpallni z. Krasniqi jopërgjegjës për asnjë prej akuzave
9 të ngritura nga Prokuroria.

10 Ka përpjekje të përsëritura nga Prokuroria për të lidhur
11 Jakup Krasniqin me krimet e akuzuara. Ne parashtrojmë që këto
12 përpjekje të Prokurorisë kanë dështuar. Ju kërkojmë të nderuar
13 Gjykatës që të keni parasysh përdorimin prej Prokurorisë të
14 spekulimeve dhe është e rëndësishme që të bëhet vlerësimi i
15 plotë i argumenteve të saj.

16 Në të gjithë dosjen e Prokurorisë nuk ka marrëdhënie që
17 ekzistojnë midis pjesëve të palidhura të provave, të cilat
18 bëhen baza për lidhjet me ngjarje që për ndryshe nuk kanë pikë
19 lidhje. Besoj që ju e keni vënë re, anëtarë të Trupit Gjyqësor,
20 që emri i Jakup Krasniqit përdoret për ngjarje ose incidente
21 ose pretendime ku Jakup Krasniqi nuk ka fare lidhje. Dhe për
22 këtë arsye është e rëndësishme që të vihet në dukje që
23 qëndrimi i Prokurorisë është që thjesht ta thotë emrin e z.
24 Krasniqi edhe po mbetet diçka le të mbesë.

25 Për shembull, në paragrafin 367 të dosjes së vet

1 paragjyqësore, Prokuroria e ka vendosur Jakup Krasniqin në një
2 takim në Malishevë në fund të qershorit të 1998-s edhe madje
3 edhe ka sugjeruar një lidhje midis këtij takimi dhe urdhrit
4 për mbylljen e zyrave të partive politike në Malishevë.

5 Këto prezantime ose këto akuza nuk qëndruan në gjykim.
6 Prokuroria vendosi që të mos e thërriste Gani Krasniqin.
7 Dëshmitari tjetër i cili mund të jepte dëshmi për këtë takim
8 ishte Ahmet Rrahmanaj. Sikurse tregohet në ekran dhe për
9 procesverbal kjo është prova P01695, pra, Rrahmanaj shpjegoi
10 që e ka parë Jakup Krasniqin që të futej në Malishevë më vonë
11 gjatë ditës pasi kishte përfunduar takimi. Vetë Jakup Krasniqi
12 i ka thënë Rrahmanajt që po shkonte në Malishevë për të
13 vizituar një person që ishte i sëmurë. Rrahmanaj asnjëherë nuk
14 ka dëgjuar askënd të thotë që Jakup Krasniqi ka marrë pjesë në
15 këtë takim.

16 E papenguar nga dëshmitë faktike që Jakup Krasniqi nuk
17 kishte pikë lidhje me takimin në Malishevë, në paragrafin 789
18 të dosjes së saj përfundimtare, Prokuroria e përshkruan
19 takimin në Malishevë në fund të qershorit të 1998-s, sikur në
20 të kanë marrë pjesë Fatmir Limaj, Musë Jahari, Gani Krasniqi
21 dhe anëtarë të tjerë të njësitit Lumi, ku, sipas Prokurorisë,
22 Gani Krasniqi u konfirmua si drejtues ose shef i administratës
23 civile në Malishevë. Më tej Prokuroria shton, dhe këtu citoj,
24 mund ta lexoni në të njëjtin diapozitiv përpara ekranit:

25 "Jakup Krasniqi vizitoi Malishevën të njëjtën ditë, pra,

1 të njëjtën ditë të takimit.”

2 Po çfarë vlere ka kjo fjali? Çfarë do të thotë Prokuroria
3 me këtë fjali? Nuk duhet të ketë asnjë hapësirë për hamendësim
4 ose për aludime opake. Pas viteve gjykimi dosja përfundimtare
5 e Prokurorisë nuk mund të nënkuptojnë gjëra të paqena ose nuk
6 mund të nënkuptojë që duhet të ketë një lidhje për shkak të
7 faktit që nuk dëshiron që ta hedhë një akuzë që është refuzuar
8 prej dëshmitarëve të vet. Kjo nuk ka asgjë, nuk është asgjë
9 tjetër sesa një përpjekje për të hedhur baltë mbi të akuzuarin
10 dhe demonstroi qasjen e Prokurorisë mbi çështjen.

11 Një tjetër shembull ku Prokuroria mbështetet në spekulim
12 mund të shikohet se si Prokuroria trajton relevancën apo
13 rëndësinë e pranisë së pretenduar të Jakup Krasniqit në vende
14 të caktuara në Kosovë. Herë pas here, Prokuroria nënkupton që
15 ka pasur një prani ose prezencë të pretenduar në një zonë të
16 caktuar dhe kjo duhet të shikohet si e barabartë me
17 pjesëmarrjen në krime ose njohurinë për krime. Kjo do të
18 trajtohet më tepër në hollësi nga z. Ellis kur ai të bëjë
19 parashtrimet lidhur me rolin e Jakup Krasniqit si zëdhënës e
20 UÇK-së.

21 Një element tjetër i çuditshëm në dosjen e Prokurorisë
22 është se në mënyrë të vazhdueshme i mbyll sytë përpara çdo
23 prove që nuk i përshtatet narratives së Prokurorisë.
24 Prokuroria as nuk e pranoi ekzistencën e provave shfajësuese e
25 jo më tepër të bënte parashtrime mbi peshën që iu duhej dhënë

1 atyre. Një pjesë e madhe e dosjes së Mbrojtjes e kundërshton
2 teorinë e Prokurorisë, dhe këto nuk trajtohen aspak në dosjen
3 e tyre, përveç faktit që janë një tipar i rëndësishëm i
4 Mbrojtjes së z. Krasniqit gjatë gjithë gjykimit. Pra, është e
5 çuditshme se si shkojnë punët.

6 Për shembull, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të shumta që
7 emërimi i Jakup Krasniqit si zëvendëskomandant për mbështetje
8 nuk njihej në të gjitha nivelet e UÇK-së. Z. Krasniqi nuk
9 njihej si zëvendëskomandant për mbështetje për ndërkombëtarët
10 me të cilët ka pasur komunikim sepse këtë mund ta shihni
11 konkretisht në diapozitivin konkret. Dëshmitarë të Prokurorisë
12 po ashtu kanë konfirmuar se Jakup Krasniqi zyrtarisht e ka
13 mbajtur këtë rol vetëm për një periudhë të shkurtër kohore,
14 për afërsisht tre muaj, që janë tre muaj brenda periudhës 18-
15 mujore të aktakuzës dhe ka dhënë dorëheqjen më 27 shkurt 1999.
16 Për këtë mund të shihni paragrafin 630 të dosjes sonë. Të
17 njëjtët dëshmitarë të Prokurorisë dhe dokumentet e asaj kohe
18 tregojnë qartazi se emërimi i Jakup Krasniqit nuk u pranua
19 asnjëherë - ose dhe më saktë u kundërshtua - nga komandantët e
20 zonave. Këto mund t'i shikoni në paragrafin 624, 629 të
21 dosjes. Prokuroria në dosjen e vet as nuk është përpjekur t'i
22 kundërmojë këto fakte. Por, sigurisht, këto prova ekzistojnë
23 dhe Trupi Gjykses duhet t'i vlerësojë dhe, ne mendojmë, që nuk
24 përputhen aspak me narrativën e Prokurorisë në lidhje me këtë
25 aspekt.

1 Tani kam dy fusha të tjera që dua të diskutoj, materialet
2 shkresore edhe materialet që pretendohet se janë sekuestruar
3 nga shtëpia e Jakup Krasniqit si dhe materialet që Prokuroria
4 ka marrë prej autoriteteve serbe në Beograd.

5 Të nderuar Gjykatës, Prokuroria i ka dhënë shumë rëndësi
6 provave shkresore të cilat i kanë shtjelluar në mënyra të
7 ndryshme në dosjen e tyre përfundimtare.

8 Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, unë këtë çështje do
9 ta ndaj në dy kategori të përgjithshme: së pari, materialet që
10 janë sekuestruar nga banesa e z. Krasniqi në nëntor të vitit
11 2020, dhe së dyti, materialet që e kanë prejardhjen nga
12 autoritetet serbe në Beograd, përfshirë këtu provën P3551 dhe
13 provën P1700. Në lidhje me të dyja kategoritë e këtyre
14 dokumenteve Prokuroria, të nderuar Gjykatës, pret që ju t'u
15 jepni peshën atyre si prova të përshtatshme për provat
16 parësore që duhet të kishin pasur.

17 Ne mendojmë që Prokuroria e ka shtrembëruar relevancën,
18 vlerën provuese të këtyre dokumenteve. Për arsye që do të
19 bëhen të qarta, sipas nesh, ju, të nderuar Gjykatës, duhet të
20 jeni tepër të kujdesshëm kur të mbështeteni në të dyja
21 kategoritë e dokumenteve që përmenda. Asnjë dëshmitari nuk i
22 është treguar një dokument i rëndësishëm për vërtetësinë,
23 verifikim apo për shpjegim. Si rezultat autenticiteti,
24 relevanca dhe vlera provuese mbeten kryesisht të patestuara.

25 Të flasim për materialet që janë sekuestruar nga banesa e

1 z. Krasniqi, të cilat i kemi trajtuar në paragrafët 66 deri në
2 74, 76 deri në 77, 365 dhe 441 të dosjes sonë përfundimtare.

3 Prokuroria ka ndërtuar një "teori mbivendosëse" ku
4 argumenton se mjafton për të vërtetuar vlerën provuese të
5 dokumenteve për të dënuar Jakup Krasniqin me prova të tjera të
6 cilat i përmendin në dosjen e tyre përfundimtare. Kjo teori,
7 në fakt, është një përpjekje për të mos thirrur ekspertë
8 kriminalistikë për të peshuar dhe për të vlerësuar dokumentet
9 në mënyrë që të jetë në favor të argumenteve të Prokurorisë.
10 Teoria e tyre nuk mjafton për argumentet që parashtrojnë.

11 Kjo teori përputhet, në fakt, në mënyrë konsistente dhe
12 me hulumtime historike të mëvonshme, hartime apo materiale që
13 qarkulluar në mënyrë të gjerë. Fakti që dokumentet
14 "mbivendosen" nuk mjafton për të identifikuar autorin e
15 shënimit përkatës, procesverbalit apo komunikatës. Mund të
16 ketë pasur autorë të ndryshëm që kanë përdorur të njëjtin
17 burim. Ju nxisim, të nderuar Gjykatës, të zbërtheni secilin
18 nga faktorët të renditur në paragrafët 1486 të dosjes së
19 Prokurorisë. Faktor pas faktori të renditur në paragrafin 1486
20 sepse, sipas nesh, nuk janë asgjë më shumë sesa përfundime
21 subjektive dhe janë përpjekur në çdo mënyrë të mos vërtetojnë
22 autorësinë e një materiali.

23 Është pranuar gjerësisht nga Prokuroria se z. Krasniqi ka
24 qenë një mësues dhe një historian dhe ka botuar libra.

25 Prokuroria nuk merr parasysh provat se z. Krasniqi po mblidhte

1 materiale në lidhje me UÇK-në pas luftës për të shkruar librin
2 e tij për gati dy dekada përpara kontrollimit dhe sekuestrimit
3 më 4 nëntor 2020. Z. Krasniqi, në 2007-n, 13 vjet para
4 gjyqimit të Haradinaj, bëhet fjalë për provën P800, ka thënë:

5 "Kam shkruar një libër, 'Kthesa e madhe' dhe që të
6 shkruaja këtë librin më duhet të konsultohesha me
7 literaturën."

8 Dihet gjerësisht se Prokuroria ka hetuar ngjarje në
9 Kosovë qysh prej 2015-s. Nëse Jakup Krasniqi do të kishte
10 menduar se materialet hulumtuese dhe dokumente të tjera në
11 shtëpinë e tij do të ishin pjesë e një ndërmarrje kriminale të
12 përbashkët ku ishte dhe ai pjesë apo që të ishin inkriminuese
13 për të, atëherë pse do t'i mbante ai këto dokumente? Fakti që
14 i mbante haptazi, nuk e shkatërroi, duhet parë në favor të tij
15 sepse ai është i bindur që është i pafajshëm.

16 Diku tjetër në dosjen e tyre, konkretisht në paragrafin
17 4, 1448, 1518 dhe 1519, Prokuroria ju kërkon ju, të nderuar
18 Gjykatës, të shqyrtoni akuzat për ndërhyrjen e dëshmitarëve
19 dhe frikësimin e dëshmitarëve për shkak të fajësisë. Unë nuk
20 po flas për këtë, por dua të theksoj se nuk është ngritur
21 sikur një akuzë e vetme në këtë proces gjyqësor që Jakup
22 Krasniqi t'i ketë shkruar në mendje e jo më të jetë përpjekur
23 të ndërhyjë me ndonjë person dëshmitar apo këto tjetër.
24 Sjellja e tij në këtë proces gjyqësor, respekti për ligjin,
25 ruajtja e dokumenteve në shtëpinë e tij pavarësisht se e dinte

1 se po kryhej një hetim penal, të paktën meriton disa rreshta
2 pozitivë nga Prokuroria. Ne mendojmë që këta faktorë janë në
3 favor të tij dhe pikërisht tregojnë që ai është tërësisht i
4 vetëdijshëm se është i pafajshëm.

5 Në paragrafin 1486 të dosjes përfundimtare Prokuroria
6 shtrembëron deklaratat hyrëse të z. Krasniqi duke pretenduar
7 se z. Krasniqi ka pranuar në gjykatë autorësinë e shënimeve
8 dhe dokumenteve të tjera që janë sekuestruar në shtëpinë e
9 tij. Në ekran kemi transkriptin e 5 prillit 2023. Z. Krasniqi,
10 në fakt, ka thënë:

11 "Mos keqkuptoni shënimet e mia, shënimet që kam shkruar
12 për librat e mi dhe esetë dhe mos i përdorini këto si prova
13 për veprimtari penale ..."

14 Dhe më pas e sqaroi:

15 "Ju lutem me mirësjellje mos lejoni që të përdoren
16 materialet në këtë mënyrë sikurse është rasti i shënimeve që
17 kam shkruar unë për të shkruar një libër."

18 Nuk mund të interpretohen fjalët e tij si pranim i
19 autorësisë të të gjitha materialeve që janë sekuestruar prej
20 shtëpisë së z. Krasniqi. Ky është një shtrembërim grotesk dhe
21 të thuash që ai ka shkruar disa shënime sepse janë sekuestruar
22 nga shtëpia e tij pa asnjë provë të cilat pa asnjë moment të
23 vetëm nuk e ka pranuar, ai asnjëherë të vetme nuk ka thënë që
24 materialet që janë gjetur në shtëpinë e tij kanë qenë të
25 shkruara prej tij. Nuk e ka thënë diçka të tillë. Ai, në fakt,

1 ka pranuar që ka bërë disa shënime për të shkruar një libër,
2 po kjo nuk do të thotë që materialet ishin domosdoshmërisht në
3 lidhje me konfliktin, por kanë qenë shkrime që lidheshin me
4 konfliktin pas periudhës përkatëse.

5 Procesi është thjesht një proces burokratik. Prokuroria
6 në mënyrë të vazhdueshme nuk i ka pranuar kundërshtimet e
7 Mbrojtjes lidhur me sekuestrimet që janë bërë, kontrollimet që
8 janë bërë. Nuk po diskutojmë për këtë, por është barrë e
9 Prokurorisë të vërtetojnë se këto dokumente vërtet lidhen me
10 akuzat, përfshirë autorësinë e z. Krasniqi dhe gjithashtu të
11 vërtetojnë autenticitetin dhe besueshmërinë e dokumenteve.
12 Diçka që nuk e kanë bërë deri tani.

13 Si shumë avokatë që mbledhin, të paktën unë, mbledh libra
14 dhe lexoj atë që më intereson mua të lexoj. Prokuroria pa
15 asnjë bazë, hamendëson që edhe nëse dokumentet janë
16 sekuestruar prej shtëpisë së Jakup Krasniqit, ai e ka ditur
17 patjetër për çfarë flitej në këto dokumente, apo që i ka
18 lexuar të gjitha dokumentet apo që është pajtuar me
19 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre. Po ashtu personat e dinin
20 se Jakup Krasniqi ka qenë shumë i interesuar në periudhën pas
21 luftës edhe vjen nga bota akademike. E dinin se ai
22 grumbullonte çdo material që lidhej me UÇK-në. Kjo nuk lidhej
23 aspak me hipotezën e Prokurorisë dhe nuk duhet të jetë aspak
24 një argument bindës.

25 Më pas Prokuroria përpiket t'i atribuojë çdo përmbajtje.

1 Në paragrafin 1486 në dosjen e tyre Prokuroria pretendon se
2 shënimet me doemos reflektojnë dijeninë e z. Krasniqi sepse
3 janë të nivelit të Shtabit të Përgjithshëm, që janë marrë në
4 emër të Shtabit të Përgjithshëm, që trajtojnë Shtabin e
5 Përgjithshëm apo që pasqyrojnë informacione që janë komunikuar
6 Shtabit të Përgjithshëm dhe anasjelltas. Këto janë etiketime,
7 këto nuk janë prova. Shtabi i Përgjithshëm ka pasur shumë
8 takime, shumë pjesëmarrës dhe të thuash temë në nivel të
9 Shtabit të Përgjithshëm nuk e evidenton as personin që ka
10 marrë shënimet, as saktësinë e shënimeve apo në cilin takim
11 supozohet se janë marrë shënimet në fjalë.

12 Diapozitivi tjetër nuk është për publikun.

13 E njëjta gjë vlen për dokumentet që supozohet se janë
14 sekuestruar nga banesa e z. Krasniqi që Prokuroria parashton
15 se janë nënshkruar prej Jakup Krasniqit. Mjaft të themi që një
16 dokument syresh iu tregua Bislim Zyrapit gjatë intervistës së
17 tij me Prokurorinë, bëhet fjalë për provën P168 dhe P183 edhe
18 ai nuk ishte në gjendje ta njihnte nënshkrimin në dokument.
19 Sikurse e dini shumë mirë, të nderuar Gjykatës, Prokuroria nuk
20 thirri sikur vetëm një ekspert kaligrafik, por vetë u përpoq
21 të verifikonte nënshkrimin në këto dokumente përmes Bislim
22 Zyrapit, i njëjti dëshmitar që tha që nuk e njoh këtë
23 nënshkrim dhe këtë e ka thënë në intervistën e vitit 2019 me
24 Prokurorinë.

25 Fakti që fjalët "Jakup Krasniqi" shfaqen mbi një dokument

1 nuk nënkuptojnë se ato fjalë i ka shkruar pikërisht Jakup
2 Krasniqi. As nuk vërtetojnë se nënshkrimet e pretenduara kanë
3 qenë të shkruara prej tij. Kjo është e qartë.

4 Thjesht për faktin që një dokument është sekuestruar nga
5 banesa e Jakup Krasniqi nuk do të thotë që është një dokument
6 autentik, që ai të jetë autori i dokumentit dhe sigurisht që
7 nuk vërteton asnjë lloj përfshirje kriminale nga ana e z.
8 Jakup Krasniqi. Kjo vlen më shumë për faktin se Jakup Krasniqi
9 ka dhënë dëshmi në TPNJ dhe ka thënë që mblidhte materiale për
10 të bërë më shumë hulumtime për librin e tij dhe për qëllime
11 akademike. Tani Prokuroria duhet të jepte prova. I informuam
12 për këtë që në fillim të gjykimit, dhe iu thamë disa herë që
13 ata kishin barrën e provës në këtë drejtim.

14 Kjo vlen në fakt sidomos për dokumentet të shkruara apo
15 të nënshkruara që kanë thjesht inicialet në fund të faqes.
16 Trupi Gjykses ka dëgjuar dëshmi të dëshmitarëve të Prokurorisë
17 se inicialet tregojnë personin që e ka hartuar dhe e ka
18 shtypur një dokument të caktuar. Konkretisht kemi një
19 dëshmitar, W04739, kemi Bislime Zyrabin po ashtu, në faqen
20 18069. Inicialet janë një tregues i qartë që dikush tjetër, që
21 nuk ishte Jakup Krasniqi, ka hartuar dokumentin në fjalë dhe
22 nuk mund të thuhet automatikisht se Jakup Krasniqi ka pasur
23 dijeni apo përfshirje me dokumentin përkatës.

24 Edhe sikur një dëshmitar ta pranojë që një material
25 përputhet me materialet e asaj kohe, kjo nuk vërteton

1 autorësinë dhe as nuk provon se z. Krasniqi ka shkruar apo e
2 ka lexuar ndonjë dokument të caktuar. E para sepse bëhet fjalë
3 për shumë dekada më pas dhe as nuk vërteton se kur është
4 krijuar dokumenti. A ka qenë një dokument i shkruar në kohën
5 përkatëse apo është një dokument i hartuar pas ngjarjeve? A ka
6 qenë mbase me shënimet përkatëse për një arkiv të caktuar apo
7 ka pasur qëllime të tjera?

8 Prokuroria në mënyrë të vazhdueshme është përpjekur ta
9 prishë kronologjinë e ngjarjeve, prejardhjen dhe autorësinë.
10 Sipas nesh, Trupi Gjykses nuk duhet t'i mbushë këto boshllëqe
11 me spekulime që përdor Prokuroria, se Prokuroria i kishte
12 mjeteve dhe burimet e disponueshme që të gjente prejardhjen
13 ose t'u përgjigjet pyetjeve kryesore që janë ende pa përgjigje
14 tani që jemi në përfundim të gjykimit.

15 Ditën e hënë, në faqen e transkriptit 28476 edhe një herë
16 Prokuroria foli për "kompjuterin e z. Krasniqi" që ishte vendi
17 i punës së z. Krasniqi. I kujtohet Trupit Gjykses që 11 korrik
18 2014 në faqen e transkriptit 18052, 55, Mbrojtja e sqaroi dhe
19 një herë kundërshtimin e vazhdueshëm lidhur me dokumentet që
20 janë marrë nga vendi ku punonte z. Krasniqi, konkretisht që
21 Prokuroria nuk ka vërtetuar mbështeteshmërinë, autenticitetin
22 dhe nuk kishte asnjë bazë për të deduktuar autorësinë e
23 dokumenteve që ishin sekuestruar.

24 Diapozitivi tjetër nuk është për publikun.

25 Ajo që është marrë nga shtëpia e z. Krasniqi në nëntor të

1 2020-s ka qenë një material, një pajisje që nuk ishte lidhur
2 me monitor apo me energji elektrike. Kjo është prova 4D229,
3 4D230. Kjo njësi, kjo pajisje, pra, nuk ishte fare në
4 përdorim. Ishte vendosur mbi një radiator, siç e shihni, që
5 shërbente për të mbështetur disa veshje, pra, për të tharë
6 rrobat pasi ishin larë. E kemi vendosur në ekran - për t'ua
7 ilustruar, të nderuar Gjykatës, jo si provë, dhe Prokuroria
8 tha që nuk kishin kundërshtim që ta përdornim ne këtë -
9 gjendja se si ishte "kompjuteri i z. Krasniqi", kjo ishte pra
10 situata me "kompjuterin e z. Krasniqi" kur e ka gjetur
11 Prokuroria në banesën e tij.

12 Prokuroria nuk e ka vërtetuar si është zhvendosur kjo
13 pajisje nga Divjaka në 1998-1999 në një banesë private në
14 2020-n dhe as që është e njëjta pajisje që është treguar në
15 fotografitë që përdor Prokuroria si provë. Prova P1402, 1403,
16 1405, 1406 dhe prova 1264 në faqen SPOE00128711 apo ka pasur
17 dokumente të tjera që nuk i ka marrë parasysh më konkretisht.
18 Pra, cili është versioni përfundimtar, të nderuar Gjykatës?

19 Prokuroria nuk ka vërtetuar kush ka pasur qaske në
20 kompjuterin përkatës në vitet e mëpasshme, a e ka përdorur z.
21 Krasniqi, kur janë krijuar dosjet elektronike apo nëse ka
22 pasur edhe projekte të papërfunduara që, në fakt, nuk u hoqën
23 asnjëherë nga stacioni i punës, nga vendi i punës.

24 Diapozitivat e radhës nuk janë për publikun.

25 Disa materiale iu treguan dëshmitarëve dhe e vetmja gjë

1 që u tha ishte që janë "sekuestruar nga Jakup Krasniqi", nuk u
2 sqarua asnjëherë a ishin dosje elektronike, a ishin kopje
3 fizike. Dëshmitarët kanë thënë që ishte hera e parë që
4 shikonin këto dokumente, por kjo nuk vërteton asgjë. Për
5 shembull, Fondaj, transkripti i 26 qershorit 2024, faqja
6 17245, 17246, po ashtu Dëshmitari W04739 ,transkripti i 22
7 prillit 2024, faqet 14606, 07. Përgjatë gjithë gjykimit, në
8 mënyrë të vazhdueshëm, ai ka kundërshtuar materiale të këtij
9 lloji. Më konkretisht në faqen 3490 të transkriptit kemi thënë
10 që të mos pranohen materialet e sekuestruara. Prokuroria është
11 mbështetur në dokumentet elektronike nga vendi i punës së tij
12 dhe kjo tregon se Prokuroria, në fakt, nuk ka arritur të
13 vërtetojë autorësinë e një dokumenti. Në dosjen 1487
14 Prokuroria e pranon se kompjuteri është përdorur nga persona
15 të shumtë. Të thuash tani anëtarë të tjerë të Shtabit të
16 Përgjithshëm herë pas here, nuk duhet ta lejojnë Trupi Gjykses
17 të dalë në përfundimin që dokumentet elektronike konkrete kanë
18 qenë patjetër të shkruar nga z. Krasniqi apo për të cilat ka
19 pasur dijeni aso kohe. Sekuestrimi i kompjuterit nga një
20 banesë private në vitin 2020 nuk mund të shërbejë për të thënë
21 që çdo dokument i mundshëm ka qenë dokument i z. Krasniqi.
22 Sepse thjesht të dhënat kryesore metadata të materialeve që
23 janë hequr nga kompjuteri i punës nuk janë të mjaftueshme për
24 të vërtetuar autorësinë.

25 Po ashtu Prokuroria është përpjekur t'i atribuojë z.

1 Krasniqi materiale të tjera që janë diskutuar në paragrafët
2 1486, 1487 të dosjes së tyre përfundimtare.

3 Disa dokumente nga një periudhë e mëparshme që thuhet që
4 lidhen me rolin e z. Krasniqi në LDK nuk tregojnë
5 domosdoshmërisht që kanë qenë pjesë në kompjuterin e tij gjatë
6 periudhës së aktakuzës.

7 Disa përgjigje të intervistave, disa materiale
8 elektronike apo qoftë dhe kopje fizike me shënime nuk
9 vërtetojnë aspak autorësinë, sidomos pa pasur prova që të
10 evidentojnë kaligrafinë e një personi.

11 Prokuroria nuk ka provuar, për shembull, nëse z. Krasniqi
12 ka përgatitur vetë përgjigjet e pyetjeve apo nëse ai i ka
13 reflektuar përgjigjet e shkruara nga të tjerët. Dokumentet në
14 kopje fizike apo në USB apo dosjet elektronike nuk vërtetojnë
15 kur i ka marrë në zotërimin e tij, kush është autori i tyre
16 apo nëse i ka lexuar këto dokumentet gjatë periudhës së
17 aktakuzës. Kur dokumentet kanë inicialet e të tjerëve apo
18 duket se janë hartuar nga të tjerët, kjo tregon pikërisht që
19 ka pasur hartues të shumtë dhe përdorues të shumtë dhe nuk
20 mund të dilet në përfundimin që dokumentet në fjalë ishin
21 përgatitur vetëm nga z. Krasniqi.

22 Në mënyrë të vazhdueshëm Prokuroria në dosjen e vet citon
23 dokumente të sekuestruara nga banesa e z. Krasniqi dhe thonë
24 që kjo është provë që z. Krasniqi është autor, ka pasur dijeni
25 dhe ka lidhje me këto dokumente dhe pa dhënë një provë të

1 vetme. Kjo nuk vërteton kush i shkroi këto dokumente, kur janë
2 krijuar, pse janë mbajtur dhe si mbërritën në banesën e tij.

3 Diapozitivi i radhës po ashtu nuk është për publikun.

4 Në paragrafin 759 të dosjes përfundimtare, Prokuroria
5 pretendon se dy persona janë identifikuar si shënjestra në
6 "një bllok shënimesh të UÇK-së", pa dhënë sikur një faqe të
7 vetme -- duke përdorur një faqe që është gjetur në banesën e
8 z. Krasniqi që nuk ka as datë, as nënshkrim. Diapozitivi i
9 radhës në ekran tregon provën 1112. Prokuroria mbështetet në
10 provën P1112 në poshtëshënimin 3161 për të dalë në
11 përfundimin, se përndryshe nga përgjigjet që i ka dhënë
12 anëtarëve të familjes, z. Krasniqi e ka ditur se çfarë i ka
13 ndodhur atij personi.

14 Sidoqoftë, Prokuroria nuk vërteton kur e mori z. Krasniqi
15 provën P1112 si e mori, prej kujt e mori dhe kush e ka
16 shkruar. Nuk mund të dilet në përfundimin se e ka pasur
17 patjetër këtë dokument gjatë konfliktit apo kur ka folur me
18 anëtarët e familjes.

19 Sidoqoftë, Prokuroria ia paraqiti dokumentin, P1112 vetëm
20 një dëshmitari, Dëshmitarit W04739, i cili përmendi verën e
21 1998-s, po nuk mund të shtonte asgjë më shumë sepse ai, 4739,
22 nuk ka qenë vetë atje aso kohe. Këtë mund ta gjeni në
23 transkript në faqen 14188. Pra, pikërisht kjo tregon që nuk ka
24 asnjë vlerë provuese ky dokument.

25 Duke mos pasur asnjë dëshmitar ta shpjegojë provën P112,

1 atëherë nuk mund të thuhet që kjo provë shërben për të
2 vërtetuar që ai ka pasur dijeni. Ka thjesht emrin e personit
3 në fjalë, por nuk thotë që personi është ndaluar apo çfarë i
4 ka ndodhur këtij personi. Prandaj, sipas nesh, nuk mund të
5 lidhet z. Krasniqi me këtë argument të Prokurorisë.

6 Në paragrafin 284 të dosjes Prokuroria përmend deklarata
7 të drejtorisë së policisë ushtarake që pretendohet po ashtu që
8 janë sekuestruar prej banesës së z. Krasniqi. P586 është një
9 version i papërfunduar i disa shënimeve dhe Prokuroria bën një
10 krahasim me provën P300 dhe P270.10_ET. Sidoqoftë, të tri
11 dokumentet nuk kanë tregues të autorësisë, kanë tituj të
12 ndryshëm dhe data të ndryshme dhe asnjë ekspert kaligrafik nuk
13 është thirrur për të vërtetuar nëse këto shënime i ka bërë
14 vërtetë z. Jakup Krasniqi.

15 Në paragrafin 939, Prokuroria pretendon që "marrjet në
16 pyetje në Qirez përputhen" dhe ka përdorur një tekst pa datë
17 të cilit i është referuar si "pyetësor". Për këtë mund të
18 shikoni poshtëshënimin 3861. Po ky dokument lidhet me z.
19 Krasniqi thjesht se është sekuestruar nga banesa e tij, po
20 autori nuk dihet. Prokuroria në fakt nuk ngre asnjë akuzë
21 kundër z. Krasniqi lidhur me Qirezit dhe këtë dokument nuk ia
22 ka treguar asnjë dëshmitari dhe nuk është përpjekur asnjëherë
23 të bëjë një lidhje provuese mes ngjarjeve të Qirezit apo z.
24 Krasniqi. Rrjedhimisht, nuk mund të mbështeteni në këtë
25 dokument që ta lidhni z. Krasniqi me krimet e pretenduara në

1 Qirez.

2 Vetë citimet e Prokurorisë në dosjen e vet nuk mbështesin
3 propozimet e saj dhe duhen trajtuar me shumë kujdes. Në
4 paragrafin 561, mbështetet vetëm në provën 3765 për të
5 pretenduar se shënimet me shkrim dore që janë gjetur në
6 banesën e z. Krasniqi shpreheshin se asgjë nuk duhet
7 nënshkruar pa miratimin e Shtabit të Përgjithshëm. Por prova
8 3765 nuk është sekuestruar nga banesa e z. Krasniqi. Por, në
9 fakt, nëse hyni në metadatat e *Legal Workflow* do ta kuptoni që
10 është sekuestruar prej z. Selimi.

11 Në poshtëshënimin 6288, Prokuroria argumenton se Trupi
12 Gjykues nuk duhet të dalë në përfundim negativ sa i takon
13 peshës apo vlerës provuese të shtatë dosjeve që ishin fshirë
14 nga kompjuteri i punës thjesht sepse ishin dokumente të
15 fshira. Edhe më shqetësuese në këtë rast është se dosjet ishin
16 përfshirë përpara sekuestrimit dhe u rikuperuan më pas nga
17 Prokuroria përmes specialistëve forensikë. Praktikisht,
18 përpara se t'i rikuperonin, nuk do t'i kishin parë në
19 stacionin e punës asnjë përdorues edhe as vetë z. Krasniqi nuk
20 mund ta dinte që kanë qenë këto dokumente në kompjuterin e
21 tij, ndonëse ai e ka përdorur këtë kompjuter.

22 Prokuroria nuk është përpjekur aspak të lidhë faktet kur
23 janë krijuar dosjet, kur janë redaktuar apo dhe kur janë
24 fshirë dhe nuk mund të thonë që medoemos z. Krasniqi e ka
25 ditur sepse e përdorte atë kompjuter pune. *Hardware* në vitin

1 2020 nuk vërteton se ai ka pasur dijeni se çfarë të dhënash ka
2 pasur në këtë kompjuter më parë dhe çfarë të dhënash ishin
3 fshirë në këtë kompjuter më pas.

4 Në paragrafin 1486, 87 të dosjes përfundimtare dhe në
5 parashtrimet me gojë, për shembull, në transkriptin e 2
6 prillit në faqen 24168, Prokuroria argumenton se në fakt mund
7 të dali me disa deduksione. Ky është një pozicion i rrezikshëm
8 dhe tërësisht i gabuar. Siç duket në paragrafët 66, 74,365 dhe
9 441 të dosjen sonë përfshirë përmes dokumenteve që janë
10 trajtuar më herët në këto parashtrime - si konkretisht në
11 provën 1402, 1403, 1405, 1112, 586 - hapat themelore që
12 mungojnë janë trajtuar nga Prokuroria sikurse të jetë Mbrojtja
13 ajo që ka barrën e provës për t'i vërtetuar ato. Është e
14 kundërta. Është pikërisht e kundërta. Barra e provës është e
15 Prokurorisë. Dhe Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim që t'i
16 kundërshtojë dhe të gjejë barrën e provës. Kështu që shpallja
17 e fajësisë kërkon prova përtej dyshimit të arsyeshëm.

18 Këto shembuj tregojnë se Prokuroria po ju kërkon ju, të
19 nderuar Gjykatës, të spekuloni, jo të konstatooni faktet dhe
20 dokumentet gjyqësore. Autenticiteti dhe atribuimi janë të
21 vërtetuar përmes themelimit dhe jo përmes lidhjeve rastësore.
22 Dokumentet që pretendohen që janë marrë në kopje fizike duhet
23 të verifikohen, duhet të gjendet ku është gjetur secili
24 dokument edhe duhet të vërtetojnë autorësinë, periudhën kohore
25 edhe më tej. Materialet digjitale kërkojnë kriteret e veta,

1 atribuimin e pajisjes, kërkojnë integritet forensik dhe
2 ruajtjen e metadatave. Në rast se kontestohet autorësia apo
3 nënshkrimi atëherë kërkon një ekspert kaligrafik. Pra, të
4 gjitha këto tregojnë që Prokuroria nuk ka respektuar barrën e
5 provës.

6 Tani do të flas për kategorinë e dytë të dokumenteve që
7 janë materialet nga shteti serb. Tani i kthehem një kategorie
8 tjetër dokumentesh që kanë ardhur nga institucionet serbe dhe
9 që ngrenë një problem tjetër po aq serioz mbi besueshmërinë. I
10 kemi në paragrafin 55, 65 të dosjes sonë.

11 Prokuroria është bazuar shumë mbi dokumentet që kanë ardh
12 nga shteti serb pa një zinxhir komandimi apo kontrolli të
13 sigurtë. Pa atë, Trupi Gjykses nuk mund të vlerësojë
14 ligjshmërinë, autenticitetin dhe besueshmërinë. Dhe vetëm ky
15 gabim duhet të ngrejë shqetësime dhe kujdes të madh në
16 peshimin e këtyre dokumenteve. Konteksti është i rëndësishëm.
17 Këto materiale janë grumbulluar nën regjimin e Beogradit në
18 kohën kur ky regjim është dënuar nga pikëpamja ndërkombëtare
19 për krime kundër shqiptarëve të Kosovës dhe për dhunë masive
20 në Bosnjë dhe Kroaci që ka çuar në një numër të madh
21 refugjatësh. Kosova ishte në qendër të këtij rrëfimi të
22 politikës së këtij shteti duke rritur rrezikun e materialeve
23 të politizuara dhe të falsifikuara.

24 Tani të kalojmë në këtë pikë konkrete të provave. Prova
25 materiale 4D107 që është një vlerësim javor i Misionit

1 Mbikëqyrës të Komunitetit Evropian i cili ka të bëjë me
2 policinë e Gjakovës, dhe më pas ka konstatime të KDOM-it dhe
3 se lëndimet dhe vendosja e tyre janë të papërputhshme me
4 pretendimin se këtë aksion e ka filluar UÇK-ja. Në 4D108,
5 KDOM-i është një raport i policisë i cili kundërshtohet nga
6 provat në vend, përfshirë edhe luftën në Rahovinë në 25 nëntor
7 1998. Në faqe SPOE00133491, e njëjta provë që ka të bëjë me të
8 ashtuquajturat armë apo depo armësh të UÇK-së e cila nuk mund
9 të konfirmohet dhe mund të jetë një operacion i implantuar i
10 ushtrisë jugosllave.

11 Tani kemi transkriptin në faqen 26580. Në 4D106, që është
12 Rubin më 28 maj 1999 që ka të bëjë me autoritetet serbe si i
13 kanë mbuluar ata krimet dhe kanë akuzuar në mënyrë false UÇK-
14 në. Ky është transkripti i Rubin i 15 shtator 2025, 267579,
15 581. Po të shihen së bashku, këto dokumente tregojnë një model
16 të përsëritur që materialet zyrtare serbe kundërshtohen nga
17 verifikimi në terren. Trupi Gjykues duhet t'i trajtojë këto
18 materiale si materiale bazë me interes dhe jo si provë në
19 qoftë se nuk janë të miratuara apo të provuara në mënyrë të
20 veçantë.

21 Materialet e prova të kësaj natyre janë fabrikime të
22 skemave të krijimit nga autoritetet serbe. Vëzhguesit
23 ndërkombëtarë kanë shpjeguar pikërisht pengimin në raportimin
24 e shpërndarë nga autoritetet serbe. Fred Abrahams e bëri të
25 qartë këtë dallim mes medias së pavarur dhe medias shtetërore

1 duke iu referuar masakrës në Obrinjë dhe *The Human Right Watch*
2 e tregoi se ka shkelje serioze të rregullave të luftës.

3 Në letrën për presidentin e Këshillit të Sigurimeve më 16
4 mars 1999, presidenti i TPNJ-së i tregoi Këshillit se si
5 Republika Federale e Jugosllavisë nuk kishte zbatuar detyrimet
6 për të lejuar Prokurorinë dhe hetuesit që të hyjnë në Kosovë
7 për të hetuar Reçakun, masakrën e Reçakut. P4259. Williams,
8 transkripti në faqen 26854. Patologu John Clark konfirmoi se
9 hollësitë e vendit të krimit kanë krijuar mundësinë që kjo të
10 kishte qenë e montuar, që ndodhet në faqen e transkriptit
11 24422, 24423. Abrahams po kështu dha dëshmi se sa i përket
12 vrasjeve në Radoniq, në liqenin e Radoniqit, ekipi i tij i *The*
13 *Human Right Watch* nuk u lejua që të shkonte aty ku ishin
14 mbajtur trupat e viktimave. Ndodhet në transkriptin në faqen
15 7437.

16 Dhe shqetësimi lidhur me besueshmërinë nuk janë thjesht
17 të natyrës historike. Ato kanë dalë në pah këtu në këtë sallë
18 gjyqi. Një numër dëshmitarësh kanë identifikuar paqartësi në
19 deklaratat e shënuara nga autoritete serbe. Diapozitivi në
20 vazhdim -- deklarata e 2007-s e treguar autoriteteve, që kur
21 iu tregua W01163 dhe kjo deklaratë e autoriteteve serbe tha se
22 "ato që kanë krijuar duket sikur po i improvizojnë", nuk mund
23 të shpjegojnë dot se si janë shkruar këto deklarata dhe nuk
24 tha si ju kishte dhënë ai këtë informacion. Dhe ky dokument
25 vjen nga prova materiale 2D8. Nuk është për publikun.

1 Dëshmitari 1236 në të njëjtën mënyrë ka hedhur poshtë
2 pjesë kyçe nga deklarata e tij për autoritetet serbe: "Jo, atë
3 e kanë shkruar gabim, unë nuk e thashë një gjë të tillë",
4 ndodhet në provën 2D8, faqja 5298. Dhe tjetra, "Jo, e kanë
5 shtuar një gjë të tillë", 2D8, 5300. Dëshmitari 1236 i tha
6 Gjykatës në vitin 2007 se nuk e dinte se çfarë ishte shkruar
7 pasi nuk kuptonte serbisht dhe nuk e ka lexuar dot vetë, 2D8,
8 faqja 5299. Dhe deklarata nuk i është lexuar me zë të lartë
9 atij përpara nënshkrimit, pavarësisht se shënimi sipër këtij
10 nënshkrimi thotë se një gjë e tillë është bërë, 2D8, faqja
11 5299.

12 Trupi Gjykses do të mbajë parasysh edhe faktin që
13 autoritetet serbe kanë përdorur torturën përpara dhe pas
14 konfliktit me qëllim që të siguronin deklarata nga shqiptarët
15 e Kosovës. 2D34, P743. Dëshmitari 3878 tha se autoritetet
16 serbe e kishin marrë në pyetje atë përmes torturës lidhur me
17 lidhjet e tij të ashtuquajtura me UÇK-në.

18 Sa u përket materialeve që i janë dhënë Prokurorisë nga
19 autoritetet serbe - dhe e kam fjalën për P02094, P03551 dhe 40
20 materialet e tjera të ngjashme të cilat ndodhen në
21 poshtëshënimin 252 të dosjes sonë - ne bazohemi, ne i kemi
22 paraqitur këto në parashtrimet tona në paragrafët 56 deri në
23 65 të dosjes sonë.

24 Diapozitivi tjetër nuk duhet transmetuar publikisht. Të
25 nderuar Gjykatës, më duhet të kaloj në seancë private për këtë

1 pjesë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretaria,
3 të kalojmë në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 kemi kaluar në seancë publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
24 Vazhdoni.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Pavarësisht perspektivës

1 linding shumë pyetje. Ku ishin këto materiale në 25 vitet e
2 mëparshme? Ku kanë qenë ato gjatë gjithë ekzistencës së TPNJ-
3 së të Kombeve të Bashkuara? Përse nuk ekziston varianti
4 origjinal? Sa të sakta janë ato? A janë ndryshuar? A ka patur
5 ndërhyrje? Në bazë të pyetjeve që kanë ngritur pala e
6 Mbrojtjes dhe provave të qarta të përpjekjeve të organizuar të
7 autoriteteve serbe gjatë dhe pas konfliktit, ndërhyrjes në
8 skenat në vendet e krimit dhe në prova të cilat janë të
9 inskenuara, të gjitha janë raportuar në mënyrë të pavarur nga
10 Bashkimi Evropian që ndodhet në 4D07, 4D08 - nga Shtetet e
11 Bashkuara siç është e dhënë në telegramet - për shembull,
12 P1070, 1071, 1072 dhe të tjera, ne parashtrojmë se Prokuroria
13 nuk e ka realizuar të arrijë barrën e provës që janë këto
14 materiale në të cilat nuk mund të mbështetesh për të fajësuar
15 klientin tim.

16 Por në të dyja këto kategori, Prokuroria i kërkon Trupit
17 Gjykses që të hamendësojë lidhur me të vërtetën, autorësinë
18 dhe njohurinë, duke lënë pa provuar bazat që kanë të bëjnë me
19 zinxhirin e kontrollit, autenticitetin, besueshmërinë, kohën,
20 origjinën dhe kontekstin e dëshmitarëve. Dokumentet e marra
21 nga rezidenca e z. Krasniqi dhe materialet që vijnë nga
22 autoritete serbe tregojnë që këto defekte mbeten të
23 pazgjithura. Ne i kërkojmë Trupit Gjykses që të mos mbushë
24 hendeqet e provës me spekulime dhe t'i japë peshë shumë
25 minimale këtyre çështjeve bazë.

1 Të nderuar Gjykatës, kur flitet për rolin e z. Jakup
2 Krasniqi si zëvendëskomandant për mbështetje, Prokuroria
3 vazhdon që të përzgjedhë prova fajësuese duke injoruar
4 sqarimet dhe provat shfajësuese. Në paragrafin 563 të dosjes
5 së saj, Prokuroria vëren se z. Krasniqi u bë zëvendëskomandant
6 për mbështetje si pjesë e ristrukturimit të nëntorit të 1998-
7 s. Jemi dakord. Prokuroria vazhdon:

8 "Në këtë mënyrë, Shtabi i Përgjithshëm e rriti në pozitë
9 zëdhënësin e shpërndarjes publike të synimit të përbashkët në
10 një post në të cilin kishte kontroll logjistik për të
11 kontrolluar veprimet në territor."

12 Dua që ta zhvilloj këtë argument për një çast.

13 Më lejoni ta them qartë, unë nuk jam dakord që pas
14 nëntorit 1998 z. Krasniqi ka patur "kontrollin logjistik të
15 domosdoshëm për të shkaktuar që në terren të bëhen veprime
16 konkrete". Ta them më në hollësi. Provat nuk tregojnë që z.
17 Krasniqi ka patur kontroll mbi logjistikën. Nuk ka vërtetuar
18 se ai mund të kishte ndikim në ndonjë veprim në terren. Dhe as
19 nuk tregon ndonjë kontroll logjistik që mund të ketë pasur, që
20 pretendohet të ketë pasur të jetë lidhur në ndonjë mënyrë me
21 ndonjë krim të aktakuzës. Në pjesën që vazhdon të këtij
22 seksioni do të demonstrojmë gabimet e Prokurorisë lidhur me
23 rolin e z. Krasniqi dhe kompetencat pas nëntorit të vitit
24 1998.

25 Megjithëkëtë, paragrafi 563 i dosjes së Prokurorisë

1 përbën një pranim të rëndësishëm nga pala e Prokurorisë. Aty
2 pranohet se në nëntor të vitit 1998, z. Krasniqi u ngrit në
3 një post të cilin nuk e ka pasur më parë. Pranon se para
4 nëntorit 1998, ai nuk ka patur kontrollin logjistik të
5 domosdoshëm për të shkaktuar që në terren të ketë veprime
6 konkrete dhe përpara nëntorit 1998 ka qenë, sipas Prokurorisë,
7 zëdhënës.

8 Zëdhënësi nuk është një komandant ushtarak i cili ka
9 kontroll ushtarak. Përgjegjësia penale mund t'i atribuohet
10 zëdhënësit vetëm në rastet kur deklaratat specifike lidhen me
11 krime specifike. Prokuroria as nuk i është afruar arritjes së
12 pragut në këtë rast.

13 E njëjta gjë përmendet edhe në paragrafin 619 të dosjes
14 së Prokurorisë, ku pretendohet që z. Krasniqi kishte kontroll
15 logjistik "kryesisht në rolin e tij si zëvendëskomandant për
16 mbështetje".

17 Prokuroria e di që z. Krasniqi nuk ka patur çfarëdolloj
18 kontrolli në rolin e tij të mëparshëm si zëdhënës dhe
19 Prokuroria është e kujdesshme që t'i kufizojë pretendimet pas
20 caktimit të tij si zëvendëskomandant i mbështetjes për
21 kontrollin logjistik dhe jo operativ.

22 Në vlerësimin e parashtrimin e Prokurorisë lidhur me
23 rolin e z. Krasniqi si zëvendëskomandant për mbështetje, duhet
24 të mbajmë parasysh, është e rëndësishme të mbahet parasysh se
25 ai e ka ushtruar këtë rol për një periudhë shumë të shkurtër

1 që prej tre muaj e gjysëm, 115 ditë. U caktua në mes të
2 nëntorit 1998. Në atëkohë, sapo kishte filluar ristrukturimi.
3 Shtabi i Përgjithshëm nuk ka patur as seli fikse dhe struktura
4 të rëndësishëm si, për shembull, departamenti ligjor, nuk kanë
5 filluar që të krijohen deri pas arritjes në Divjakë të
6 Dobrunës një muaj më vonë në dhjetor të vitit 1998. Paragrafët
7 115, 120 të dosjes sonë. Z. Krasniqi shkoi në Rambuje në
8 fillim të shkurtit 1999 dhe u kthye në Kosovë pas atij viti
9 kur dha dhe dorëheqjen si zëvendëskomandant i mbështetjes pas
10 disa ditëve. Kjo gjendet në paragrafët 503(d) dhe 630 të
11 dosjes sonë.

12 Çdo konstatim që z. Krasniqi ka ushtruar kontroll apo e
13 ka patur mundësinë për të parandaluar apo për të dënuar krimet
14 e kësaj periudhe do të duhet të ballafaqohen me realitetin që
15 ai është rritur në pozitë, po të përdorim gjuhën e
16 Prokurorisë, në këtë post për vetëm disa muaj të shkurtër, në
17 kohën kur strukturat e Shtabit të Përgjithshëm dhe drejtoritë
18 e tij ishin vetëm në proces të krijimit e sipër.

19 Ne do të flasim për disa raste të Prokurorisë, që ne nuk
20 do të kemi kohë për t'i diskutuar të gjitha karakteristikimet e
21 gabuara apo rastet kur Prokuroria nuk ka shprehur qartë akuzat
22 e saj, pasi është ky një material të cilin e kemi diskutuar në
23 plotësi në dosjen tonë.

24 Prokuroria në paragrafin 562 thotë që z. Krasniqi mori
25 pjesë në takime të Shtabit të Përgjithshëm të cilat kanë çuar

1 në emërimin e personelit të nivelit të lartë dhe anëtarëve të
2 NKP-së.

3 E di që ky pretendim i aktakuzës, paragrafi 51(e) ishte
4 që z. Krasniqi ka kontribuar në mënyrë të qartë në NKP duke
5 "caktuar, rritur në pozitë apo miratuar emërimin dhe
6 promovimin e anëtarëve dhe veglave të NKP-së duke përfshirë
7 persona të cilët kanë patur histori të rolit të tyre në
8 kryerjen e krimeve të rënda". Pra, caktimi, promovimi dhe
9 miratimi i emërimeve është zvogëluar në "pjesëmarrje në
10 takimet e Shtabit të Përgjithshëm ku janë bërë këto caktime".

11 Problemi me parashtrimet e Prokurorisë është se nuk
12 identifikon se çfarë roli ka luajtur Krasniqi për këto
13 caktime. Arkitekti i ristrukturimit të nëntorit 1998 nuk ishte
14 z. Krasniqi po Bislam Zyrapi, i vetmi anëtar i Shtabit të
15 Përgjithshëm me përvojën ushtarake të domosdoshme për ta
16 krijuar këtë strukturë. Kjo është në paragrafin 4888 të dosjes
17 sonë. Paneli po kështu nuk duhet ta anashkalojë faktin që vetë
18 z. Krasniqi u caktua si zëvendëskomandanti mbështetës në të
19 njëjtat takime të Shtabit të Përgjithshëm, në të njëjtin takim
20 të Shtabit të Përgjithshëm më 12 nëntor 1998. Përpara saj,
21 sipas analizës së vet Prokurorisë, siç kemi dëgjuar, ai ka
22 qenë thjesht zëdhënës dhe ne themi që nuk ka patur kompetenca
23 për të emëruar askënd.

24 Nuk janë paraqitur prova lidhur me procesin e emërimit të
25 Fatmir Limajt, i cili foli, kush foli në favor, kush kundër

1 apo për njohuritë e kohës të pjesëmarrësve lidhur me
2 pretendimet kundër z. Limaj.

3 Për sa i përket Sokol Dobrunës, pala Mbrojtëse e ka
4 trajtuar çështjen e caktimit të tij në dosjen tonë
5 përfundimtare paragrafët 529, 531. Shkurt, dëshmitë të
6 Prokurorisë në P2099 përcaktojnë që dikush në Shtabin e
7 Përgjithshëm kishte kërkuar emërimin e z. Dobruna tre ditë
8 përpara takimit të 12 nëntorit. Zyrapi e konfirmoi se ky
9 emërim u propozua nga Ramush Haradinaj dhe më pas u bë nga
10 Azem Syla. Zyrapi po ashtu e pranoi që P1175 ishte thjesht
11 zyrtarizim i vendimit që kishte marrë Azem Syla. Nuk ka dëshmi
12 apo prova që Jakup Krasniqi ka patur vendim në caktimin e
13 Dobrunës.

14 Në dosjen përfundimtare të Prokurorisë nuk ka emërim të
15 tjera të treguara në mënyrë specifike. As edhe një i vetëm.
16 Është me vlerë të përmendet se në paragrafin 566 të dosjes së
17 tyre, Prokuroria, pretendimin kundër Jakup Krasniqit ia çon --
18 e përmend si përçim i emërimeve të bëra nga të tjerët, jo
19 personi që i ka bërë këto emërimet vetë.

20 Megjithëkëtë, Prokuroria përpigjet më pas që të vërtetojë
21 që kompetencat e z. Krasniqi për caktime janë, dhe kjo gjendet
22 në paragrafin 178, 79 përmes krijimit të një këshilli të
23 personelit të cilin pretendon se ai e ka kryesuar.

24 Paragrafi 178 i referohet dokumentit të dëshmimeve të cilat
25 përpigjen që të tregojnë se është krijuar një këshill i

1 personelit, megjithatë, Prokuroria nuk ka prova se si apo nëse
2 ky këshill në fakt ka funksionuar.

3 Është i spikatur fakti që në paragrafin tjetër të dosjes
4 së Prokurorisë, paragrafi 179, i cili supozohet që të fliste
5 lidhur me zbatimin e punës së këtij këshilli, Prokuroria
6 diskuton një takim të Shtabit të Përgjithshëm të 11 shkurtit
7 1999 dhe vendimin për ta zëvendësuar komandant Drinin ditën e
8 më pasme.

9 Ne e dimë që ku ka qenë Jakup Krasniqi më datën 11 dhe 12
10 shkurt 1999. Ishte në Rambuje. Nuk ka prova se kur ka qenë në
11 Rambuje në kohën e negociatave më të rëndësishme të të gjithë
12 konfliktit, z. Krasniqi as të jetë informuar lidhur me
13 caktimet në Kosovë dhe aq më pak që ai të ketë kryesuar ndonjë
14 takim të një këshilli funksionues.

15 Më lejoni që t'i kthehem edhe një herë problemit të
16 caktimit të Jakup Krasniqi si zëvendëskomandant për
17 mbështetje. Në paragrafin 105 të dosjes së saj, Prokuroria
18 pohon se z. Krasniqi u caktua zëvendëskomandant i parë me
19 autoritet të plotë dhe me funksione të komandantit të
20 përgjithshëm kur Azem Sylaj nuk ishte në Kosovë. E njëjta gjë
21 u përsërit nga z. Quick ditën e hënë, transkripti 468. Dhe nuk
22 është çudi, duke patur parasysh që nuk ka patur vërtetim, që
23 Prokuroria mbështetet vetëm në dëshminë e Bislime Zyrapit për
24 të mbështetur këtë pretendim krejtësisht pa bazë.

25 Së pari, Prokuroria harron dallimin e qartë të roleve

1 midis dy zëvendëskomandantëve, të cilin e pranoi dhe vetë
2 Bislím Zyrapi. Dhe kjo gjendet në faqen 18004, P1355.7, në
3 faqen 4 deri në 5. Jakup Krasniqi është marrë me çështjen e
4 mbështetjes dhe të çështjeve politike. Sokol Bashota është
5 marrë me çështje operative, janë dy funksione të dallueshëm
6 dhe nuk ka prova që të ketë patur ndonjë hierarki mes të dyve
7 apo që njëri prej tyre të ketë qenë zëvendës i parë, të jetë
8 emëruar si zëvendës i parë nga Azem Sylá.

9 Përkundrazi, P847 tregon një intervistë të botuar në Zëri
10 i Kosovës në tetor të 1999. Azem Sylá vetë e ka identifikuar
11 Sokol Bashotën - dhe vetëm Sokol Bashotës - si
12 zëvendëskomandantin e tij "deri në periudhën midis dy takimeve
13 në Rambuje". Kur edhe është zëvendësuar komandanti dhe dy
14 zëvendëskomandantët kanë dhënë dorëheqjen. Dhe kjo është në
15 paragrafin 488 të dosjes sonë.

16 Së dyti, dëshmia e Bislím Zyrapit në këtë çështje i
17 shërben vetëm atij dhe kundërshtohet nga dokumentacioni tjetër
18 i kësaj çështjeje. Së pari të gjithë dëshmitarët e tjerë të
19 UÇK-së që kanë dhënë dëshmi në këtë gjyq e kanë konsideruar
20 Bislím Zyrapin, jo Jakup Krasniqin, si shef i Shtabit të
21 Përgjithshëm si përgjegjës në Kosovë kur Azem Sylá nuk ka
22 qenë në Kosovë.

23 Në vitin 2016 dhe 2018 Bislím Zyrapi tha që:

24 "Në nëntor të 1998-s, unë u caktova si shef i Shtabit të
25 Përgjithshëm të UÇK-së."

1 Dhe specifikoi se në këtë rol ai ka urdhëruar dhe ka
2 miratuar operacione luftarake dhe ka menaxhuar dhe drejtuar
3 Shtabin e Përgjithshëm. P1356 dhe P775_ET.

4 Bislime Zyrapi ka vazhduar që ta quajë veten si shef i
5 Shtabit të Përgjithshëm edhe përpara këtij Trupi Gjykses,
6 derisa është ballafaquar me këtë gjë të kundërpjetjeve. Vetëm
7 në atë pikë ai u përpoq që të tërhiqej dhe ta hidhte poshtë
8 dëshminë e tij të mëparshme. Nodhet në transkriptin në faqen
9 17537, 17616, 17617. Për më tepër, gjatë luftës, Bislime Zyrapi
10 nënshkroi të paktën gjashtë dokumente të kohës si shef i
11 Shtabit të Përgjithshëm. Prokuroria vërtetë dëshiron që ne të
12 besojmë se Bislime Zyrapi, eksperti ushtarak, nuk ka patur
13 mundësi të dijë se çfarë kuptimi kishte titulli që mbante?

14 Dy diapozitivat e tjera nuk janë për shfaqje publike.

15 Në fakt ka dhe më tej. Komandantët dhe ushtarët e UÇK-së
16 përfshirë oficerët profesionistë si komandanti Drini dhe
17 Shaban Dragaj, dokumentet që i kanë dërguar Bislime Zyrapi ia
18 kanë dërguar si shef i Shtabit të Përgjithshëm. P1432, P1360.
19 Edhe një herë Prokuroria dëshiron që ne të besojmë që
20 komandanti Drini, oficer ushtarak shumë afër Bislime Zyrapi,
21 do t'i referohej z. Zyrapi si shef i Shtabit të Përgjithshëm
22 gabimisht?

23 Trupi Gjykses ka dëgjuar disa dëshmitarë të UÇK-së të të
24 gjitha niveleve që kanë dhënë dëshmi se ka patur vetëm një
25 shef të Shtabit të Përgjithshëm që ka qenë përgjegjës për të

1 tërë Kosovën dhe ky person ishte Bislime Zyrapin, i cili e ka
2 paraqitur veten me këtë titull. Këta dëshmitarë përfshijnë
3 Dëshmitarin 4764, 4739, 3781, 3870, Halil Qadrakun dhe Kurtesh
4 Fondajn. Ky gjendet në paragrafin 585 të dosjes sonë. Këto
5 prova janë provat në të cilat mund të mbështetesh, vërtetojnë
6 njëra-tjetrën dhe janë shumë të fuqishme dhe ekspozojnë
7 agjendën e z. Zyrapin. Duke patur parasysh se mund të fajësonte
8 veten, Bislime Zyrapin kërkoi ta mbronte veten duke e dërguar
9 për herë të parë -- duke ia hedhur fajin Jakup Krasniqit.
10 Pretendimi i tij i rremë që Jakup Krasniqi ka marrë përsipër
11 autoritetin e Azem Sylës kur ky nuk ishte aty, nuk është më
12 shumë sesa një përpjekje transparente e qartë që të shmangte
13 përgjegjësitë e tija. Ne themi se kjo është e qartë për Trupin
14 Gjykses. Trupi Gjykses nuk duhet të bjerë viktimë e
15 gënjeshtreve të Bislime Zyrapi. Këtë ne e paraqesim në
16 paragrafin 579, 588 të dosjes sonë.

17 Nuk është çudi që të gjitha dëshmitë që kemi shpjeguar
18 nuk janë pranuar të hënë nga z. Quick, që është një shembull
19 tjetër i Prokurorisë që përzgjedh. Përkundrazi, z. Quick u
20 përpoq që të shfrytëzonte provat e Naim Malokut për të thënë
21 që zëvendëskomandanti Krasniqi ishte më i lartë se Shefi i
22 Shtabit Zyrapin, dhe kishte rolin e komandantit të
23 përgjithshëm. Ndodhet në transkriptin në faqen 28469, 28470.
24 Në ekran, të nderuar Gjykatës, do të shihni dëshminë e Naim
25 Malokut që ndodhet në faqen e transkriptit 25943:

1 "PY. A është e saktë që ky posti i zëvendëskomandantit u
2 krijua për të formalizuar me shkrim vendimet apo propozimet që
3 janë marrë, për ndryshe, nga Shefi i Shtabit?

4 "PË. Po, nuk ka arsye tjetër."

5 Naim Maloku e konsideroi rolin e Jakup Krasniqit si
6 zëvendëskomandant për mbështetje si rol administrativ, jo
7 operativ. Nuk ishte një funksion komandues siç kuptohet në
8 kuptimin tradicional. Nuk kishte asgjë të përbashkët me
9 ushtrimin e autoritetit të komandantit të përgjithshëm që nuk
10 ndodhej aty, që atë nuk e ka thënë Naim Maloku.

11 Maloku tha edhe këtë, që ndodhet në transkriptin në faqen
12 25936:

13 "... ka patur vetëm tre oficerë", Maloku, Sali Veseli dhe
14 Zyrapi, "të cilët kanë patur kapacitet dhe njohuri
15 profesionale, dhe janë ata të cilët kanë ditur si të
16 organizonin Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe si të
17 caktonin përgjegjësinë për drejtoritë e ndryshme. Pjesa tjetër
18 e UÇK-së, e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nuk kanë patur
19 njohuri apo trajnim ushtarak."

20 Është e qartë se kush e ka drejtuar Shtabin e
21 Përgjithshëm të UÇK-së në mungesë të Azem Sylës: Bislime Zyrapi
22 dhe i shoqëruar nga ish-zyrtarët e tjerë profesionistë, jo
23 Jakup Krasniqi.

24 I njëjti argument kundërshton edhe pretendimin e
25 Prokurorisë së z. Selimi i ka raportuar z. Krasniqi, që

1 ndodhet në paragrafin 106 të dosjes përfundimtare të
2 Prokurorisë. Këto pretendime nuk janë të mbështetura me prova.
3 Është një shembull tjetër i gënjeshtreve të Zyrapit për t'i
4 shpëtuar përgjegjësisë.

5 Të nderuar Gjykatës, ky është një moment i duhur për të
6 marrë një pushim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është koha
8 për të marrë pushimin e pasdites. Do të takohemi sërish në
9 orën 3.15.

10 --- Seanca ndërpritet në orën 14.59

11 --- Seanca rifillon në orën 15.15

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 vazhdoni, znj. Alagendra.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
15 Gjykatës.

16 Të nderuar Gjykatës, kjo praktikë e njëjtë përsëritet
17 sërish në paragrafët 249 dhe 553 të dosjes së Prokurorisë, kur
18 Prokuroria ngre dy pretendime njësoj jokorrekte, të cilat
19 gjithashtu u përsëriten nga z. Halling të martën.

20 Pretendimi i parë është që Jakup Krasniqi ka mbikëqyrur
21 punën e departamentit juridik. Ky pretendim mbështetet në
22 dëshmitë spekulative dhe që i ka bërë për interesa të veta dhe
23 në fund jo tëbesimta të Bislime Zyrapit. Bislime Zyrapit nuk
24 është informuar për asnjë udhëzim të nxjerrë nga Jakup
25 Krasniqi dhe dhënë Dobrunës apo nuk ka asnjë informacion sa i

1 takon raportimit nga Dobruna Jakup Krasniqit, lidhur me punën
2 e departamentit juridik. Kështu që si mund të flitet për
3 mbikëqyrje ndërkohë që Dobrunës nuk i janë dhënë asnjë udhëzim
4 prej Krasniqit ose Dobruna nuk ka bërë asnjë raportim?

5 Zyropi pranoi që Sokol Dobruna duhet të jetë personi që
6 duhet të pyetet sa i takon mbikëqyrjes së punës së tij, më në
7 fund, duke zbuluar natyrën spekulative të pohimeve të tij. Për
8 procesverbal këtë mund ta shikoni në transkript në faqen
9 18538, 18539.

10 Të shohim pak tani se çfarë ka thënë Sokol Dobruna.
11 Dobruna i tha Prokurorisë që nuk kishte raportim zyrtar për
12 askënd në Divjakë - kjo jepet në provën 501955, në faqe 2 deri
13 në 3, - dhe se ai gjithmonë e ka kryer punën e vet në mënyrë
14 të pavarur dhe nuk është ndikuar fare dhe nuk ka pasur
15 kontroll nga anëtarët e Shtabit Përgjithshëm. Vetë Dobruna e
16 ka bërë të qartë për Jakup Krasniqin kur ai ka mbërritur në
17 Shtabin e Përgjithshëm se ai nuk dëshironte që askush të
18 përfshihej në përgjegjësitë e tij, dhe i ka thënë troç që ai
19 dhe vetëm ai do ishte personi që do merrej me aspekte
20 juridike. Kjo jepet në provën 1955 Pjesën 2. Gjithashtu edhe
21 në provën P01963. Raportet e vetme që Dobruna ka dhënë si shef
22 i departamentit juridik janë raporte që i ka bërë Azem Sylës
23 ,kur ky i fundit ka qenë në Kosovë. Kjo jepet në provën P01955
24 Pjesa 2 dhe Pjesa 9. Nuk është befasuese që edhe kësaj here
25 Prokurori, Prokuroria në përgjithësi nuk nxori asnjë dëshmi të

1 besueshme që Jakup Krasniqi i ka dhënë urdhër Sokol Dobrunës
2 ose Sokol Dobruna i ka raportuar Jakup Krasniqit.

3 Ja vlen që të shpenzojmë disa momente lidhur me
4 pretendimin konkret të bërë në dosjen përfundimtare të
5 Prokurorisë që Jakup Krasniqi ka këshilluar Sokol Dobrunën.
6 Bëhet fjalë për vëllezërit Salevic dhe pretendimi konkret
7 jepet në paragrafin 567, dhe këtu citojmë:

8 "[Krasniqi] e këshilloi Sokol Dobrunën se si të trajtonte
9 çështjen duke marrë parasysh pyetjet e shumta që vinin nga
10 vëzhguesit ndërkombëtarë."

11 Ky pretendim është theksuar përsëri, sikurse besoj e
12 mbani mend, të martën nga z. Halling në komente e tij
13 përmyllëse sa i takon Jakup Krasniqit. Megjithëse duhet të
14 theksoj që Prokurori e ngatërroi çështjen e vëllezërve Salevic
15 me çështjen e pesë pleqve serbë.

16 Dy diapozitivat e radhës nuk i duhen paraqitur publikut.

17 Në ekran shikoni provën P03551, faqen 111807. Kjo është
18 një bisedë e 28 shkurtit 1999 që është e vetmja provë që është
19 cituar në mbështetje të këtij pretendimi. Sikurse mund ta
20 shikoni, biseda këtu është midis "Sokolit" dhe "Jakupit", dhe
21 biseda ka të bëjë me diskutimet në vijim e sipër me Shaun
22 Byrnes dhe William Walker lidhur me vëllezërit Salevic.

23 Të duhet vetëm njohuri bazike për këtë çështje gjyqësore
24 për ta ditur që Sokol Bashota si kontakti kryesor i KDOM-it
25 amerikan, ishte personi që merrej me Byrnes dhe Walker, dhe jo

1 Sokol Dobruna.

2 Sikur kjo mos mjaftonte, z. Halling i cili përsëri të
3 martën na e tha këtë informacion, dhe këtu citoj paragrafin
4 567 të dosjes së Prokurorisë, tha se Jakup Krasniqi e ka
5 këshilluar Sokol Dobrunën se çfarë t'i thoshte
6 ndërkombëtarëve. I njëjti person, z. Halling, me datë 2
7 dhjetor 2024, sikurse tregohet nga faqja 23079 i tha Sokol
8 Bashotës që kjo bisedë që ai e tregoi në ekran ishte midis
9 Jakup Krasniqit dhe Sokol Bashotës, dhe Sokol Bashota tha që
10 kështu është.

11 Sikur kjo të mos ishte mjaftueshëm, përsëri vazhdohet në
12 të njëjtin refren, pra, kjo është një tjetër -- është një
13 tjetër rast ku Prokuroria ndryshon dëshmitë e prokurorëve
14 [Sipas përkthimit] duke i formësuar këto dëshmi në momente të
15 caktuar në mënyrë të tillë që ato t'i shërbejnë narrativës së
16 vet dhe duke mos e lejuar narrativën të formësohet mbi bazën e
17 provave.

18 Po të shohim përmbajtjen e bisedës, pretendimi i
19 Prokurorisë që Jakup Krasniqi ka këshilluar që çfarë t'i
20 thuheshe ndërkombëtarëve për vëllezërit Salevic është
21 qesharake. Personi që thuhet që kanë emrin "Jakup" thotë: "Më
22 besoni nuk di se çfarë t'ju themi. Nuk dimë çfarë të bëjmë. A
23 të presim për Bisin që të mbërrijnë. Le ta lëmë derisa të
24 arrijë Bisi". Kjo është e kundërta e këshillimit. Në fakt, kjo
25 demonstroi se "Jakupi" thotë që "personi që është përgjegjës

1 për çështje të tilla është personi që duhet të japë udhëzimet
2 apo këshillat e nevojshme".

3 Pretendimi i dytë nga Prokuroria është që Jakup Krasniqi
4 ishte kontakti kryesor i Dobrunës. Në mbështetje, Prokuroria
5 citon vetëm dëshminë e Dobrunës. Megjithatë, lidhur me këtë
6 dëshiroj që të them që përveç provës së dhënë përmes dëshmisë
7 së Bislime Zyrapit në poshtëshënimin 1080 në të ai nuk e
8 deklaroi z. Krasniqi lidhur me këtë aspekt. Ndërkohë që
9 deklaratat e Dobrunës janë pranuar në bazën e rregullës 155.
10 Mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia që të verifikojë dëshminë
11 e tij përmes pyetjeve të saj. Ndërkohë Prokuroria kishte dy
12 anëtarë shtesë të departamentit juridik në listën e
13 dëshmitarëve, por vendosi të mos i thërriste ata. Përmes
14 pranimi të dëshmisë së Dobrunës në versionin e shkruar pas
15 vendimit që të mos thërriste dy dëshmitarët e tjerë që e
16 kishin mundësinë që të flisnin për strukturën e departamentit
17 juridik, Prokuroria e parandaloi Mbrojtjen që të verifikonte
18 provat dhe i ka mohuar Trupit Gjykses praninë e dëshmive
19 thelbësore për të ushtruar siç duhet një ushtrim për gjetjen e
20 besueshme të së vërtetës.

21 Në çdo rast Prokuroria i injoron sqarimet që Sokol
22 Dobruna i ka dhënë -- pra Jakup Krasniqi me Sokol Dobrunën
23 kanë folur thjesht si kolegë, si ish-kolegë në biseda të
24 rëndomta të zakonshme, ndërkohë që vetë Dobruna ka thënë që
25 "Jakup Krasniqi nuk ishte mbi hierarkinë", dhe se Jakup

1 Krasniqi vetë i kishte thënë atij në Divjanë që nuk ishte
2 komandant por ishte thjesht zëdhënës. Kjo jepet në provën
3 P01957, dhe në faqen e transkriptit 23712.

4 Pyetja kryesore që ngrihet këtu është cili është kuptimi
5 i fjalës "mbikëqyrje"? Çfarë prove ekzistonte që Jakup
6 Krasniqi kishte lidhje me departamentin ligjor përveç
7 deklaratave të përgjithshme spekulative të Zyrapit? A mund të
8 ketë mbikëqyrje kur nuk ka asnjë provë për urdhra, udhëzime,
9 raportime, diskutime, mbështetje logjistike ose përfshirje në
10 raste specifike? A mund të ketë mbikëqyrje kur shefi i
11 departamentit juridik ka dhënë vetë dëshmi që ai ishte
12 tërësisht i pavarur në ushtrim e detyrës së vet dhe që Jakup
13 Krasniqi nuk ishte eprori i tij? Përgjigja është e qartë, jo.
14 Prokuroria refuzon të pranojë këtë përfundim të paevitueshëm.
15 Edhe një herë ajo anashkalon dëshmitë shfaqësuese që cenojnë
16 këtë çështje dhe argumentet e veta kundër Jakup Krasniqit.

17 Të njëjtat aspekte zbatohen edhe për pretendime ngritur
18 në paragrafin 250 të dosjes së Prokurorisë që Sokol Dobruna ka
19 mësuar nga Jakup Krasniqi lidhur me burgje që ekzistojnë në
20 Kleçkë, në Kervasari dhe në Lladrovç. Prokuroria mbështetet
21 tërësisht në provat e pa verifikuara të Dobrunës. Mbrojtja nuk
22 pati mundësi që të konfrontonte këto pretendime në pyetjet e
23 saj. Kështu që për rrjedhojë nuk mund të arrihet një konstatim
24 lidhur me këtë aspekt, në veçanti duke marrë parasysh
25 formulimet dhe gjuhën e përdorur nga Dobruna në pjesën e

1 cituar. Është në provën P01955, faqja 23. Ai thotë, dhe këtu
2 citoj, "Ju po më pyesni lidhur me diçka që nuk është fare e
3 rëndësishme se kush më njoftoi. Me siguri e kam dëgjuar nga
4 Jakupi përmes bisedave miqësore, jo bisedave zyrtare". Pra,
5 Dobruna vetë nuk e ka konsideruar të rëndësishme këtë aspekt.
6 Dhe dua ta theksoj edhe një herë formulimin që ka bërë ai,
7 "Mbase me siguri e kam dëgjuar nga Jakupi", gjë e cila tregon
8 që është thjesht spekulim dhe hamendësim në rastin më të mirë.
9 Domethënë nuk është e vërtetë tërësisht.

10 Jakup Krasniqi nuk ka qenë mbikëqyrës i departamentit
11 ligjor, dhe njësoj si për këtë aspekt Prokuroria në paragrafin
12 556 ka gabuar kur ka thënë se ai ka luajtur një rol kryesor
13 për sa i takon krijimit të Radios së Lirë të Kosovës, dhe
14 pavarësisht vendimit -- ky vendim për krijimin e KosovarPress-
15 it dhe Radios së Lirë të Kosovës ky është një vendim i cili
16 është marrë si pjesë e ristrukturimit të UÇK-së më 12 dhe 13
17 nëntor 1998, sikurse sqarohet nga procesverbalet e këtij
18 takimi. Në këtë takim, Berat Luzha, jo Jakup Krasniqi u emërua
19 si shefi i shtypit dhe radios. Prova e vetme që e përfshin
20 Jakup Krasniqin për sa i takon këtyre mediave ose emërimit të
21 shefit të tyre, është thjesht prania e tij në këtë takim.

22 Pjesë të librit të Nyhi Bytyqit të cituara nga Prokuroria
23 sugjerojnë që Jakup Krasniqi i ka komunikuar atij që vendimi
24 për krijimin e Radios së Lirë të Kosovës dhe KosovaPress-it
25 ishin marrë, por nuk thuhet asgjëkundi që Jakup Krasniqi ishte

1 i përfshirë në këtë vendimmarrje.

2 E vetmja provë tjetër ku mbështetet Prokuroria është një
3 letër e dërguar nga Ahmet Qeriqi që i drejtohet z. Krasniqi.
4 Për procesverbal kjo është prova P03785. Kjo është një letër e
5 cila është pranuar si provë, pra, në dokumentet shkresore të
6 dërguar për Trupin Gjykses, ndërkohë që dëshmitari, pra, Ahmet
7 Qeriqi, nuk është thërritur për të dhënë dëshmi përpara këtij
8 Trupi Gjykses. Edhe një herë, autori i letrës ka shprehur
9 keqardhje, inat, zhgënjim për sa i takon z. Krasniqi për shkak
10 të mosmarrëveshjeve politike. Për shkak të mungesës së
11 autenticitetit dhe kontekstit nuk i duhet dhënë asnjë peshë
12 kësaj letre.

13 Nuk ka asnjë provë edhe sa i takon marrëdhënies, në qoftë
14 se ka ndonjë marrëdhënie midis Berat Luzhës dhe Jakup
15 Krasniqit. Të nderuar në Gjykatës, Berat Luzha jeton edhe sot
16 e kësaj dite, dhe pavarësisht se Prokuroria nuk e thërriti atë
17 për të dhënë intervistë. Ajo as nuk u takua fare me
18 dëshmitarin, gjë që do ta kishte bërë çdo prokurori kompetente
19 e pavarur dhe e paanshme. Në qoftë se Prokuroria vërtet
20 dëshironte që të gjente të vërtetën lidhur me Kosovën e Lirë
21 dhe KosovaPress-in duhet të kishte folur padiskutim me
22 personin që ishte caktuar si shefi i këtyre mediave. Por në
23 vend të kësaj, Prokuroria bëri sikur ky person të mos
24 ekzistonte. Këtë e bëri pavarësisht që ishte e informuar për
25 faktin që mund të mblidhte prova për këtë argument.

1 Atëherë, sa i takon përfshirjes së Jakup Krasniqit, e
2 vetmja përfshirje e Jakup Krasniqit ishte një fjalim në një
3 ceremoni inauguruese. Dhe kjo në fakt ishte plotësisht në
4 përputhje me rolin e Jakup Krasniqin si zëdhënës, dhe
5 absolutisht nuk tregon kontroll mbi tonin apo thelbin e
6 mesazheve publike të UÇK-së.

7 Më tej Prokuroria vazhdon dhe i referohet disa bisedave
8 midis Jakup Krasniqit dhe personave të lidhur me KosovaPress-
9 in ose Radion e Lirë të Kosovës. Këto provojnë asgjë. Jakup
10 Krasniqi ishte zëdhënësi. Nuk është befasuese që në raste të
11 caktuara atij i duhej -- edhe një herë, pra, nuk është e
12 pazakontë që ai në raste të caktuara të kishte kontakte me
13 mediat. Në të vërtetë bisedat tregojnë që kontakti midis
14 KosovaPress-it dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
15 përfshirë dhe Bislam Zyrabin.

16 Dhe besoj që Trupi Gjykes e kujton provën P03551 ku
17 "Bisa" ka njoftuar Isën nga KosovaPress-i që ai sapo kishte
18 dërguar një komunikatë për botim. Po ashtu ekzistojnë prova të
19 kontaktit midis KosovaPress-it dhe zonave të UÇK-së, përfshirë
20 këtu edhe komandantin Remi. I referohem konkretisht provës
21 P02094, faqja 111654; këtu përfshihet edhe Rrahman Rama, në
22 faqen 111782 në provën P03551; dhe anëtarë të komandës së
23 zonës në Llap; për më shumë detaje referojuni provës P02094,
24 faqja 11565, më pas prova P03551, faqet 11718, 111724; dhe më
25 pas Dukagjini, që jepet në provën P03562, në faqen 095922,

1 provën P02563, në faqen 095926 dhe 95927; dhe Nerodima, që
2 është prova P03551, në faqen 111704.

3 Bisedat e cituara nga Prokuroria nuk e veçojnë Jakup
4 Krasniqin. Kontakti me shtypin nuk është provë e kontrollit
5 mbi shtypin.

6 Sa i takon aspektit të raporteve të pretenduara të z.
7 Krasniqi, pretendimet e Prokurorisë në paragrafin 547 që z.
8 Krasniqi urdhëroi dhe mori raporte nga zonat, janë të
9 mbështetura dhe të pabazuara. Prokuroria mbështetet në provën
10 P00617 dhe P00184. Prova 184 është një version në draft i
11 panëshkruar, pa datë, i paplotë që mbase -- që madje edhe nuk
12 i drejtohet zëvendëskomandantëve. Prokuroria nuk prodhoi asnjë
13 version të nënshkruar dhe të plotë të tij. Ndërkohë që prova
14 617 është një raport i shkruar i nënshkruar nga Bislime Zyrapi
15 që bën përmbledhje të përmbajtjes së diskutimeve midis Zyrapit
16 dhe zonave. Ne kemi parashtrime lidhur me këto dokumente në
17 dosjen tonë në paragrafët 619 deri në 623.

18 Mjafton të thuhet që Prokuroria thërriti dy dëshmitarë
19 për të folur lidhur në këtë dokument: Zyrapin dhe Malokun. Ata
20 të dy konfirmuan që prova 617, ose këto lloj raportesh në
21 përgjithësi, nuk përmbanin asnjë informacion lidhur me
22 veprimtari kriminale ose çështje, probleme me civilët.
23 Atëherë, këto mund t'i gjeni në dëshminë e dhënë nga Zyrapi në
24 faqen 18173 dhe lidhur me Malokun, faqja 25949 e transkriptit
25 e mbulon këtë.

1 Këto janë dokumente të cilat merren me logjistikë bazë.
2 Dhe në fakt si Zyrapin dhe Maloku menduan që mbase t'ja jepnin
3 një kopje të tyre Jakup Krasniqit, ose të mbanin një kopje
4 derisa të kthehej Azem Syla ose që t'ja dërgonte komandantit
5 të logjistikës në Tiranë. Për referencë për Zyrapin, faqja e
6 transkriptit është 18179, pjesa e provës P02090 për Malokun,
7 në faqen 25948. Mbajtja e një kopje për arkivin ose ushtrimi i
8 funksionit të personit, të korrierit, të personit që dërgon
9 mesazhe, nuk është asgjë e cila ka të bëjë me këtë pretendim
10 për raportim nga ZPS-ja.

11 Në çdo rast, Maloku ishte i qartë që janë zhvilluar vetëm
12 dy takime me komandantët e zonave, në dhjetor 1998 dhe janar
13 1999, kështu që kanë ekzistuar vetëm dy raporte të kësaj
14 natyre. Më konkretisht, Maloku e ka thënë këtë në transkript
15 në faqen 25867. Prova e dy raporteve gjatë aktakuzës,
16 periudhës së aktakuzës prej 18 muajsh është asgjë që të tregon
17 që bëhej fjalë për raportim efektiv.

18 Prokurori më pas mbështet në provën 628, që është një
19 urdhër që i drejtohet zonave nënshkruar nga Bislime Zyrapin, jo
20 nga Jakup Krasniqi, dhe si i tillë nuk është provë që Jakup
21 Krasniqi ka urdhëruar ndonjë raportim. Gjithsesi, kjo
22 referencë është e vendosur keq, sikurse ne e diskutojmë në
23 paragrafët 607, 608 të dosjes tonë. Raportet i dërgoheshin
24 përmes telefonit Bislime Zyrapit, shefit të Shtabit të
25 Përgjithshëm të UÇK-së. Në qoftë se nuk merrej përgjigje

1 atëherë këto raporte i duheshin dërguar drejtorisë operative,
2 dhe vetëm në qoftë se nuk kishte përgjigje, raportet më pas i
3 dërgoheshin numrit të telefonit të shtëpisë që përdorej nga
4 persona të tjerë, të ndryshëm nga Jakup Krasniqi, përveç Jakup
5 Krasniqit. Pse ndodhte kjo? Kjo ndodhte që mesazhi t'i
6 transmetohej Bislam Zyrapi. Ky është shpjegim që vetë Zyrapi
7 ia ka dhënë këtij Trupi Gjykues dhe që është konfirmuar nga
8 bisedat që ja ka paraqitur Prokuroria këtij dëshmitari.

9 Kalojmë tek diapozitivi tjetër i cili nuk duhet të
10 paraqitet për publikun. Më tej, Prokuroria citon dy biseda,
11 një bisedë midis "Jakupit", dhe "Remit", që jepet në faqen
12 111691, ku Jakupi regjistrohet që thotë si më poshtë: "Cila
13 është situata?". Ajo çfarë injoron ose nuk merr parasysh
14 Prokuroria është që për pjesën tjetër të bisedës Remi flet me
15 "Jakupin" për ta informuar që ai nuk do të marrë pjesë në
16 takimin e ardhshëm për të diskutuar negociatat në Rambuje dhe
17 për t'i dhënë "Jakupit" mendimin e vet lidhur me negociatat.
18 Qartazi Remi nuk po raporton asgjë lidhur me zonën e vet, e aq
19 më pak po raporton për krime. Do i kërkoja Trupit Gjykues të
20 kalojmë në seancë private tani.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
22 në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 vazhdoni.

24 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në paragrafët 263 dhe 266
25 të dosjes përfundimtare, Prokurori duket sikur nënkupton një

1 lidhje midis shërbimit të inteligjencës dhe Jakup Krasniqit.
2 Unë them "duket" sepse një akuzë e tillë nuk jepet
3 shprehimisht për kontribute domethënëse në NKP ose akuzat e
4 mëposhtme për kontroll efektiv dhe njohuri.

5 Megjithatë, në paragrafin 263 Prokurori pretendon se
6 "drejtoria e zbulim-kundërzbulimit i ka raportuar Komandantit
7 të Përgjithshëm (ose sipas rastit zëvendëskomandantit) dhe
8 Shefit të Shtabit". Ajo vijon më tej, "me raste, raportet e
9 zbulim-kundërzbulimit e anashkalonin Bislim Zyrapin, si Shef i
10 Shtabit dhe i jepeshin vetëm Komandantit."

11 Çdo pretendim që drejtoria e zbulim-kundërzbulimit i ka
12 raportuar z. Krasniqi nuk qëndron.

13 Prokuroria mbështetet në P83 dhe P1408, të cilat duket
14 sikur janë dokumente të Shtabit të Përgjithshëm që përcaktojnë
15 vijat e raportimit për drejtorinë e zbulim-kundërzbulimit. Ka
16 shumë pak prova që këto raportime janë ndjekur. Ja vlen të
17 theksohet që të dy thonë nga ana e tyre që raportet e
18 drejtorisë -- domethënë, raportimi bëhej si për drejtorinë e
19 zbulim-kundërzbulimit dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm,
20 domethënë, Sylës dhe Zyrapit. Dhe askush nuk thotë që
21 raportimi i bëhej dhe zëvendëskomandantit për mbështetje.

22 I vetmi dëshmitar që ka dhënë dëshmi që zbulim-
23 kundërzbulimi i ka raportuar Jakup Krasniqit, ishte Bislim
24 Zyrapin. Ky një është një shembull i qartë i faktit që nuk
25 duhet besuar z. Zyrapin. Zyrapin është përballur në një situatë

1 në të cilat dokumente të tilla si kjo kanë sugjeruar që
2 raportet, domethënë raportimet e zbulim-kundërzbulimit i janë
3 bërë atij. Zyrapit e ka thënë qartazi në intervistën që i ka
4 dhënë ZPS-së që ai ka qenë në gjendje dhe ka dhënë udhëzime
5 për shefin e drejtorisë së zbulim-kundërzbulimit. Ai po ashtu
6 ka thënë që ka marrë raporte nga zbulim-kundërzbulimi,
7 përfshirë këtu lëvizjen e forcave serbe dhe informacion rreth
8 bashkëpunëtorëve jashtë ushtrisë. Ne themi që kjo është e
9 kuptimtë sepse në mënyrë të tillë që të kishte mundësi që të
10 udhëhiqte operacionin Zyrapit duhej që të kishte informacion
11 inteligjent. Por, përpjekja e vonuar e Zyrapit për të
12 pretenduar që informacioni i zbulim-kundërzbulimit i është
13 dhënë Jakupit është thjesht një gënjeshtër që i shërben atij
14 vetë.

15 Nuk ka asnjë dëshmitar që pretendon që ka dhënë raport
16 zbulim-kundërzbulimi për z. Krasniqi. Në qindra faqe biseda
17 Prokuroria nuk ka theksuar asnjë bisedë ku pretendohet që një
18 raport inteligjence i është dhënë z. Krasniqi, për pasojë
19 pretendimi apo akuza e Prokurorisë duhet të hidhet poshtë.

20 Në paragrafin 266, Prokuroria vijon dhe parashton që
21 Ferat Shala ka shoqëruar zëvendëskomandant Krasniqin për
22 vizita në zona. Edhe ky është një shembull i qartë i
23 Prokurorisë që fshihet pas hamendësimit. Në qoftë se
24 Prokuroria pretendon që Shala i ka dhënë informacion zbulim-
25 kundërzbulimi për krimet z. Krasniqi, këtë duhet ta thotë

1 qartë, troç. Për shkak të faktit që nuk ka prova të tilla,
2 Prokuroria preferon që të fshihet pas supozimeve dhe
3 spekulimeve të saj për gjëra të cilat ajo nuk i provon dot.

4 Prokuroria nuk e ka thërritur Ferat Shalën si dëshmitar,
5 ndërkohë që në poshtëshënimin e saj, në veçanti në
6 poshtëshënimin 1088, përfshihen tre referenca që e lidhin atë
7 me zonën e Shalës në janar të 99-s. Ky rast e keqinterpreton
8 insinuimin që Ferat Shala e ka shoqëruar Jakup Krasniqin në
9 vizita. E kam në shumës këtu, në vizita.

10 Domethënë kjo është tërësisht e pabazuar. Në pyetje të
11 Trupit Gjykues, Zyrapi, i cili ka udhëtuar së bashku me Ferat
12 Shalën në këtë rast, tha se ai nuk e dinte se çfarë roli ka
13 pasur ai. Do ishte tërësisht e pavend që të nënkuptohej ndonjë
14 lidhje me krimet nga një vizitë e vetme.

15 Në dosjen e vet, dhe përsëri të martën, Prokuroria në
16 mënyrë të pasuksesshme u mundua që të lidhte Shtabin e
17 Përgjithshëm dhe Jakup Krasniqin me vrasjen e Ramiz Hoxhës dhe
18 Selman Biniqit në tetor 1998. Në veçanti Prokuroria ka
19 keqinterpretuar peizazhin e provave aktuale që lidhen me
20 vrasjen e këtyre dy personave. Ne e trajtojmë këtë incident në
21 paragrafët 323, 324 të dosjes sonë. Përveç kësaj, unë do
22 ilustroj disa aspekte të caktuara të cilat sipas mendimit tonë
23 Prokuroria i ka lënë qëllimisht jashtë të patrajtuara. Do i
24 kërkoj Trupit Gjykues të kalojmë në seancë të mbyllur tani.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në

1 seancë të mbyllur.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Para TPNJ-së ai iu përgjigj

20 pyetjeve lidhur me informacionet që kishte asokohe kur z.

21 Krasniqi e ka dhënë dëshminë. Dhe Prokuroria nuk e përmendi

22 shpjegimin e mëtutjeshëm që bëri Jakup Krasniqi në çështjen

23 Bellanicë në 2018-n, ku e bëri të qartë se ai kishte mësuar

24 për këtë incident vetëm pas luftës. Për këtë, ju lutem,

25 shikoni provën 792 në faqen 00068090. Kjo është treguese në

1 vetvete. Prokuroria nuk mund të argumentojë se komentet e
2 Jakup Krasniqit në TPNJ tregonin dijeni për vrasjen, kur kanë
3 ndodhur këto vrasje. Ai nuk është pyetur për bazën e dijenisë
4 së tij, kur e mori informacionin, prej kujt e mori
5 informacionin, nëse e verifikoi apo thjesht nëse po spekulonte
6 gjatë dëshmisë që ka dhënë për TPNJ-në.

7 Në tej në paragrafin 403 të dosjes së vet Prokuroria
8 pretendon se Krasniqi i ka kërkuar Naim Malokut të merrte
9 pjesë në një mbledhje me fshatarët në Bellanicë në dhjetor të
10 98-s. Sidoqoftë Prokuroria qëllimisht shpërfill dëshminë e
11 Naim Malokut kur tha se ishte vetë Maloku ai që e pyeti atë të
12 shkonte -- nëse mund të shkonte në takim, sepse kishte anëtarë
13 të familjes në atë zonë. Shikoni transkriptin, ju lutem, në
14 faqen 25963. Maloku ka qenë shumë i qartë se nuk e ka dërguar
15 Jakup Krasniqin në atë mbledhje. Por, Jakup Krasniqi thjesht i
16 tha që mirë do të ishte që Naim Maloku të merrte pjesë se atje
17 jetonte familja. Jakup Krasniqi as nuk i tregoi Malokut se për
18 çfarë ishte ky takim. Mund të shikoni transkriptin në faqen
19 26006, 26007.

20 Më tej Prokuroria pretendon se pas takimit Naim Maloku ka
21 folur me Sali Veselin lidhur me atë ç'ka ishte diskutuar në
22 takim për Ramiz Hoxhën dhe Selman Biniqin. Ajo që Prokuroria
23 heq është që Naim Maloku i vetmi dëshmitar që ka cituar këtë
24 pretendim, në fakt, ka qenë në mospërputhje me këtë pikë.
25 Ndonëse ai ka thënë në 2016-n se ka folur me Sali Veselin pas

1 takimit, ai më pas e tërhoqi deklaratën e tij të mëparshme në
2 intervistën e 2019-s për ZPS-në, që është një nga burimet që
3 citon Prokuroria, dhe e tërhoqi sërish në dëshminë që dha
4 përpara këtij Trupi Gjykses. Në të dyja rastet Maloku theksoi
5 se ai nuk i raportoi askujt në Shtabin e Përgjithshëm,
6 përfshirë edhe Jakup Krasniqin, lidhur me diskutimet në këtë
7 takim. Këtu mund të shikoni në transkript faqen 25964 ose
8 provat materiale P2090 Pjesa 6. Kjo është një dëshmi e
9 rëndësishme sepse kjo është provë shfajësuese të cilën
10 Prokuroria nuk e trajton aspak në dosjen e vet. Kjo është
11 tronditëse.

12 Nëse Prokuroria e vlerëson dëshminë e dëshmitarëve të vet
13 të pabesueshme, atëherë duhet ta thotë këtë gjë. Të
14 mbështetesh në një deklaratë të mëparshme, por të shpërfillësh
15 një deklaratë të mëparshme kërkon më së paku një shpjegim prej
16 tyre. Prokuroria vijon e vendosur të vlerësojë që barra e saj
17 e provës është thjesht duke përzgjedhur në mënyrë selektive
18 provat që kanë dhënë dëshmitarët e saj. Ne mendojmë se nuk
19 është kështu, dhe sërish i kërkojmë Prokurorisë ta bëjë të
20 qartë se si -- të na e bëjë të qartë qasjen e vet për provat
21 shfajësuese. Por Prokuroria nuk ka dashur ta bëjë këtë sepse
22 cenon narrativën e vet.

23 Një deklaratë tjetër e fryrë lidhur me z. Krasniqi është
24 shoqërimi me armë. Prokuroria pretendon në paragrafët 625 se
25 Jakup Krasniqi është shoqëruar nga anëtarë të armatosur të

1 UÇK-së kur ka udhëtuar nëpër Kosovë. Kjo tregon që ai ka pasur
2 kontroll efikas lidhur -- për shkak të përgjegjësisë së
3 eprorit që ai kishte. Dhe burimi ligjor sipas tyre është
4 poshtëshënimi 2437, është rasti Brima dhe të tjerët, në këtë
5 rast Trupi Gjykes në paragrafin 788 ka vlerësuar se tregues
6 të kontrollit efektiv në një ushtri parregullt përfshin edhe
7 faktin se "eprori kishte kapacitetin të frikësonte vartës dhe
8 t'i detyronte të respektonin atë që kërkonte ai. Pra, eprorët
9 mbroheshin nga rojet personale që ishin besnikë ndaj tij apo
10 saj, pra ishin roje personale të tij".

11 Tani është interesante kjo shprehja "roje" sepse në një
12 njësi elitë dikur mbrohej perandori. Por, këtë Prokuroria nuk
13 e ka shtjelluar më tej në parashtrimet e veta. Pra, është
14 pikërisht kjo frazë që është thelbësore në arsyetimin e Trupit
15 Gjykes nëse po vlerëson aftësinë e një personi për të ushtuar
16 kontroll efektiv në një formacion të parregullt, ekzistenca e
17 një njësie elite është qartazi relevante sepse ky person mund
18 të përdorë këtë njësi elitë për të ushtuar kontrollin e vet.
19 Por kjo nuk ka kurrfarë lidhje me situatën në rastin tonë.

20 Prokuroria e fillon këtë pjesë në paragrafin 621 duke
21 pretenduar se anëtarë të UÇK-së dhe të Qeverisë së Përkohshme
22 funksiononin dhe si ekupe mbrojtjeje të të akuzuarve, madje
23 ushtron dhe rolin e badigardëve, shoqëruesve apo vozitësve.
24 Por, Prokuroria në paragrafin 625 thotë që "Jakup Krasniqi po
25 ashtu shoqërohej nga anëtarë të armatosur të UÇK-së kur

1 udhëtonte në Kosovë”.

2 Më pas në poshtëshënimin 2493 nuk janë të qartë ose madje
3 dhe kontradiktorë. Mbrojtja nuk e mohon që në disa raste Jakup
4 Krasniqi vërtet ka udhëtuar me anëtarë të armatosur të UÇK-së
5 sepse ai njihej publikisht si zëdhënësi i UÇK-së. Ndryshe nga
6 anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm forcat serbe e
7 dinin kush ishte ai. Trupi Gjykues e di shumë mirë se çfarë
8 mund të bënin forcat serbe. Pra nuk është çudi që ndonjëherë
9 ky zëdhënës të kishte dhe njerëz që e mbronin. Po kjo tregon
10 që ai ishte vulnerabël dhe jo se kishte kontroll efikas.

11 Është e rëndësishme se në qoftë se e krahasojmë me
12 çështjen Brima, Prokuroria as nuk përpiqet ta argumentojë se
13 anëtarë të armatosur UÇK-së, që ndonjëherë udhëtonin me z.
14 Krasniqi, ishin roje moderne pra, pretoriane. Nuk ka asnjë
15 provë që identifikon këta anëtarë të armatosur të UÇK-së. Nuk
16 ka asnjë provë, pra, që këta të ishin roje të një njësiti
17 elitë. Nuk ka asnjë provë që ata ishim besnikë personalisht
18 ndaj z. Krasniqi. As nuk ka ndonjë provë që ai mund t'i kishte
19 përdorur këta anëtarë të armatosur të UÇK-së për të ushtruar
20 kontrollin e tij.

21 Për rrjedhojë, ne mendojnë që parashtrimet në paragrafin
22 625 nuk vërtetojnë aspak kontrollin efikas.

23 Të martën, Prokuroria iu tregoi një video në të cilën
24 shfaqej Jakup Krasniqi që merrte pjesë në festimet e Ditës së
25 Flamurit me 28 nëntor 1998, për të mbështetur si duket për

1 paraqitje. Sidoqoftë, Prokuroria nuk kupton historikun e kësaj
2 ngjarje sepse e kanë shpjeguar vetë dëshmitarët e Prokurorisë.
3 Kjo ceremoni ka qenë thjesht një propagandë që ishte
4 organizuar për t'iu ofruar mbështetje anëtarëve të dëshmorëve
5 të UÇK-së në të cilën ka marrë pjesë z. Krasniqi në cilësinë e
6 tij si zëdhënës. Nuk tregon asnjë lloj -- nuk tregon asnjë
7 lloj autoriteti.

8 Jakup Krasniqi është prezantuar nga Shaban Dragaj,
9 organizatori i ceremonisë, dhe ai ka thënë vetëm që është një
10 "përfaqësues i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës",
11 dhe nuk ka thënë që është zëvendëskomandanti për mbështetje.
12 Shikoni provën 1288, faqe 1.

13 Pasi pati shumë humbje në zonën e Kleçkës, njësitet
14 lokale të UÇK-së ftuan familjet e dëshmorëve të merrnim pjesë
15 në ceremoninë e Ditës së Flamurit për t'u treguar mbështetje
16 familjarëve të njerëzve që kishin humbur jetën. Dëshmitari
17 04741, në faqen 14811, 14813. Në të njëjtën video që e ka
18 treguar Prokuroria mund të shihni, në fakt, të afërmit e
19 dëshmorëve të UÇK-së që janë pas Jakup Krasniqit në skenë.

20 I gjithë ky aktivitet është organizuar thjesht për foto
21 dhe për video. Pavarësisht kushteve të vështira, ushtarëve të
22 Brigadës 121 iu kërkua të shkonin në kohë bore dhe të
23 qëndronin në rresht ndërkohë që prisnin folësit. Fotoja duhet
24 të nxirrte sa më shumë ushtarë që të ishte e mundshme në
25 mënyrë që UÇK-ja të dukej si një ushtri e fortë. Për shkak të

1 të ftohtit as të madh, në fakt, shumë ushtarë u sëmurën dhe
2 madje humbën dhe ndjenjat. Pas fjalimeve të gjithë u larguan
3 menjëherë. Këtë e ka thënë Dëshmitari 04741 në provën
4 materiale P115 -- më falni, dhe një herë -- është prova P1115,
5 Pjesa 2, faqja 21, 23.

6 Si zëdhënës i UÇK-së, Jakup Krasniqi foli për të
7 garantuar të afërmit e dëshmorëve të UÇK-së, që të dashurit e
8 tyre nuk kishin vdekur kot, por kishin vdekur duke u përpjekur
9 të çlironin vendin. Kjo nuk tregon aspak ndonjë plan të
10 përbashkët kriminal, por kjo është thjesht provë se si një
11 zëdhënës përpiqet t'ju rrisë, t'ju ngrejë moralin ushtarëve.

12 Pra, zgjedhje selektive, shtrembërime, spekulime, këto
13 nuk janë prova, këto janë shenja se si përpiqet ZPS-ja në
14 mënyrë të dëshpëruar të gjejë provat e veta.

15 Z. Krasniqi ka qenë zëvendëskomandant mbështetje vetëm
16 për pak kohë, që ka qenë pak a shumë tre muaj. Dhe ne nuk i
17 pranojmë aspak parashtrimet e ZPS-së që Jakup Krasniqi ka qenë
18 i fokusuar në aspekte politike, ka vijuar punën e tij si
19 zëdhënës dhe ka kryer detyra administrative. Pra, ne mendojmë
20 që Prokuroria nuk ka asnjë provë në lidhje me këtë.

21 Të nderuar gjykatës, tani Jacopo Ricci do të flasë për
22 aspekte të tjera lidhur me dokumentet që Prokuroria pretendon
23 se janë nënshkruar prej Jakup Krasniqi. Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. RICCI: [Përkthim] Faleminderit.

1 Ndonëse në paragrafin 563 të dosjes, Prokuroria deklaroi
2 se në nëntor të 98-s Jakup Krasniqi u emërua zëvendëskomandant
3 për mbështetje, mbase ju mund ta keni vënë re se fjalët "për
4 mbështetje" më pas u zhduken nga parashtrimet e Prokurorisë të
5 hënën dhe të martën. Sidoqoftë, ky cilësim është i rëndësishëm
6 për të vlerësuar rolin dhe përgjegjësitë e Jakup Krasniqit mes
7 nëntorit 1998 dhe shkurtit 1999.

8 Gjatë kësaj periudhe kohore, Jakup Krasniqi ka vazhduar
9 angazhimin e tij si zëdhënës i UÇK-së dhe si përfaqësues
10 politik i Shtabit të Përgjithshëm. Në fakt, siç u konfirmua
11 nga disa dëshmitarë, përfshirë dhe Bislam Zyrabin, mes
12 nëntorit 1998 dhe shkurtit 1999 këto dy role ishin fokusi
13 kryesor i z. Krasniqi. Ai takohej shpesh me ndërkombëtarët dhe
14 punonte me UÇK-në në kuadër të negociatave që po pritej të
15 filloheshin në Rambuje.

16 Sikurse u shpjegua qartë nga dëshmitari i Prokurorisë
17 Naim Maloku, roli i Jakup Krasniqit si zëvendëskomandant për
18 mbështetje ka qenë "një rol dytësor". Në praktikë roli dhe
19 përgjegjësitë e tij politike nuk ndryshuan. Provat tregojnë se
20 Jakup Krasniqi nuk ka pasur një rol komandues. Ai thjesht -- i
21 dhanë atij, thjesht i dhanë një rol për mbështetje, por
22 fokusin e kishte tek çështjet administrative. Dëshmia e
23 Malokut është e qartë, pozicioni i zëvendëskomandantit për
24 mbështetje u krijua vetëm për një arsye, që ishte për të
25 formalizuar vendimet e të tjerëve.

1 Kur ishte në Divjakë, Shtabi i Përgjithshëm nuk kishte
2 asnjë sistem administrativ. Sidoqoftë, UÇK-së i duhej që të
3 prezantohej si një ushtri e rregull në mënyrë që të kishte
4 kontakte me komunitetin ndërkombëtar. Ristrukturimi i UÇK-së
5 në nëntor të 98-s ishte pikërisht mundësia e duhur që Shtabi i
6 Përgjithshëm të ndërmernte hapa për krijimin e një sistemi
7 administrimi të brendshëm. Fatkeqësisht për shkak se nuk
8 kishin pajisje, personel dhe burime, kjo përpjekje që vetëm
9 pjesërisht e suksesshme, sepse kapacitetet administrative të
10 UÇK-së ishin të pakta.

11 Tani ky ishte konteksti që tregon emërimin e z. Krasniqi
12 si zëvendëskomandant për mbështetje. Por kjo është dhe pika,
13 pikënisja ku Trupi Gjykses duhet t'i japë peshë dhe rëndësi
14 provave dhe dokumenteve me shkrim që Prokuroria pretendon se
15 janë nënshkruar nga Jakup Krasniqi në këtë cilësi.

16 Më lejoni edhe një herë që të jem i qartë për këtë pikë.
17 Ne nuk e pranojmë që këto dokumente janë nënshkruar prej Jakup
18 Krasniqit. Barra për të vërtetuar autorësinë është e
19 Prokurorisë, e cila nuk ka arritur të vërtetë -- të respektojë
20 standardin minimal që këto nënshkrime mbi këto dokumente i
21 përkasin Jakup Krasniqit. Për parashtrime të mëtutjeshme në
22 lidhje me këtë pikë, i lutem Trupit Gjykses të lexojë
23 paragrafin 521 të dosjes sonë.

24 Sidoqoftë, nëse Trupi Gjykses vlerëson se dokumentet
25 vërtet janë shkruar prej Jakup Krasniqit, ne po ashtu

1 parashtrojmë se janë provë e funksioneve administrative dhe
2 burokratike dhe nuk tregojnë rol komandues.

3 Në paragrafët 524 deri 572 të dosjes sonë kemi bërë
4 parashtrime të hollësishme për secilin nga këto dokumente.
5 Trupi Gjykues do të jetë në gjendje ta shohë se si nuk
6 përfaqëson asgjë më shumë se thjesht formalizim të situatave
7 ekzistuese apo të vendimeve të marra prej të tjerëve. Unë nuk
8 do të përsëris të njëjtat parashtrime, po duhet të trajtoj dy
9 dokumente që i ka përmendur Prokuroria ditën e hënë gjatë
10 prezantimit të vet.

11 E para është prova me numër 168 e 2 dhjetorit 1998 që
12 është një urdhër të cilën e trajtoi Prokuroria të hënë. Tani,
13 argumentet e Prokurorisë në lidhje me këtë dokument si në
14 dosjen përfundimtare dhe në parashtrimet me gojë tregojnë edhe
15 një herë se si Prokuroria është e vendosur që të përzgjedhë
16 prova fajësuese siç i intereson dhe të lërë mënjanë çdo gjë
17 tjetër që nuk përputhen me narrativën e tyre.

18 Pikësëpari Trupi Gjykues duhet të shqyrtojnë nëse prova
19 168 a është dërguar apo është shpërndarë ndonjëherë, sepse nuk
20 ka prova që është shpërndarë, e rrjedhimisht nuk mund t'i
21 jepet asnjë peshë këtij dokumenti sepse nuk ka asnjë lidhje me
22 krimet për të cilat janë ngritur akuzat.

23 Në paragrafin 296 të dosjes, Prokuroria pretendon se
24 prova 168 është shpërndarë në zonat operative. Për të
25 mbështetur poshtëshënimin 1223, ata citojnë intervista të

1 Prokurorisë me tre dëshmitarë, 04737, 04747 dhe Nuredin
2 Ibishin. Por asnjë prej këtyre dëshmive nuk provon
3 shpërndarjen e P168.

4 Diapozitivi tjetër nuk është për publikun.

5 Dëshmitari 04737 në të njëjtën faqe që citon Prokuroria
6 po ashtu thotë që asnjëherë nuk e kishte parë më përpara këtë
7 dokument dhe asnjëherë nuk e kishte përcjellë përmbajtjen e
8 tij. Këtë mund ta shikoni në provën për P01605.7, faqet 4 dhe
9 6. Pra jo që nuk e mbështeti qëndrimin e Prokurorisë, por ky
10 dëshmitar 04737 e kundërshtoi atë.

11 Dëshmitari 04747 nuk duhet të merret parasysh sepse
12 dëshmia e tij u pranua vetëm shkrim pa u testuar në
13 kundërpyetje dhe sepse ai ishte tërësisht i pambështetshëm si
14 dëshmitar për arsyet që Mbrojtja i ka trajtuar në dosjen e vet
15 përfundimtare. Ju lutemi Trupit Gjykses të shohë paragrafët
16 464 dhe dosjen e z. Veseli në paragrafët 53 dhe 59. Sidoqoftë,
17 vetë 04747 i tha Prokurorisë se nuk i kujtohej ta kishte parë
18 konkretisht provën 168.

19 Pozicioni i Prokurorisë dobësohet edhe më tej prej
20 Nuredin Ibishit. Duke u mbështetur vetëm në intervistën e tij
21 për Prokurorinë, Prokuroria në mënyrë të qëllimshme shpërfill
22 faktin që Ibishi e trajtoi të njëjtën çështje në dëshminë që
23 ka dhënë me gojë më 24 tetor 2024, që e keni aktualisht në
24 ekran.

25 Mbase i kujtohet Trupit Gjykses se Z. Misetić, Mbrojtja e

1 Thaçit, vendosi provën 168 në ekran që të mos kishte dhe
2 keqkuptime lidhur me dokumentin në fjalë, dhe e pyeti Ibishin,
3 dhe po citoj, z. Misetic e pyet:

4 "PY. Urdhri është i datës 2 dhjetor 1998. Dhe pyetja ime
5 është a e keni parë ndonjëherë më përpara këtë urdhër?

6 Përgjigja e tij:

7 "PË. Jo, jo gjatë luftës, por e kam parë pas luftës."

8 Nuredin Ibishi është dëshmitar i Prokurorisë. Prokuroria
9 e konsideron si dëshmitar të besueshëm dhe është mbështetur
10 shumë në dëshminë e tij për aspekte që lidhen me zonën e
11 Llapit. Nuredin Ibishi kujtonte diskutime për policinë lokale,
12 por kjo nuk është provë që materiali 168 është shpërndarë në
13 zonë, dhe kjo është mohuar haptazi në Gjykatë. Dhe Prokuroria
14 nuk u përpoq madje ta sqaronte më tej këtë pyetje kur iu dha
15 mundësia për pyetje shtesë, sepse pati shansin ta bënte këtë
16 gjë. Edhe Prokuroria tashmë mbështetet vetëm në intervistën e
17 tij të 2019-s dhe shpërfill sqarimet që i dha ky dëshmitar
18 këtij Trupi Gjykses në këtë sallë gjyqi. Dhe ky është një
19 shembull tjetër se si Prokuroria i mbyll sytë përpara provave
20 që cenojnë argumentet e tyre, përfshirë këtu edhe dëshmitarët
21 e vet.

22 Bëhet edhe më keq. Duke cituar vetëm tri prova,
23 Prokuroria nuk e pranon ose nuk e shpjegon se si çdo përpjekje
24 për të vërtetuar shpërndarjen e pretenduar të këtij materiali,
25 në fakt, dështoi serish. Bislum Zyrapi, Shefi i Shtabit të

1 Përgjithshëm; Sokol Bashota, zëvendëskomandant i operacioneve;
2 Hajrush Kurtaj, zëvendëskomandant brigade - të gjithë këta
3 persona e kanë mohuar ekzistencën e këtij dokumenti përpara
4 luftës. Shihni dosjen tonë, paragrafi 5040. Prokuroria nuk
5 mund të shpërfillë dëshmitë e dëshmitarëve të vet thjesht
6 sepse nuk ju intereson atyre. Sigurisht, Prokuroria mund t'ja
7 paraqiste çdo dëshmitari këtë dokument, por Prokuroria nuk e
8 bëri këtë gjë.

9 Në paragrafët 294-297 të dosjes, dhe po ashtu të hënën,
10 Prokuroria qëllimisht përpiket t'i ngatërrojë pak gjërat, t'i
11 bëjë sa më të vagullta sa i takon dallimit mes policisë lokale
12 serbe dhe njësive të policisë, të parashikuara në planin e
13 Ambasadorit Hill.

14 Dallimi është shumë i thjeshtë. Policia lokale ishin
15 njësi të krijuara nga administrata serbe, të armatosur dhe me
16 uniforma të MUP-it të përfshirë në operacione kundër UÇK-së të
17 cilat janë kryer në bashkëpunim me policinë serbe. Trupi
18 Gjykues ka dëgjuar dëshmi të thelluara, qoftë kjo me shkrim
19 apo me gojë, lidhur me krijimin, rolin dhe veprimin e këtyre
20 njësive. Dëshmitarë të Prokurorisë, përfshirë disa prej atyre
21 që ka cituar Prokuroria në këtë pjesë të dosjes së vet, kanë
22 shpjeguar se njësitë e policive lokale kanë qenë luftëtarë që
23 ishin tërësisht në sistemin e forcave serbe. Më së paku ata
24 ishin një rrezik për sigurinë, ç'ka justifikonte masat.

25 Po ashtu, ndonëse njësitet lokale të policisë serbe

1 fillimisht u krijua në verën e '98-s, ata vazhduan të
2 shtriheshin edhe më tej në periudhën e aktakuzës. Në fillim të
3 dhjetorit '98, për afërsisht në të njëjtën kohë kur është
4 datuar materiali 168, ishin krijuar edhe njësitë e reja të
5 policisë lokale nga administrata serbe në Mitrovicë. Por,
6 Prokuroria nuk bën asnjë lidhje mes këtyre dy fakteve.

7 Ndryshe nga policia lokale serbe, siç është shpjeguar,
8 mes të tjerëve dhe nga vetë Ambasadori Hill, njësitet e
9 policisë të përshkruara në planin e tij nuk ekzistuan
10 asnjëherë, sepse plani nuk u zbatua asnjëherë. Ndryshe nga ajo
11 që kanë thënë Prokurori të hënën, ky është një element shumë i
12 rëndësishëm, sepse nga një anë kemi njësi të armatosura
13 policie që arrestojnë dhe vrasin si anëtarë të UÇK-së dhe
14 civilë shqiptarë në gjithë Kosovën; ana tjetër kemi një
15 entitet joekzistent që ishte thjesht një ide hipotetike e
16 mbetur në letër. Pra nuk ka dyshim që, në fakt, P168 i
17 referohet vetëm të parës.

18 Në fakt, Prokurori të hënën e hoqi këtë provë sepse i
19 leverdiste, përfshirë ndër të tjerave provën, dëshminë që ka
20 dhënë Sokol Bashota. Në ekran mund të shihni transkriptin e 2
21 dhjetorit 2024, në faqen 23058. Ishte kjo prova në ekran, 168,
22 dhe Bashota tha si në vijim:

23 "Unë nuk e kisha parë ndonjëherë këtë dokument, po nuk
24 mendoj si i referohet numrit të policëve që ishin pjesë e
25 kërkesës sonë në kuadër të dokumentit të Hillit. Mendoj se

1 këtu bëhet fjalë për forcat e policisë lokale që ishin
2 punësuar prej serbëve gjatë luftës. Ishin shtetas shqiptarë që
3 kishin pranuar t'i shërbenin shtetit serb edhe në disa raste,
4 në fakt, ata kanë vepruar ose kanë operuar kundër nesh, madje.
5 Por, kjo nuk lidhet me policinë që po diskutonim me Hillin."

6 Në faqen tjetër:

7 "Nuk mendoj se këto të dyja janë të lidhura ...
8 absolutisht nuk mendoj se kjo lidhet me dokumentin e Hillit."

9 Më pas, në faqen tjetër thuhet:

10 "Referenca këtu është për ata shqiptarë që mbanin
11 uniformën e Serbisë dhe që vepronin kundër Ushtrisë Çlirimtare
12 të Kosovës, pra, ishin pjesë e zinxhirit komandues të ushtrisë
13 dhe policisë serbe. Unë nuk mendoj se kam parë ndonjë dokument
14 tjetër të kësaj natyre."

15 Tani kjo dëshmi është dhënë nga një dëshmitar i
16 Prokurorisë kur iu përgjigj pyetjeve që i bëri Prokurori. Nuk
17 është, pra, për t'u habitur që Prokurori e paska harruar këtë
18 ekzistencë. Sidoqoftë, kjo është përpjekje e dëshpëruar e
19 Prokurorisë për t'i portretizuar anëtarët e policisë lokale si
20 civilë. Dhe ne mendojmë se ky propozim duhet hedhur poshtë.

21 Në paragrafin 297 të dosjes, në parashtrimet me gojë të
22 hënën, Prokuroria parashtron, po citoj, se

23 "Pasi u lëshuan urdhrat e 2 dhe 3 dhjetorit '98,
24 shërbimet e policisë dhe të zbulim-kundërzbulimit në zona
25 merrnin në pyetje, ndalonin, keqtrajtonin dhe kanë vrarë

1 anëtarë të pretenduar të policisë lokale që nuk ishin pjesë e
2 forcave të armatosura serbe dhe këtë e kanë bërë mbi dyshimin
3 se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë”.

4 Ky pretendim nuk qëndron.

5 Së pari, dua të fokusohem në një aspekt të rëndësishëm të
6 parashtrimeve të Prokurorisë të hënën. Dy shembujt që cituan
7 për të mbështetur zbatimin e urdhrit 168 - bëhet fjalë për
8 Dukagjinin dhe Kaçanikun - lidhen, në fakt, me policin lokale
9 serbe, një polici që ishte armatosur dhe administrohet nga
10 MUP-i serb, por nuk lidhen me policinë që ishte parashikuar në
11 planin e Ambasadorit Hill. Edhe nëse ata pranojnë *arguendo* se
12 këto shembuj lidhen domosdoshmërisht me provën 168, që është
13 rrëzuar poshtë, në fakt, ata kontradiktojnë vetë argumentin e
14 Prokurorisë se P168 i referohet policisë së Ambasadorit Hill
15 dhe jo me luftëtarët që merrnin pjesë në luftë.

16 Diapozitivi në vazhdim nuk duhet të transmetohet
17 publikisht.

18 Të shohim nga afër këto shembuj që citon Prokuroria. Të
19 hënën Prokuroria ju tregoi dy dokumente të shkruara, P904.7,
20 në faqen 2 dhe P905, që ishin krah për krah në ekran në
21 anglishte. Së pari, përmbajtja e dokumenteve është e njëjtë,
22 ekzaktësisht e njëjtë dhe duket sikur është kopje e njëra-
23 tjetrës. Pra, ne po trajtojmë vetëm një dokument të vetëm. E
24 dyta, që të dy nuk kanë nënshkrim dhe P905, ai që ndodhet në
25 të djathtë, nuk ka as bllok të firmave me emër. E treta, që të

1 dy janë -- janë pranuar përmes procedurës jogojore dhe
2 Prokuroria nuk e ka pyetur asnjë dëshmitarin lidhur me
3 autentifikimin apo përmbajtjen e tyre. Pra, nuk ka nevojë të
4 thuhet që këto dokumente të panëshkruara, të pautenticituara,
5 të kopjuara nuk kanë vlerë provuese.

6 Por, po t'i shohim edhe po t'i marrim ashtu siç janë këto
7 dy materiale, nuk mbështesin ekzistencën e ndonjë lidhje midis
8 P1168 dhe paraburgosjen e pretenduar të anëtarëve lokalë të
9 policisë. Që të dy këto dokumente kanë datën 25 mars 1999.
10 Pothuajse katër muaj pas daljes së P168. Asnjëri prej
11 dokumenteve nuk i referohet P168 apo ndonjë udhëzimi të
12 Shtabit të Përgjithshëm. Dokumenti i parë që Prokuroria
13 pretendon se mbështet zbatimin e P168, e ka datën 4 muaj më
14 vonë dhe nuk i referohet P168, është tregues në vetvete.

15 Për më tepër, këto dokumente që ndodhen në ekran
16 përshkruajnë policinë lokale në Gjakovë që merr rroga, karta
17 identiteti dhe armë automatike nga administrata serbe, marrin
18 pjesë në operacione për arrestimin e anëtarëve të UÇK-së dhe
19 informojnë policinë serbe lidhur me statusin dhe lëvizjet e
20 UÇK-së në Dukagjin. Këto përbëjnë rrethana të cilat vërtetohen
21 gjerësisht në procesverbalin e çështjes gjyqësore, përshirë
22 nga dokumentacioni zyrtar i administratës serbe 4D100, dhe
23 intervista të kohës të anëtarëve të policisë lokale në
24 Gjakovë, 4D81. Këto dokumente konfirmojnë statusin luftarak të
25 anëtarëve të policisë lokale në Kosovë si dhe rrezikun me të

1 cilin janë përballur nga pikëpamja e sigurisë.

2 Shembulli i dytë që ka shfrytëzuar Prokuroria është i
3 Kaçanikut, në zonën e Nerodimes. Në dosjen e tyre
4 përfundimtare në paragrafin 297, Prokuroria mbështetet në një
5 pjesë të intervistës për ZPS-në të W04722. Deklaratat e 04722
6 janë pranuar në bazë të rregullës 153 përkundër kundërshtimeve
7 të Mbrojtjes dhe kjo provë është e paprovuar dhe nuk duhet të
8 marrë peshë të kufizuar. Sidoqoftë, edhe një herë, W04722 ka
9 diskutuar ngjarjet e marsit të 1999-s më shumë se tre muaj pas
10 daljes së P168. Asnjëherë nuk e ka përmendur P168 apo ndonjë
11 udhëzues tjetër të Shtabit të Përgjithshëm lidhur me policinë
12 lokale. Dhe në fakt, Hajrush Kurtaj, zëvendëskomandant i
13 Brigadës 162 e konfirmoi se nuk e kishte parë apo ky nuk
14 kishte dëgjuar në brigadën e tij për P168. Provat e 04722 nuk
15 provojnë ekzistencën e ndonjë lidhje midis P168 dhe ngjarjeve
16 të Kaçanikut në mars 1999. Sidoqoftë, W04722 ka vërtetuar më
17 tej statusin e luftarakut të policisë ushtarake në Kaçanik. Ka
18 thënë që ata kishin marrë, kishin karta identiteti dhe armë që
19 ishin marrë nga administrata serbe dhe që funksionin nën
20 urdhrat e policisë lokale serbe kundër UÇK-së.

21 Shkurtimisht, provat se disa anëtarë të policisë lokale
22 janë arrestuar disa muaj pas P165 [Sipas përkthimit] nuk është
23 provë për të provuar se 168 është zbatuar. Kjo lidhje shkakore
24 që Prokuroria duhet të vendosë mungon tërësisht.

25 Tani do të shoh një numër dokumentesh që Prokuroria

1 parashtron se janë nënshkruar nga Jakup Krasniqi; konkretisht
2 P3681 dhe P3682. Në mënyrë të paarsyeshme Prokuroria i zmadhon
3 argumentet e saj që kanë të bëjnë me tatimin dhe zbatimin e
4 këtyre dokumente. Të hënën, në faqen 28490, Prokuroria i tha
5 Trupit Gjykues, dhe citoj:

6 "Mbrotjtja -- parashtrimet e Mbrotjtjes së Krasniqit lidhur
7 me këto urdhra nuk janë në -- nuk përputhen me synimin, që do
8 të thotë që Shtabi i Përgjithshëm ka urdhëruar -- urdhrat e
9 Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë atë që ka nënshkruar Jakup
10 Krasniqi janë shpërndarë dhe janë zbatuar, përfshirë ato nga
11 anëtarë të Brigadës 121, të policisë ushtarake."

12 Unë do të nënvizoj, të nderuar Gjykatës, dhe do të thoja
13 "vetëm për brigadën e ushtrisë -- e policisë ushtarake 121".

14 Prokuroria dhe Mbrotjtja i kanë humbur këto raste për ta
15 vërtetuar këtë gjë. Prokuroria nuk mund të provojë përmes një
16 dokumenti për zbatime -- bazuar vetëm në një dokument të vetëm
17 dhe nga një brigadë e vetme. Nuk kemi dëgjuar dëshmi apo marrë
18 prova mbi zbatimin dhe detyrimi i tij nga ndonjë brigadë
19 tjetër në Kosovë.

20 Duhet theksuar se, së pari, Brigada 121 është brigada që
21 është më e afërt nga pikëpamja gjeografike me Divjakën, që një
22 dokument që ka arritur në Brigadën 121 nuk do të thotë që ka
23 arritur në pjesën tjetër të zonës së Pashtrikut, e le më në
24 zonat e tjera përreth Kosovës.

25 Së dyti, provat tregojnë se urdhrat që kanë të bëjnë me

1 tatimet kanë ardhur pasi Dr. Fitim Selimi, që ishte pjesë e
2 Brigadës 121, ka bërë një kërkesë që është P1126, që t'i
3 dërgohen materiale mjekësore, duke theksuar në mënyrë
4 specifike zbatimin e një sistemi tatimor për këtë çështje. Siç
5 e kemi shpjeguar në paragrafët 564, 567 të dosjes sonë, kjo
6 ishte një çështje vendore dhe nuk ka prova që të jetë zbatuar
7 më gjerësisht.

8 Diapozitivi në vazhdim nuk duhet transmetuar publikisht.

9 Për më tepër, P2015.3, në të cilët mbështetet Prokuroria
10 në paragrafët 35 [Sipas përkthimit] dhe 204 të dosjes së saj,
11 nuk i ndihmon argumentet e Prokurorisë. Ky dokument tregon se
12 dy anëtarë të policisë ushtarake nuk kanë ndjekur urdhrin e
13 pretenduar lidhur me tatimet, dhe se përpjekja për ta zbatuar
14 këtë në fshatin e Bllacës, citoj, "ka dështuar tërësisht".

15 Tregohet po kështu se të vetmit individë të cilëve iu
16 kërkuar që t'i paguanin këto tatime i kishin dhënë në mënyrë
17 vullnetare kontributet e tyre në Fondin Vendlindja Thërret,
18 kështu që nuk u kërkuar pagesë tjetër. Dhe kjo vërtetohet nga
19 provat e Naser Krasniqit, në faqen e transkriptit 24791-24793.
20 Naser Krasniqi deklaroi se kontributet kanë mbetur vullnetare
21 në shumicën e rasteve dhe se edhe atyre të cilëve u është
22 kërkuar që të kontribuojnë mund ta bënin një gjë të tillë duke
23 kontribuar çfarëdolloj shume që është në kundërshtim me
24 urdhrat që pretendohet se ka nënshkruar Jakup Krasniqi.

25 Këto shembuj tregojnë mungesën e kontrollit nga -- lidhur

1 me këtë çështje nga ana e Shtabit të Përgjithshëm.

2 Të nderuar Gjykatës, kaq kisha unë. Tani ja jap fjalën
3 kolegut tim të nderuar, z. Ellis.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, kur
5 të jeni gati.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë dua -- kam
7 një orë gjatë së cilët dua të flas, dhe gjatë kësaj kohe së
8 pari do të flas lidhur me disa parashtrime që kanë të bëjnë me
9 keqinterpretimin nga ana e Prokurorisë të rolit të z. Krasniqi
10 si zëdhënës i UÇK-së; dhe së dyti, për pesë incidente
11 specifike ku thuhet që ka luajtur rol z. Krasniqi. Ne këtë
12 kategori të dytë nuk do ta përfundojmë dot gjatë kësaj dite,
13 megjithatë unë do të thoja që të filloja me çështjen e
14 zëdhënësit dhe të shohim se sa do të mund të vazhdojmë.

15 Të nderuar Gjykatës, ne sipas mendimit tonë në trajtimin
16 e rolit të zëdhënësit, Prokuroria ka ndjekur një model të
17 cilin e kemi parë dhe më parë. Ata kanë anashkaluar të tëra
18 kundërpytjetet, sqarimet dhe provat shfajësuese. Dhe ata nuk i
19 pyesin dëshmitarët lidhur me prova kritike me anë të cilave të
20 provojnë edhe argumentet e tyre. Dhe në mënyrë të vazhdueshme
21 nuk kanë bërë lidhjen midis pretendimeve lidhur me z. Krasniqi
22 me krimet të cilat janë pjesë e aktakuzës.

23 Do të përqendrohem në katër fusha në veçanti. Së pari,
24 komunikatat; së dyti, mungesën për të bërë lidhje midis
25 deklaratave publike me krimet; së treti, rregulloret; dhe së

1 katërti, pretendimet të cilat duket se bazohen vetëm në
2 praninë në vendet e ndryshme.

3 Koha mbase nuk është e përshtatshme sot për të trajtuar
4 këtë, sot që është e premtë pasdite, por fillojmë me
5 komunikatat menjëherë.

6 Në dosjen e tyre përfundimtare, Prokuroria thotë që z.
7 Krasniqi ka patur "përgjegjësi parësore për komunikatat",
8 paragrafi 4777; dhe se ishte "hartues dhe redaktor" i
9 komunikatave, paragrafi 548; dhe se ka patur "rol të
10 vazhdueshëm aktiv në hartimin dhe shpërndarjen e komunikatave"
11 paragrafi 557, dhe se ai e ka "drejtuar procesin e
12 komunikatave duke përpiluar, redaktuar, dhe lëshuar ato",
13 paragrafi 558.

14 Është e qartë që komunikatat janë në qendër të
15 argumenteve të Prokurorisë, që nga paragrafi i parë i dosjes
16 së tyre përfundimtare dhe deri në pjesën e argumenteve
17 myllëse të bëra të hënën në mëngjes. Pra, pretendimet lidhur
18 me rolin e z. Krasniqi janë shumë të rëndësishme dhe më duket
19 sikur rëndësia është shtuar sa herë që janë përmendur. Duke
20 mos paraqitur rolin personal të z. Krasniqi për komunikatat në
21 dosjen paragjyqësore, Prokuroria tani kërkon ta bëjë atë
22 përgjegjës për të tërë procesin që nga fillimi deri në fund,
23 që nga hartimi deri në shpërndarjen e tyre. Dhe nuk ka nevojë
24 të thuhet që kjo është një zmadhim i asaj që tregojnë provat.

25 Realiteti është se, pavarësisht të tre viteve të

1 gjykimit, 227 ditë gjyqi, 5000 prova materiale, ne nuk kemi
2 avancuar fare që nga fillimi. Prokuroria nuk ka provuar se
3 kush ka hartuar as dhe një komunikatë të vetme, dhe tani po
4 përpiqet ta fshehë këtë dështim duke thënë që kjo është një
5 hartim në mënyrë grandios.

6 Shumë prej pikave kryesore që kanë të bëjnë me autorësinë
7 me apo me shpërndarjen janë të dobëta dhe jobindëse dhe ato i
8 kisha parashikuar dhe i kemi në dosjen tonë përfundimtare në
9 paragrafin 195-206. Dua ta shfrytëzoj kohën që na ka mbetur
10 për të hyrë më në hollësi lidhur me atë -- me provat në të
11 cilat mbështetet Prokuroria.

12 Së pari, zbulimi i versioneve të ndryshme të komunikatave
13 gjatë kontrollit të shtëpisë së z. Krasniqi nuk provon asgjë.
14 Ekziston një deduksion alternativ i arsyeshëm që z. Krasniqi
15 ka grumbulluar numër të madh materialesh arkivore pas
16 konfliktit për të shkruar, për shkrimet e tij dhe deduksikoni
17 që e mbështet këtë është dëshmia e TPNJ-së të cilën e ka
18 përmendur më herët znj. Alagenda, në të cilën z. Krasniqi tha
19 se kishte konsultuar literaturë me qëllim që të shkruante
20 librin "Kthesa e Madhe", dhe u pyet në mënyrë të posaçme se
21 për çfarë literature bëhej fjalë dhe ai u përgjigj tha:
22 komunikata.

23 Së dyti, nga përfshirja e të paktën tre komunikatave në
24 një dorëshkrim nga z. Krasniqi për atë që i thotë që i ka
25 ardhur koha shqiptarëve që është P177, P178 dhe P591.

1 Dhe, së treti, z. Krasniqi vërtet ka cituar katër
2 komunikata si burim për poshtëshënimet e librit të tij "Kthesa
3 e Madhe". Dhe ato mund të gjenden në P189-ET.3.

4 Provat mbi të cilat mbështetet Prokuroria në paragrafin
5 1477 për t'u përpjekur për t'i atribuar përgjegjësinë
6 kryesore z. Krasniqi, në fakt, ka të bëjë me prova lidhur me
7 Deklaratën Politike numër 2, Prokuroria -- intervistën e
8 Prokurorisë me z. Rexhep Selimi, një citim i pjesshëm i
9 dëshmisë për TPNJ-në të z. Krasniqi duket e anashkaluar
10 pasazhin në të cilin mbështetemi ne, si dhe një post në
11 Facebook për Komunikatën 59.

12 Le të trajtojmë fillimisht Deklaratën Politike numër 2.
13 Prokuroria mbështetet në dëshmi lidhur me këtë deklaratë
14 politike duke -- dhe është në poshtëshënim për të dy
15 paragrafët në 1477 dhe 548. Z. Krasniqi gjithmonë e ka pranuar
16 se ka qenë një nga autorët e Deklaratës Politike 2. Dhe do t'i
17 kujtohet Trupit Gjykues se kjo deklaratë politike qartësisht e
18 ka dënuar terrorizmin dhe dhunimet e tjera kundër popullatës
19 civile dhe ka thënë se do të zbatojë të drejtën ndërkombëtare.
20 Nuk ka asgjë të paligjshme lidhur me këtë deklaratë.

21 Ajo që nuk mund ta bëjë Prokuroria, sidoqoftë, është që
22 ta shfrytëzojë autorësinë apo rolin për hartimin e një
23 deklarate politike si provë për autorësi apo rolin në hartimin
24 e të gjitha komunikatave të tjera. Këto të dyja nuk -- të dyja
25 janë gjëra krejt të ndryshme. Është e qartë. Por fakti që na

1 duhet ta ritheksojmë është domethënës në vetvete. Edhe
2 deklarata për TPNJ-në e z. Krasniqi, që është pranuar
3 pavarësisht kundërshtimit tonë, dhe në të cilën mbështetet
4 Prokuroria -- Prokuroria mbështet në provën P973, e bën këtë
5 dallim. Në rastin kur flitet për Deklaratën Politike numër 2,
6 z. Krasniqi ka thënë që "Isha autori kryesor". Ndërkohë që kur
7 flitet për komunikatat, ai thotë "të lëshuara nga Shtabi i
8 Përgjithshëm i UÇK-së". Që është një dallim krejtësisht i
9 qartë.

10 Së dyti, provat e dëshmitarit mbi të cilin është
11 mbështetur Prokuroria për t'i atribuuar komunikatat z.
12 Krasniqi është intervista me të bashkëakuzuarin, z. Selimi.
13 Nuk kam nevojë të shtoj shumë për këtë çështje pasi unë mund
14 të mbështes parashtrimet e bëra nga z. Misetic dhe deri në një
15 masë edhe nga z. Roberts lidhur me besueshmërinë e kësaj
16 interviste. Do të shtoj thjesht vetëm tre pika kryesore të
17 shkurtra.

18 Së pari, nuk ka patur bazë për këto komente. Z. Selimi
19 nuk e ka parë asnjëherë z. Krasniqi duke shkruar një
20 komunikatë. Kjo është P763.3, faqja 3. Së dyti, shumë prej
21 përgjigjeve të z. Selimi në këto pjesë relevante të
22 intervistës janë produkti i pyetjeve të përsëritura, të cilat
23 një këshilltar ligjor nuk mund t'i bëjë në një sallë gjyqi. Në
24 faqet P761.7, në faqen 16 dhe 19, dhe kur pyetet lidhur me
25 pyetjet që i bëhen atij dhe duke dyshuar për përgjigjet që ka

1 dhënë lidhur me faktin nëse e kanë diskutuar në Shtabin e
2 Përgjithshëm. Këto janë të pambështetshme si -- janë të
3 pambështetshme. Dhe Prokuroria vetë ka treguar do të duhet të
4 tregohet kujdes, dhe kjo ndodh në paragrafin 1415 të dosjes së
5 tyre. Së treti, ky pasazh i intervistës së z. Selimi iu tregua
6 z. Sokol Bashota, i cili konfirmoi në të transkriptin 23490 se
7 nuk e dinte se kush i ka shkruar komunikatat apo nëse janë
8 shkruar nga një person apo më shumë.

9 E treta, dëshmia e TPNJ-së së z. Krasniqi kryesisht në
10 gjykimin Haradinaj, këtu në mënyrë tipike për dosjen
11 përfundimtare Prokuroria përzgjedh pasazhe apo pjesët më të
12 këqija që të disa ditëve të dëshmisë. Unë nuk do të -- unë nuk
13 i fshihem këtyre pjesëve më të këqija, por gjatë pyetjeve nga
14 z. Emmerson, z. Krasniqi tha në P800, faqja 5034:

15 "Këto komunikata unë isha i zoti -- autori i tyre gjatë
16 kohës së nivelit të lartë të ofensivave kur ka patur
17 vështirësi për ne si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që të
18 mbanim takime."

19 Për sa i përket Prokurorisë edhe lidhur me provat e
20 drejtpërdrejta që lidhin Krasniqin me komunikatën, kjo është
21 edhe prova më mirë, por në fakt këtu thuhet shumë më pak sesa
22 Prokuroria e imagjinon. Në nivelin më të lartë ai ka folur për
23 autorësinë vetëm për një periudhë gjatë kohës kur ishin shumë
24 të ashpra ofensivat. Dhe ilustrimi logjik është që nuk ka qenë
25 autori gjatë gjithë kohës. Dhe barra për të identifikuar se

1 cilat ishin këto komunikata dhe për të treguar nëse këto kanë
2 qenë komunikata me ndonjë përmbajtje e cila mund të
3 kundërshtohet, i takon Prokurorisë, dhe Prokuroria nuk ka bërë
4 -- ajo që nuk ka bërë, që nuk i ka analizuar në mënyrë
5 sistematike komunikatat dhe ndonjë dëshmitar, apo nuk ka
6 treguar parashtrime për të treguar se cilat prej komunikatave
7 mund të jenë shkruar gjatë kohës kur ofensivat kanë qenë më të
8 ashpra.

9 Duke e pranuar këtë dëshmi Trupi Gjykses tani duhet të
10 vendosë se çfarë peshe t'u japë këtyre në rrethanat në të
11 cilat z. Krasniqi nuk i është treguar se kishte të drejtën
12 kundër vetëinkriminit, nuk ka patur këshilla ligjore, dhe
13 pas 20 viteve shikon që përgjigjet që ai ka dhënë po përdoren
14 kundër tij në aspektet qendrore të çështjes gjyqësore.

15 Të martën në mëngjes, Prokuroria i kërkoi Trupit Gjykses
16 që të mos i marrë parasysh parashtrimet tona lidhur me të
17 drejtat për gjykim të drejtë, bazuar në faktin që ne nuk i
18 kishim përmendur ato argumente sa i përket pranueshmërisë së
19 provave. Duke mbajtur parasysh këtë që ne nuk i kemi përmendur
20 këto, dhe paragrafi 53 i dosjes sonë ka thënë që Paneli i
21 Apelit nuk e ka hedhur poshtë vendimin tuaj. Ky nuk është
22 problemi kryesor për Prokurorinë. Problemi kryesor është se
23 vlerësimi i peshës është i ndryshëm nga ai i pranueshmërisë.
24 Në paragrafin 55 të Dhomës së Apelit, ne cituam, dhe shpresoj
25 që të jetë në ekran. Po e lexoj:

1 "Duke mbajtur parasysh që duhet treguar kujdes kur të
2 vendoset se çfarë peshe t'u jepet këtyre provave, nëse do të
3 jepet në një peshë, Paneli i Apelit konsideron se Trupi
4 Gjykues i përbërë nga gjykatës profesionalë dhe me eksperiencë
5 do të mund ta shfrytëzojë me kujdesin e duhur provat që ka
6 përpara."

7 Dhe njësoj si dhe Dhoma e Apelit, ne besojmë që Trupi
8 Gjykues do të tregojë kujdesin e duhur dhe nuk do t'i japë
9 peshë provosh të cilat janë marrë në shkelje të parimit të
10 mosinkriminimit, kryesisht duke patur parasysh kur nuk ka
11 dëshmi të tjera të drejtpërdrejta të cilat aprovojnë të
12 njëjtën pikë në këtë procesverbal.

13 Dhe në qoftë se Trupi Gjykues do t'i japë ndonjë peshë të
14 gjitha dëshmive të TPNJ-së, duhet ta shohë në tërësi, duke
15 mbajtur parasysh që z. Krasniqi ka thënë se kanë qenë
16 pothuajse e saktë që komunikatat janë shkruar nga pjesa
17 operative e UÇK-së në të cilën nuk ka marrë pjesë; ai nuk ka
18 marrë pjesë në komunikata të mëherëshme dhe nuk e ka ditur se
19 kush i ka shkruar ato. Referencat gjenden në paragrafin 437 të
20 dosjes sonë. E parë në mënyrë të qartë dhe me kujdesin që ka
21 treguar, që ka thënë, sugjeruar Apeli i apelit [Sipas
22 përkthimit], efekti është që ai të distancohej veten nga
23 shumica e komunikatave dhe jo t'i miratojë ato. Dhe prandaj
24 nuk provon pretendimin e Prokurorisë që ai e ka drejtuar
25 procesin e komunikatave që nga hartimi deri tek lëshimi i

1 tyre. Dhe provat tregojnë që shumica e komunikatave janë
2 shkruar nga krahu operativ i UÇK-së. Asnjë prej anëtarëve të
3 drejtorisë operative nuk janë në pjesë e anëtarëve të NKP-së
4 sipas Prokurorisë.

5 Në fund, do të flas lidhur me P1751, që është një post në
6 Facebook i z. Krasniqi që janë përgjigje të një deklaratë të
7 z. Thaçi. Një post i Facebook-ut ka vlerë të kufizuar
8 provuese, nuk mund të shikohet si një dëshmi e bërë nën betim.
9 Ndërkohë që aty thuhet që komunikatat janë shkruar në Kosovë
10 në vitin 1998, nuk identifikon autorin dhe nuk thotë që z.
11 Krasniqi ishte autori. Në fakt, nuk thotë -- në fakt, thotë që
12 z. Krasniqi ishte "kundër" komunikatës 59, që e distancon atë
13 nga kjo komunikatë, dhe në këtë mënyrë nuk mund të pretendohet
14 që Trupi Gjykses pa prova të thotë që të gjithë anëtarët e
15 pretenduar të NKP-së të kenë miratuar secilën prej
16 komunikatave.

17 Edhe provat e W04255 nuk e ndihmojnë Prokurorinë. Ai
18 ishte njësoj si dëshmitarët e tjerë. Nuk ka qenë në gjendje të
19 bëjë dallimin midis artikujve, komunikatave dhe deklaratave
20 politike. Shikoni faqen e transkriptit 7901. Nuk e kritikojmë
21 për një gjë të tillë. Një dëshmitar i zakonshëm nuk do ta
22 kuptojë këtë ndryshim që bën në Trupin Gjykses në këtë pikë
23 të gjykimit. Por është e qartë që ai nuk po fliste për një
24 komunikatë, por për një deklaratë politike. Të paktën ky është
25 qëndrimi i Prokurorisë në paragrafin 340 të dosjes së saj. Por

1 unë them që më i rëndësishëm është fakti se çfarë ka thënë ai,
2 ky dëshmitar lidhur me takimin e mëpastajmë që ka patur me z.
3 Krasniqi.

4 Dhe do të dëshiroja që ta vendosim këtë në ekran, por jo
5 për transmetim publik.

6 Një nga vështirësitë në gjykimin e kësaj çështje, të
7 nderuar Gjykatës, është se është vështirë për të -- se çfarë
8 ndiejnë të akuzuarit që ndodhen para jush pas shumë vitesh dhe
9 pjesë e këtij gjykimi sipas ligjit kundërshtues anglosakson.
10 Megjithatë ka momente kur do të thonim që në fakt hiqet
11 megjulla dhe shihni se z. Krasniqi siç ka qenë në atë kohë.
12 Dhe janë tre momente sipas parashtrimeve të mija. Dy të tjera
13 do t'i diskutojmë ditën e hënë.

14 Të paraqes pak sfondin e këtij takimi. Ky do të ishte një
15 takim mes z. Krasniqi dhe një personi të cilin Prokuroria do
16 ta përkufizonte si një kundërshtar. Si do të shkonte ky takim.
17 Z. Krasniqi do ta keqtrajtonte atë, apo ta kërcënonte në
18 ndonjë farë mënyre? 4255 tha se ishte i koordinuar shumë mirë,
19 bashkëpunues dhe ne këshillonim njëri-tjetrin. Ishte shumë
20 bashkëpunues.

21 "PY. Dhe rezultati i këtij takimi është se të gjithë
22 njerëzit ranë dakord që do të bashkëpunonin kundër forcave
23 serbe, kështu është?

24 "PË. Korrekt. Ashtu është. Me këshillën e z. Krasniqi."

25 Ky është z. Krasniqi, të nderuar Gjykatës. Ai nuk është

1 figura përçarëse që dëshiron të tregojë Prokuroria. Ai është
2 njeri i mirësjellshëm dhe bashkëpunues.

3 Prokuroria do të duhet ta provojë përtej dyshimit të
4 arsyeshëm që z. Krasniqi ka hartuar të gjitha komunikatat me
5 të cilat besohet. Nuk mund të hamendësohet që një person mund
6 të implikohet në komunikatat. Prova nuk arrijnë të përmbushin
7 standardin e provimit përtej dyshimit të arsyeshëm. Nëse z.
8 Krasniqi ka hartuar të gjitha komunikatat dhe pse nuk i gjetën
9 këto kopje në shtëpinë e tij. Në qoftë z. Krasniqi i ka
10 hartuar edhe redaktuar dhe lëshuar të gjitha komunikatat përse
11 kur dha dëshmi në TPNJ, dëshmi ligjore, nuk e ka pranuar atë
12 autorësinë për to, siç bëri për Deklaratën Politike numër 2?

13 Provat lënë më shumë se dyshim të arsyeshëm. Nuk është
14 provuar asnjëherë që z. Krasniqi ka patur përgjegjësinë
15 parësore për komunikatat.

16 Dhe unë do të përfundoj duke thënë se paragrafi 554 i
17 dosjes përfundimtare të Prokurorisë është një shembull i qartë
18 i mënyrave se si ka dështuar Prokuroria. Do të ishte paragrafi
19 i cili do të vërtetonte se z. Krasniqi ka dhënë kontribut të
20 ndjeshëm për NKP-në duke shpërndarë materiale për të
21 mbështetur synimin e përbashkët. Mirëpo, pretendimi që ngrihet
22 është që Shtabi i Përgjithshëm ka njoftuar masat ndëshkimore
23 të formave të ndryshme. Pra, ajo që pretendohet që ishte
24 pretendim kundër z. Krasniqi dhe rolit të tij për personal,
25 shndërrohet në një pretendim për Shtabin e Përgjithshëm, dhe

1 në këtë mënyrë Shtabi i Përgjithshëm nuk tregon rolin e
2 përgjithshëm të z. Krasniqi për këtë dhe nuk provohet që ka të
3 bëjë me komunikatën dhe nuk thuhet a ka ndonjë lidhje me
4 Qirezin.

5 Shoh që ka ardhur koha, të nderuar Gjykatës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
7 takohemi të hënën në orën 9.00.

8 z. Ellis, keni një orë e gjysëm për të hënën në mëngjes?

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, por nuk do të jem vetëm unë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
11 kërkonim ZPS-së që të përgatitej për të bërë pyetjet e tyre
12 apo përgjigjet e tyre të hënën pasdite. Shpresojmë që ta
13 arrijmë një gjë të tillë. Pas përfundimit të deklaratës
14 mbyllëse të Mbrojtjes së Krasniqit, Gjykatësit do të kenë dy
15 orë dhe shumica e pasdites do të jetë për juve. Unë besoj se
16 pala Mbrojtëse do të jetë gati për komentet e tyre ndaj këtyre
17 përgjigjeve. Nuk di nëse do mund ta arrijmë këtë, por kemi
18 parashikuar gjithsesi ditën e mërkurë dhe jam i sigurt -- do
19 të bëjmë të sigurtë që ta përfundojmë të mërkurën.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, iu përgjigjët
21 gjysmës së pyetjes që bëra pak më herët. Gjysma e dytë ka të
22 bëjë me këtë, Trupi Gjykses a do të na dërgojë një listë të
23 pyetjesh të cilave do t'i përgjigjemi të hënën?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo në këto
25 moment. Nëse ndryshojmë mendjen do ta bëjmë këtë. Por tani

1 është e premtë pasdite dhe nuk ka ngelur shumë kohë këtu në
2 dispozicion. Nuk di nëse -- kush është prej jush që ka
3 përgatitur këto paraprake? Jo, jo.

4 Z. Laws.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Në njoftimet lidhur me përfundimin e
6 dhënies së provave ne kemi vënë re se ne do të kemi si
7 Mbrojtës së Viktimave kohën për të dhënë përgjigje. Do të
8 kërkoja 10 deri në 15 minuta për t'u përgjigjur asaj që po
9 thuhet në parashtrimet e z. Selimi. Ndoshta mund të shtoj
10 ndonjë gjë. Unë ndoshta do të shtoj pak më shumë kur të
11 dëgjojmë se çfarë kanë për të thënë Mbrojtja e Selimit të
12 hënën, por kaq për momentin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pas pyetjeve
14 të Gjykatësve do të fillojmë me përgjigjet nga Prokuroria, dhe
15 pastaj ju do të vini më pastaj.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Doja ta ngrija këtë me
17 qëllim që ta dini që do të shtohet edhe kontributi ynë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Z. LAWS: [Nuk ka përkthim].

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 --- Seanca mbyllet në orën 16.47

22

23

24

25